

ZHVILLIMI I KËSAJ STRATEGJIE ËSHTË I FINANCUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN

PËRMBAJTJA E KËTIJ DOKUMENTI ËSHTË PËRGJEGJËSI E PALËS KONTRAKTUESE (AESA)
DHE MINISTRISË PËR ARSIM DHE SHKENCË DHE NË KURFARË RRETHANA NUK MUND TË
TRAJTOHET QË E REFLEKTON QËNDRIMIN E BASHKIMIT EVROPIAN

REPUBLIKA E MAQEDONISË

**STRATEGJIA E ARSIMIT
PËR PERIUDHËN 2018-2025**

dhe plani i veprimit

CIP- Katagolizimi në publikim

Biblioteka Popullore dhe Universitare "Sh. Kliment Ohridski", Shkup

37(497.7)"2018/2025"

STRATEGJIA për arsim për vitin 2018-2025 dhe Plani i Veprimit.

-Shkup: Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë,
2018.-170 faq.: ilustro.; 25 cm

Dokumenti është hartuar në kuadër të Programit Operativ, "Zhvillimi i resurseve njerëzore 2007-2013", nëpërmjet realizimit të projektit të udhëhequr nga lideri i ekipit: Aram Avagijan, eksperti kryesor: prof: Violeta Petroska- Beshka dhe shtatë grupe të punës të koordinuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë

ISBN 978-608-226-396-0

a) Education - Strategy - Macedonia - 2018-2025 – Action Plans
COBISS.MK-ID 107255306

PËRMBAJTJA

1. KONTEKSTI SHOQËROR-EKONOMIK DHE POLITIK.....	8
2. PASQYRA E SISTEMIT ARSIMOR.....	10
3. VIZIONI, SYNIMET DHE DETYRAT E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT	15
4. QASJA STRATEGJIKE.....	22
5. FUSHAT KRYESORE STRATEGJIKE (SHTYLLAT) TË ARSIMIT.....	24
5.1 ARSIMI PARASHKOLLOR.....	25
5.1.1. Pasqyra e gjendjes dhe veprimtaritë e deritanishme	25
5.1.2. Sfidat	27
5.1.3. Përparësitë dhe përfundimet e pritshme.....	27
5.2 ARSIMI FILLOR (ARSIMI I PËRGJITHSHËM)	29
5.2.1. Pasqyra e gjendjes dhe veprimtaritë e deritanishme	29
5.2.2. Sfidat	31
5.2.3. Përparësitë dhe përfundimet e pritshme.....	33
5.3 ARSIMI I MESËM I PËRGJITHSHËM (gjimnazet, shkollat e arteve dhe shkollat për nxënësit me nevoja të posaçme arsimore)	35
5.3.1. Pasqyra e gjendjes nga aktivitetet e deritanishme	35
5.3.2. Sfidat	37
5.3.3. Përparësitë dhe rezultatet e pritshme	38
5.4 ARSIMI DHE TRAJNIMI PROFESIONAL.....	40
5.4.1. Pasqyra e gjendjes dhe veprimtaritë e deritanishme	40
5.4.2. Sfidat	42
5.4.3. Përparësitë dhe rezultatet e pritshme	43
5.5 ARSIMI I LARTË HULUMTIMET DHE INOVACIONET	45
5.5.1. Pasqyra e gjendjes së veprimtarive të deritanishme	45
5.5.2. Sfidat	47
5.5.3. Përparësitë dhe rezultatet e pritshme	48
5.6 ARSIMI JOFORMAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR	50
5.6.1. Pasqyra e gjendjes dhe veprimtaritë e deritanishme	50
5.6.2. Sfidat	51
5.6.3. Përparësitë dhe rezultatet e pritshme	52
5.7 PËRPARËSITË E PËRGJITHSHME-TË PËRBASHKËTA NË SISTEMIN E ARSIMIT	53
5.7.1. Pasqyrimi i gjendjes dhe veprimtarive të deritanishme	54
5.7.2. Sfidat	57
5.7.3. Përparësitë dhe rezultatet e pritshme	59
6. ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI I STRATEGJISË.....	61
7. PLANI I VEPRIMIT	62

LISTA E SHKURTIMEVE

PPV	Prodhimi i përgjithshëm i vendit
BZhA	Byroja e zhvillimit të arsimit
VMJI	Validiteti i mësimi joformal dhe informal
QRM	Qeveria e Republikës së Maqedonisë
EShS	Enti Shtetëror i Statistikës
QShP	Qendra Shtetërore e Provimeve
IShA	Inspektorati Shtetëror i Arsimit
KE (EC)	Komisioni Evropian
SECAAP (EQAVET)	Sigurimi evropian i cilësisë në arsimin dhe aftësimin profesional
EKAR (EQAR)	Regjistri evropian i sigurimit të cilësisë për arsimin e lartë
EMIS	Sistemi i menaxhimit të informacionit në sistemin arsimor
ENQA	Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë
KEK	Korniza evropiane e kualifikimeve
ESG	Standardet dhe kriteret për kontrollimin e cilësisë së arsimit të lartë në Evropë
FET (ETF)	Fondacioni Evropian i Trajnimeve
BE (EU)	Bashkimi Evropian
BNJVL	Bashkësia e Njërive të Vetëqeverisjes Lokale të Republikës së Maqedonisë
TIK	Teknologjia e informacionit dhe komunikimit
IPA	Instrumenti i Asistencës së Para-anëtarësimi
DIS	Dokumenti strategjik indikativ 2014-2020
TI	Teknologjia informatike
ME	Ministria e Ekonomisë
MSh	Ministria e Shëndetësisë
MShIA	Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administrimi
MVL	Ministria e Vetëqeverisjes Lokale
MASH	Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
KMK	Korniza e Maqedonisë së Kualifikimeve
MPPS	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
MF	Ministria e Financave
ZKTT	Zyra Kombëtare e Transferimit të Teknologjive
AJ dhe ARr	Arsimi joformal dhe arsimi i të rriturve
NPAA	Programi kombëtar për miratimin e të drejtës së Bashkimit Evropian
KNK	Korniza nacionale e kualifikimeve
KNALShIT	Këshilli nacional i arsimit të lartë, i shkencës, inovacioneve dhe teknologjive
KAEAL	Këshilli për akreditim dhe vlerësim në arsimin e lartë

KMBP	Këshilli për mirëbesim dhe bashkëpunim me publikun
AShJ	Arsimi për shkathtësitë e jetës
SZhQ	Synimet zhvillimore të qëndrueshme të BE-së
KZhPA	Këshilli për zhvillimin e politikave arsimore
PIRLS	Studim rreth përparimit në shkrim-lexim dhe në të lexuarit në shkallë ndërkombëtare
PISA	Programi për vlerësimin ndërkombëtar të nxënësve
ShP	Shërbimi pedagogjik
GP	Grupe pune
BB (WB)	Banka Botërore
APT	Arsimi profesional dhe trajnimi
TIMSS	Studimi i trendeve ndërkombëtare në fushën e matematikës dhe studimeve të shkencës
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi Ndërkombëtar i Emergjencës për Fëmijët i Kombeve të Bashkuara
NARr	Të nxënit dhe arsimimi për të rriturit
DZhPAGjPB	Drejtoria për zhvillimin dhe përparimin e arsimit në gjuhët e pjesëtarëve të bashkësive
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për zhvillim ndërkombëtar
FIZhT	Fondi për inovacionet dhe zhvillimin teknologjik
QARr	Qendra për Arsimimin e të Rriturve
QAPT	Qendra e Arsimimit Profesional dhe Trajnimit

FALËNDERIMI PËR NDIHMESËN

Qeveria e Republikës së Maqedonisë i falënderon të gjithë ata që dhanë ndihmesë për zhvillimin e Strategjisë së arsimit 2018-2025.

PARATHËNIE

Strategjia e arsimit në Republikën e Maqedonisë për periudhën 2018-2025 dhe Plani i veprimit i saj u hartuan me përkrahjen financiare dhe teknike të Bashkimit Evropian nëpërmjet një procesi këshillimesh të gjera dhe të pjesëmarrjes, i cili u zhvillua me anë të një numri të madh takimesh, diskutimesh, debatesh e konferencash gjatë fazave të ndryshme të përpilimit të strategjisë, më saktësisht, që nga përcaktimi i sfidave dhe përparësive e deri te formulimi i tekstit përfundimtar.

Mbështetje të madhe pati nga shumë ekspertë, punonjës arsimit, njerëz akademikë dhe figura publike, përfaqësues të institucioneve publike, sektori civil si dhe palëve të tjera të interesuara për zhvillimin e burimeve njerëzore dhe të politikave arsimore në Republikën e Maqedonisë.

Zhvillimi i Strategjisë u bë nëpërmjet gjashtë grupeve të punës të formuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe u mbikëqyr prej dy bashkërenduesish në shkallë kombëtare. Ata mbështeteshin nga një ekip ekspertësh që vepronin në kuadër të projektit për Marrëveshjen kornizë të ndihmës teknike për përgatitjen e Strategjisë gjithëpërfshirëse 2018-2020 të zbatuar nga Agrikonsalting Evropa prej Belgjike (C.A.Agriconsulting Europe S.A.- AESA).

Versioni i parë i projektit të Strategjisë u përpilua në qershor 2016 dhe iu shpërnda palëve kryesore të interesuara, duke përfshirë pushtetet kombëtare, institucionet publike, partnerët socialë, institucionet arsimore, partnerët e zhvillimit, njerëzit profesionistë dhe faktorët e tjerë në fushë të arsimit. Duke u bazuar në sugjerimet e tyre Strategjia u rishikua, u përmirësua sërish dhe versioni përfundimtar u prezantua nga fundi i vitit 2017.

HYRJE

1. Strategjia e arsimit në Republikën e Maqedonisë për periudhën 2018-2025 paraqet bazën e veprimtarive të qeverisë së Republikës së Maqedonisë në fushën e arsimit gjatë periudhës deri më 2025. Ajo u hartua mbi bazën e gjendjes së tanishme në sistemin tonë arsimor dhe synon që këto arritje t'i përmirësojë dalëngadalë në pajtim me përparësitë e përcaktuara.
2. Ndonëse procesi i përgatitjes së Strategjisë përkrahet fuqimisht nga ana e Bashkimit Evropian, prapëseprapë ky proces ka ndjekur këto parime: *përkatësia* ndaj qeverisë së Republikës së Maqedonisë (QRM) dhe institucioneve që përgjigjen drejtpërdrejt për zbatimin e tyre, sidomos Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale si dhe organet dhe institucionet përgjegjëse për arsim duke përfshirë dhe institucionet arsimore; dhe *pranimi* nga një rreth i gjerë palësh të interesuara, duke përfshirë këtu organet publike, shoqatat qytetare, partnerët socialë dhe bashkësinë e partnerëve zhvillimorë (partnerët e zhvillimit);
3. Strategjia në fjalë mbështetet në përcaktimin e qartë të sfidave kryesore në sektorin arsimor dhe kësaj sigurohet *relevanca* me anë të përcaktimit me kujdes të fushave me përparësi ku duhet përqendruar vëmendja gjatë periudhës deri në vitin 2025. Njëkohësisht, duke pasur për qëllim përmbushjen e kriterit të *kredibilitetit* te kjo strategji janë përfshirë vetëm ato masa që mund të zbatohen gjatë periudhës së planifikuar dhe që mbështeten edhe prej Planit të veprimit, ku hyjnë shpenzimet dhe burimet e financimit.

Megjithatë, Strategjia propozon gjithashtu edhe objektiva më afatgjatë që mund të merren parasysh kur të bëhet programimi i fazave të tjera të zhvillimit të arsimit në vendin tonë.

4. Identifikimi i sfidave e përparësive dhe përcaktimi i masave u bë në disa mënyra të ndryshme:
 - pasqyrimi i arritjeve në sistemin arsimor në 10 vjetët e fundit, i bërë nga grupet e punës (GP) të formuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës (MASH) për nevoja të përgatitjes së kësaj strategjie;
 - shqyrtimi i strategjive kryesore gjithëpërfshirëse në shkallë kombëtare, i dokumenteve ku përmbahen politikat arsimore dhe politikat në sektorët e tjerë që kanë të bëjnë me arsimin, si dhe dokumentet më të rëndësishme që përfshijnë politikat evropiane dhe rajonale, duke bashkëngjitur këtu edhe dokumentet që lidhen me marrëdhëniet BE – Republika e Maqedonisë;
 - konsultime me një pjesëmarrje të madhe e të ndryshme të palëve kryesore të interesuara, duke përfshirë këtu institucionet e vendit, organizatat qytetare, partnerët socialë, bashkësinë e partnerëve të zhvillimit, si dhe ekspertë të arsimit e profesionistë nga praktika, nëpërmjet shumë e shumë takimesh, diskutimesh, debatesh dhe konferencash.
5. Ky dokument përfshin në radhë të parë gjashtë shtyllat e sistemit arsimor: arsimin parashkollor; arsimin fillor; arsimin e mesëm; arsimin profesional dhe trajnimin; arsimin e lartë dhe hulumtimin; dhe të nxënit e arsimimi i të rriturve. Pastaj vjen shtylla e shatë ku hyjnë disa tema të përgjithshme të sistemit arsimor.
6. Këto shtylla trajtohen te Pjesa 5, nëpërmjet Pasqyrimin të gjendjes dhe arritjeve të mëhershme, identifikimit të sfidave, përcaktimit të përparësive dhe përfundimeve të pritshme që duhet të arrihen.
7. Pjesa 6 i shtron parimet themelore për zbatimin, mbikëqyrjen dhe vlerësimin e Strategjisë, kurse Pjesa 7 e shpalos Planin e veprimit.

KONTEKSTI SHOQËROR- EKONOMIK DHE POLITIK

8. Republika e Maqedonisë është një vend kontinental me një popullsi prej 2 022 547 banorësh²⁵, e cila në këto 15 vjetët e fundit ka pasur zhvillim relativisht të qëndrueshëm – nga statusi i ekonomisë së ulët-të mesme në vitin 2000 arriti në statusin e ekonomisë së mesme-të lartë. Në mesin e 188 vendeve, Maqedonia më 2016 u rendit në vendin 82 (duke mbetur mbrapa për një vend – e 81-ta, në krahasim me vitet 2014 dhe 2015) dhe tash hyn në grupin e vendeve me zhvillim të lartë njerëzor²⁶.
9. Përpjekjet për të ruajtur stabilitetin makroekonomik, në kontekstin e recesionit të përgjithshëm dhe ngadalësimit në Euro-zonë, dhanë si rezultat rritjen e PPV në 3,7% në vitin 2015²⁷, kurse në vitin 2016 vetëm 2,6%²⁸. Në vitin 2016 shkalla e punësimit të popullatës së aftë për punë (15-64) ishte 49,1%, ku vihet re një rritje prej 5,7 pikë për qind në krahasim me vitin 2009. Megjithatë, shkalla e punësimit te popullata e re (15-24) edhe më tej mbetet e ulët dhe shënon 16,2%²⁹.
10. Indikatorët e varfërisë tregojnë një përmirësim të vogël në 5-6 vitet e fundit. Kështu, numri i të varfërve në shkallë vendi ka rënë prej 26,8% në vitin 2010 në 22,1% më 2014³⁰.
11. Megjithëse shkalla e papunësisë ka rënë nga 32,3% e vitit 2009 në 24% më 2016, prapëseprapë ajo mbetet edhe më tej e lartë. Papunësia e të rinjve bie me rritjen e shkallës së arsimimit të tyre, por ajo mbetet dy herë më e lartë se mesatarja dhe shënon 48,2% (47,9% për meshkujt dhe 48,8% për femrat)³¹. Në vitin 2016, 25,2% e personave të moshës 15-24 vjeçe as nuk qenë të përfshirë në sistemin arsimor dhe as nuk qenë të punësuar.
12. Gjatë viteve të fundit u hapën gjithnjë e më shumë vende pune në sektorin e industrisë së përpunimit, në ndërtimtari, transport dhe magazinim, në veprimtaritë administrative e shërbyese dhe ato artistike, në zbavitje e rekreacion. Rreth 53% e vendeve të reja të punës lidhen me arsimin e mesëm profesional, kurse 34% me shkallët më të ulëta të arsimit. Në të ardhmen shumica e vendeve të punës do të hapen në

²⁵ Sipas regjistrimit të fundit në vitin 2002.

²⁶ UNDP, Human Development Report 2015.

²⁷ Banka botërore, Indikatorët e zhvillimit botëror: <http://databank.worldbank.org/data/reports.aspx?source=2&country=MKD&series=&period=>

²⁸ Enti Shtetëror i Statistikës, Raporti mujor i statistikës, nr. 1.2.17.03

²⁹ Enti Shtetëror i Statistikës, Anketë për fuqinë punëtore 2016 (http://www.stat.gov.mk/PrikaziPoslednaPublikacija_en.aspx?id=3).

³⁰ World Bank, Global Poverty Working Group. http://databank.worldbank.org/data/Views/Reports/ReportWidgetCustom.aspx?Report_Name=CountryProfile&Id=b450fd57&tbar=y&dd=y&inf=n&zm=n&country=MKD.

³¹ Enti Shtetëror i Statistikës, Anketë për fuqinë punëtore, 2016

industrinë e përpunimit (40%) dhe në tregti (9%), me shkallë të mesme/profesionale (62%) dhe me arsim të lartë (10%)³².

13. Në periudhën 2009-2015, migrimi neto u rrit vazhdimisht nga 1,065 në 4,342 – kryesisht nga shkak i numrit të të huajve me qëndrim të përkohshëm – mirëpo në vitin 2016 u regjistrua rënie prej 4,113. Njëherazi edhe migrimi neto i banorëve në Maqedoni ka një përmirësim të vogël, po përsëri mbetet negativ (nga -510 më 2009 deri -157 më 2016)³³:

	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Ardhacakë	1 857	2 715	3 211	3 787	3 991	4 208	5 358	4 743
Shtetas	259	303	349	396	490	265	259	283
Të huaj me qëndrim të përkohshëm	1 000	1 356	1 747	2 072	1 941	2 273	3 617	2 481
Të huaj me qëndrim të vazhduar	598	1 056	1 115	1 319	1 560	1 670	1 482	1 979
Të shpërngulur	792	1 007	1 290	1 415	1 041	839	1 016	630
Shtetas	769	923	1 143	1 330	945	740	767	440
Të huaj me qëndrim të përkohshëm	23	84	147	85	96	99	249	190
Migrimi neto	1 065	1 708	1 921	2 372	2 950	3 369	4 342	4 113

14. Grupin më të madh të ardhacakëve e përbëjnë ata që janë me arsim të mesëm (25,0% e gjithë ardhacakëve më 2016, 31,0% më 2014, 34,4% më 2013 dhe 41,8% në vitin 2012), pastaj vjen grupi me arsim të lartë (ku hyjnë edhe ata me diplomë magjistri) që paraqet 9,8% të ardhacakëve në vitin 2016 (10,7% më 2014, 11,2% më 2013 dhe 9,0% më 2012). Ndërkohë, grupi i ardhacakëve me arsim fillor përbën 6,1% të numrit të përgjithshëm të ardhacakëve – numri i tyre ishte shumë më i madh në vitet e mëparshme: 13,2% më 2014, 17,3% më 2013 dhe 28,3% në vitin 2012). Personat me doktoratë janë grupi më i vogël i ardhacakëve dhe pjesëmarrja e tyre është 0,2%.³⁴
15. Në vitin 2013 për studentët e Maqedonisë pesë shtete më të popullarizuara kanë qenë: Bullgaria (1197), Italia (507), Gjermania (425), Austria (412) dhe Turqia (361), ndërkaq studentët e huaj që kanë studiuar në universitetet e vendit tonë kanë qenë kryesisht nga: Serbia (1146), Shqipëria (230), Turqia (211), Bullgaria (30) dhe Kroacia (24)³⁵. Në bazë të kësaj, baraspesha e mobilitetit edhe më tej mbetet negative.
16. Maqedonia ka përkushtim të fuqishëm ndaj proceseve të integritit evropian dhe anëtarësimit përfundimtar në BE. Shteti ynë bëri Marrëveshjen e stabilizimit dhe asocimit në vitin 2011 që hyri në fuqi në vitin 2004 dhe fitoi statusin e vendit-kandidat të BE në dhjetor të vitit 2005. Programi kombëtar për miratimin e të drejtës së Bashkimit Evropian (NPAA) u miratua në vitin 2006 dhe rishikohet çdo vit, me aktivitete që vijnë nga raportet e progresit të Komisionit Evropian, si dhe prioriteteteve afatmese dhe afatshkurtra nga Partneriteti për anëtarësim i cili miratua nga Këshilli i Ministrave të BE-së në vitin 2008.

³² Ibid.

³³ Enti Shtetëror i Statistikës, Migrimet 2016. http://www.stat.gov.mk/PrikaziPoslednaPublikacija_en.aspx?id=9

³⁴ Statistika nuk e tregon korrelacionin midis atyre me arsim të mesëm të përgjithshëm dhe atyre me arsim të mesëm profesional.

³⁵ UNICEF, Migration Profiles: The Former Yugoslav Republic of Macedonia.


2

PASQYRA E SISTEMIT ARSIMOR

17. Sistemi arsimor në Republikën e Maqedonisë përbëhet nga arsimi parashkollor, fillor (6-14 vjeç), i mesëm (15-17/18 vjeç) dhe i lartë. Skema e paraqitur në faqen tjetër e pasqyron strukturën e sistemit tonë arsimor.
18. Në vitin 2016 u përfshinë 33 238 fëmijë të moshës deri 6 vjeç në 64 institucione parashkollore publike dhe në 19 private, 4 kopshte brenda shkollave private si entitete juridike, 1 qendër për fëmijët me zhvillim të hershëm si entitet publik, 6 qendra për zhvillim të hershëm të fëmijëve si entitete private juridike, 1 kopsht publik brenda një entiteti juridik të themeluar për nevojat e punonjësve të saj, 1 kopsht privat brenda një entiteti juridik të themeluar për nevojat e punonjësve të saj. Nga numri i përgjithshëm i fëmijëve 16 796 janë vajza. Nga numri i tërësishëm i fëmijëve ka 840 fëmijë me përkatësi romë dhe vetëm 174 fëmijë me aftësi të kufizuara (përkatësisht me nevoja të posaçme arsimore). Vitin përgatitor (mosha 5-6 vjeçe) e ndjekin 14 035 fëmijë (43%).
19. Arsimi fillor zgjat nëntë vjet, është i detyrueshëm dhe pa pagesë për të gjithë nxënësit (e moshës 6-14 vjeçe). Në vendin tonë ka 347 shkolla fillore (rreth 1100 së bashku me ato periferike). Shkalla e atyre që dinë shkrim e lexim është e lartë dhe shënon 98,8% për meshkujt dhe 96,8% për femrat (2015)³⁶. Shkalla bruto e përfshirjes është 63%, kurse shkalla neto është 91%. Këta numra nuk përfshijnë nxënësit (kryesisht romë) që fare nuk janë të regjistruar në sistem (pa numër amë), kurse për këtë shkak edhe shkalla aktuale e përfshirjes për kohortën përkatëse moshore është më e vogël.
20. Arsimi i mesëm, që po kështu është i detyrueshëm dhe pa pagesë, është i ndarë në katër lloje: gjimnaz, arsim i mesëm profesional, arsim artistik dhe arsim për nxënësit me nevoja të posaçme arsimore. Arsimi i mesëm profesional mund të zgjasë 3-4 vite. Pasi t'i kryejnë tre vjet arsim profesional, nxënësit hyjnë në provimin përfundimtar dhe nuk kanë të drejtë të regjistrohen në universitet. Nxënësit që kryejnë arsimin e mesëm profesional katërvjeçar mund të zgjedhin ose provimin përfundimtar ose maturën shtetërore, varësisht nga dëshira për të vazhduar shkollimin ose jo, kurse nxënësit e gjimnazeve në mënyrë të detyrueshme i nënshtrohen maturës shtetërore ose shkollore.
21. Nga 124 shkollat e mesme ekzistuese, 108 prej tyre janë publike, ndërsa 16 shkollat e tjera janë private. Nga shkollat e mesme publike, 23 janë gjimnaze; 43 janë profesionale; 33 ofrojnë edhe arsim si gjimnaze edhe si profesionale; 4 shkolla janë për nxënësit me nevoja të posaçme arsimore; dhe 5 të tjera janë shkolla artistike.

³⁶ Burimi: "Adult literacy rate, population 15+ years (both sexes, female, male)". UIS Data Centre. UNESCO. August 2015.

Struktura e sistemit arsimor në Republikën e Maqedonisë (në pajtim me KMK)



22. Në vitin shkollor 2016/2017, në 194 paralele të 45 shkollave/institucioneve fillore speciale kanë mësuar gjithsej 809 nxënës (duke përfshirë 289 femra) dhe në 61 paralele të 4 shkollave të mesme speciale janë përfshirë 229 nxënës me nevoja të posaçme arsimore (66 prej tyre femra)³⁷. Sipas MASH-it 725 nxënës me

³⁷ Të dhënat administrative nga Sektori për arsimin fillor dhe të mesëm i MASH-it.

nevoja të posaçme arsimore u përfshinë në mësimin e rregullt në shkollat fillore dhe 230 në mësimin e rregullt në shkollat e mesme.

23. Në vitin shkollor 2016/2017 u përfshinë 44.064 nxënës në arsimin e mesëm profesional publik (rreth 59% e gjithë nxënësve në arsimin e mesëm), prej të cilëve 44,7% qenë vajza. Vetëm 3.053 ishin të përfshirë në arsimin e mesëm trevjeçar (6,9% e arsimit profesional, përkatësisht 4,1% e arsimit të mesëm), kurse 41.011 nxënës kanë ndjekur arsimin profesional katërvjeçar (93,1% e arsimit profesional, gjegjësisht 55,2% e arsimit të mesëm). Në arsimin profesional pas së mesmes u përfshinë vetëm 1049 nxënës që paraqet 1,82% e të gjithë nxënësve të përfshirë në arsimin pas së mesmes.
24. Arsimi i lartë realizohet në tri nivele: universitar, i magjistraturës dhe i doktoratës. Në vendin tonë funksionojnë gjashtë universitete shtetërore (dy prej tyre në gjuhën shqipe), 1 universitet privat-publik dhe 9 universitete private dhe dy shkolla të larta profesionale. Në vitin akademik 2016/2017 në 122 fakultete në kuadër të universiteteve u regjistruan rreth 58 mijë studentë në studime universitare, prej të cilëve rreth 56% janë femra. Shkalla bruto e përfshirjes shënon 34,2% (39,2% për femrat), ndërsa shkalla neto ishte 26,3% (31% për femrat). Në vitet 2015/16 ka pasur 3.034 studentë në studime magjistrature, kurse 58,9% i përkasin atyre shtetërore.
25. Në arsimin fillor mësimi organizohet në katër gjuhë mësimore (maqedonisht, shqip, turqisht dhe serbisht)³⁸, ndërkaq në shkollimin e mesëm në tri gjuhë mësimore (maqedonisht, shqip dhe turqisht). Pothuaj 29% e shkollave fillore dhe 34% e shkollave të mesme janë dygjuhëshe / trigjuhëshe³⁹.
26. Në kuadër të MASH-it Sektori për arsimin fillor dhe të mesëm (me katër seksione) dhe Sektori për arsimin e lartë (me tri seksione)⁴⁰ janë përgjegjës për nivelet përkatëse të arsimit. Sektori për Bashkimin Evropian (me tri seksione) është i ngarkuar për bisedimet dhe integrimin e bashkësisë, si dhe për implementimin, bashkërendimin, mbikëqyrjen dhe vlerësimin e përbërësve relevantë të IPA-s (Instrumenti për ndihmën para anëtarësimin). Për shkak të karakterit specifik të strukturës së sistemit për arsimin profesional e trajnimin dhe të arsimit për të rriturit, në vendin tonë nuk ka një njësi të veçantë brenda MASH-it të ngarkuar me këta resorë, por bashkërendimi i ngarkohet Seksionit për arsimin e mesëm.
27. Ka disa institucione në kuadër të sistemit që janë përgjegjëse për aspekte të ndryshme të arsimit. Byroja e zhvillimit të arsimit (BZhA) është organ i administratës shtetërore në përbërje të MASH-it, që kryen punë profesionale me rëndësi për zhvillimin dhe përparimin e edukimit dhe arsimit në vendin tonë. BZhA-ja është kompetente për ndjekjen, kontrollin profesional, hulumtimin, përparimin dhe zhvillimin e veprimtarisë edukativo-arsimore në fushën e arsimit parashkollor, fillor, gjimnazor dhe artistik, të mesëm profesional dhe pas të mesmes, të arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe të arsimit për të rriturit, në veprimtarinë edukativo-arsimore në konviktet e nxënësve, si dhe për arsimimin e fëmijëve të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë jashtë vendit për të mësuar gjuhën dhe kulturën amtare. Brenda BZhA-së veprojnë katër sektorë: për planet dhe programet mësimore, për kërkime në arsim, për zhvillimin profesional dhe për veprimtarinë botuese. Selinë e ka në Shkup, mirëpo për zhvillimin e punëve me karakter këshillues profesional dhe të punëve instruktuese-mentoruese të kuadrit edukativo-arsimor dhe udhëheqës janë formuar 12 njësi organizative në qytetet të ndryshme.
28. Qendra e arsimit profesional dhe trajnimit (QAPT), e formuar në vitin 2007, udhëhiqet nga Këshilli drejtues prej nëntë anëtarësh që e përfaqësojnë atë: nga një person prej MASH-it, Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale (MPPS), odave ekonomike, Dhomës së zëhtarëve të Republikës së Maqedonisë dhe Shoqatës së njësisive të vetëqeverisjes lokale të Republikës së Maqedonisë (ShNjVL), si dhe katër veta nga QAPT-ja.

³⁸ Në vitin 2010 u fut mësimi eksperimental në gjuhën boshnjake, i cili mund të zbatohet në shkollat që do të siguronin kushte për realizimin e tij.

³⁹ Burimi: Projekti i USAID-it për integrimin ndëretnik në arsim.

⁴⁰ Në kuadër të MASH-it janë edhe sektori i shkencës dhe risive, i financave, për punë të përgjithshme dhe mbështetje të ministrit, për punë normative-juridike, për tekstet, për mbikëqyrje të brendshme, për menaxhimin e burimeve njerëzore, për planifikim strategjik dhe analizë, Drejtoria për zhvillimin dhe përparimin e arsimit në gjuhët e pjesëtarëve të bashkësive si dhe njësi të tjera.

Në obligimet kryesore të QAPT-së bëjnë pjesë: analiza dhe shqyrtimi i sistemeve për arsimin profesional; zhvillimi i standardeve të profesioneve; zhvillimi i standardeve për kualifikime profesionale; programet mësimore; trajnimi i mësimdhënësve; këshillimi e mentorimi; si dhe bashkëpunimi ndërkombëtar dhe përkrahja e partneritetit social. QAPT-ja merr pjesë aktive në promovimin e arsimit profesional dhe trajnimit me qëllim që të përmirësohet atraksioni për këtë lloj arsimit. Megjithatë, kapacitetet e QAPT-së për realizimin e veprimtarive janë të kufizuara si nga buxheti i ulët në dispozicion, ashtu edhe nga personeli.

29. Qendra për arsimin e të rriturve (QARr) u formua në nëntor të vitit 2008 nga ana e qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe e filloi punën në qershor të vitit 2009. QARr-in e udhëheq Këshilli drejtues i përbërë prej dhjetë anëtarësh që i përfaqësojnë: MASH-in, MPPS-në, odat ekonomike, Dhomën e zëhtarëve të Republikës së Maqedonisë, Shoqatën e njëjësive të vetëqeverisjes lokale të Republikës së Maqedonisë (ShNjVL) dhe QARr-in. Synim kryesor QARr-i ka të japë ndihmesë në plotësimin e nevojave shoqërore-ekonomike të vendit tonë, si të kërkesave të tregut të punës dhe ta ndihmojë zhvillimin profesional të individëve. Ndër obligimet kryesore të QARr-it janë: promovimi i arsimit për të rriturit, bashkërendimi i bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare dhe me organizatat e tjera për arsimin e të rriturve, sigurimi i cilësisë sidomos nëpërmjet vendosjes së standardeve dhe kritereve për arsimin formal dhe joformal të të rriturve.
30. Misioni i Qendrës ndërkombëtare të provimeve (QShP) është e ngarkuar kryesisht me organizimin dhe sigurimin e formave të ndryshme të vlerësimit të nxënësve (siç janë notimi nga jashtë, matura shtetërore), duke përfshirë këtu edhe testimet në shkallë ndërkombëtare (si Programi për vlerësimin ndërkombëtar të nxënësve – PISA dhe Studimi i trendeve ndërkombëtare në fushën e matematikës dhe studimeve të shkencës – TIMSS). Si plotësim, QShP-ja bën edhe trajnime, vlerësime dhe licencime të drejtorëve (kandidatëve për drejtorë) të institucioneve arsimore. QShP-ja është strukturë e pavarur që varet drejtpërdrejt nga QRM-ja, por shënon linjën e dytë buxhetore të BZhA-së. QShP-ja përgatit raporte të rregullta dhe ka një numër të madh informacionesh për përparimin arsimor të nxënësve në shkallë kombëtare, rajonale dhe lokale.
31. Inspektorati shtetëror i arsimit (IShA) është person juridik, një organ në përbërje të MASH-it. Në IShA punojnë disa inspektorë dhe këshilltarë që janë përgjegjës për kontrollin e zbatimit të rregullativës juridike që ka të bëjë me arsimin dhe për kontrollin e cilësisë në procesin edukativo- arsimor në të gjitha nivelet arsimore dhe në universitetet e hapura qytetare. Kontrolli i cilësisë bëhet nëpërmjet zbatimit të vlerësimit integral në shkollat fillore, në shkollat e mesme dhe në universitetet e hapura qytetare. Ai përfshin shtatë fusha (planin dhe programet mësimore, të arriturat e nxënësve, të nxënësve dhe mësimdhënësve, përkrahja e nxënësve, klima në shkollë, burimet dhe përparimi e udhëheqja), në pajtim me instrumentin e brendshëm Indikatorët për vlerësimin e cilësisë në procesin edukativo arsimor në kuadër të institucioneve edukativo- arsimore. Përveç kësaj IShP-ja bën edhe mbikëqyrjen inspektuese në institucionet parashkollore, por vetëm nga aspekti i realizimit të programit si dhe në universitete nga aspekti i respektimit të përcaktimeve ligjore.
32. Drejtoria e zhvillimit dhe përparimit të arsimit në gjuhët e pjesëtarëve të bashkësive (DZhPAGjPB) është një organ në kuadër të MASH-it. Ajo është kompetente për t'u kujdesur rreth zhvillimit të mësimin për pjesëtarët e bashkësive etnike, të sigurojë një qasje më të mirë në të gjitha shkallët e arsimit për gjitha grupet etnike të marginalizuara, si dhe të bashkërendojë punën e projekteve që kanë për qëllim forcimin e tolerancës midis pjesëtarëve të bashkësive etnike të ndryshme në vend. DZhPAGjPB-ja është përgjegjëse edhe për jetësimin e Strategjisë për arsimin e romëve dhe të Strategjisë për arsimin e integruar. DZhPAGjPB-ja përbëhet nga Seksioni për gjuhën shqipe, turke, serbe, rome, vllahe e boshnjake dhe nga Seksioni për paqe dhe të drejtat e fëmijës të të gjitha bashkësitë.
33. Shërbimi pedagogjik (ShP) është një organ në kuadër të MASH-it me dy sfera të veprimtarisë së vet: (1) përgatitja e programeve dhe masave për përmirësimin e zhvillimit psikologjik, social, kulturor dhe arsimor të nxënësve si dhe për zbatimin e procedurave të përkrahjes së zhvillimit të nxënësve dhe (2) organizimi dhe mbështetja e procedurave për përgatitjen e teksteve mësimore për arsimin fillor dhe të mesëm.
34. Në kuadër të Ministrisë së punës dhe politikës sociale (MPPS), çështjet që kanë të bëjnë me punësimin i bashkërendon Sektori i politikave në lëmin e të drejtave në punë dhe politikave për punësim (me katër

seksione). Këto njësi janë kompetente për përgatitjen, menaxhimin, bashkërendimin, mbikëqyrjen dhe vlerësimin e Strategjisë kombëtare për punësim dhe Planit të veprimit për punësimin e të rinjve dhe për masat rreth punësimit nga Programi operativ për zhvillimin e burimeve njerëzore. Seksioni për gjithëpërfshirje sociale në kuadër të Sektorit për mbrojtje sociale është përgjegjës për përgatitjen, bashkërendimin dhe mbikëqyrjen e Strategjisë kombëtare për uljen e varfërisë dhe përjashtimit social 2010-2020. MPPS-ja vepron sipas Planit operativ vjetor për programet dhe masat aktive për punësimin dhe shërbimet e tregut të punës (me synime të qarta dhe indikatorë dalës), me shpenzime të përlogaritura dhe me burime të përcaktuara financimi. Sektori për mbrojtjen e fëmijëve mban përgjegjësi për të gjitha aspektet e arsimit parashkollor, përveç për Programin për të nxënëit dhe zhvillimin e hershëm (që bie në kompetencat e MASH-it – BZhA-së).

35. Për vitin 2017 shpenzimet e arsimit kapin shumë më 25492,8 milionë denarë⁴¹ (rreth 414,5 milionë euro) ose 12,4% nga buxheti i shtetit në krahasim me 23644,4 milionë denarë⁴² (rreth 383,3 milionë euro) ose 12,1% në vitin 2016. Shpërndarja e kësaj shume në nivelet e ndryshme të arsimit paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Niveli i arsimit	Në mijë denarë		Në mijë euro (përafërsisht) ¹⁹		Rritje 2016-2017, %
	2016	2017	2016	2017	
Arsimi parashkollor dhe fillor	1160204	1916388	18804	31161	65,2
Arsimi i mesëm	1116846	1314261	18101	21370	17,7
Arsimi i lartë	5794356	6030399	93912	98055	4,1
Arsimi tjetër që nuk është sipas nivelit	19301	28939	313	471	49,9
Shërbimet e për përkrahjen e arsimit	14318833	14751639	232072	239864	3,0
Hulumtimet në fushë të arsimit	546325	513662	8855	8352	-6,0
Veprimtari të tjera në fushë të arsimit	163739	256091	2654	4164	56,4
Programe zhvillimore të arsimit	524797	681375	8506	11079	29,8
Gjithsej	23644401	25492754	383216	414516	7,8

36. Mjetet e parashikuara në buxhetin e shtetit i mbulojnë shpenzimet vijuese për funksionimin e sistemit arsimor (p.sh.: bllok dotacione dhe dotacione të destinuara, rroga, bursa, furnizimi me mallra e shërbime dhe investimet kapitale që mbulohen rregullisht nga buxheti) dhe shpenzimet për programet e shumta zhvillimore. Janë të domosdoshme edhe mjetet plotësuese nga buxheti dhe nga burimet e tjera që të bëhet i mundur realizimi i synimeve të Strategjisë dhe mbulimi i shpenzimeve të parashikuara me Planin e veprimit.

⁴¹ Buxheti i Republikës së Maqedonisë për vitin 2017, "Fletorja zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 191/2016.

⁴² Buxheti i Republikës së Maqedonisë për vitin 2016, "Fletorja zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 209/2015

⁴³ Përlogaritjet për vitin 2016 bazohen në kursin si vijon sipas Bankës Qendrore Evropiane: 1 euro = 61,7 denarë të RM-së (sipas kursit në janar të vitit 2016), kurse për vitin 2017 dhe për vitin tjetër kursi i llogaritjes është 1 euro = 61,5 denarë të RM-së (sipas kursit për muajin nëntor 2016)

3

VIZIONI, SYNIMET DHE DETYRAT E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

37. Qeveria e Republikës së Maqedonisë (QRM) konsideron se arsimit, trajnimi, hulumtimi dhe risitë janë faktorë vendimtarë për forcimin e ekonomisë kombëtare dhe mirëqenies së qytetarëve. Në këtë kontekst si **vizion** i përcaktuar me këtë Strategji mund të llogaritet përpjekja për të siguruar *arsim gjithëpërfshirës, inkluziv e të integruar, të orientuar nga “nxënësi”⁴⁴, me programe bashkëkohore që mundësojnë gjeneratat e ardhshme të fitojnë dituri, shkathtësi dhe kompetenca në pajtim me nevojat e shoqërisë demokratike multikulturore, me tregun e punës dhe me sfidat e reja në mjedisin e përgjithshëm shkencor-teknologjik.*
38. Sipas këtij vizioni, Strategjia do të orientohet kryesisht nga përmirësimi i:
1. Cilësia e arsimit dhe relevanca e tij për zhvillimin e përparësive të shoqërisë maqedonase (sidomos kur bëhet fjalë për formimin e qytetarëve të angazhuar e produktivë) dhe për nevojat e tregut të punës, të udhëhequr drejt rezultateve të pritura të mësimin, si dhe për pranimin e multikulturalizmit, integritimit ndëretnik, respektimit të dallimeve dhe vlerave demokratike;
 2. Zhvillimi i kompetencave të përgjithshme dhe thelbësore të gjithë nxënësve, në mënyrë që të zhvillohen në mendimtar kritik, aktivë dhe pjesëmarrës relevant në jetën shoqërore;
 3. Infrastruktura të sistemit arsimor, duke përfshirë këtu ndërtimet, pajisjet, teknologjitë mësimore dhe ato ndihmëse, me qëllim të krijimit të mjedisit adekuat për të nxënësit në tërësi dhe përfshirje të personave me nevoja të veçanta arsimore;
 4. Kapaciteteve të burimeve njerëzore, duke i përfshirë personat udhëheqës, kuadrin dhe shërbimet profesionale;
 5. Cilësia dhe rezultate e procesit arsimor nëpërmjet përmirësimit të vlerësimit në të gjitha nivelet arsimore: nxënës, mësues, shkollë dhe sistem;
 6. Autonomia e institucioneve në arsim, veçanërisht e universiteteve, si dhe autonomia e entiteteve në procesin arsimor;
 7. Legjislacionit, administrimit dhe financimit.
39. **Qëllimet** dhe **detyrat** e përcaktuara brenda Strategjisë dalin nga sfidat më të rëndësishme të sistemit arsimor që janë identifikuar nëpërmjet analizës së themeltë të situatave në çdo nënsektor. Ato, gjithashtu, janë në pajtim me qëllimet e përcaktuara nga ana e dokumenteve themelore që lidhen me procesin e qasjes dhe janë nënshkruar nga ana e BE-së dhe e Republikës së Maqedonisë dhe janë miratuar nga QRM-ja.

⁴⁴ Në këtë kontekst, me termin “nxënës” kuptohet çdo pjesëmarrës në procesin edukativ dhe/ose arsimor.

40. Dokumenti strategjik indikativ 2014-2020 i miratuar në gusht të vitit 2014 i përcakton këto qëllime kryesore për ndihmën nëpërmjet IPA II në Sektorin e arsimit, punësimit dhe politikave sociale: *ulja e shkallës së lartë të papunësisë, rritja e pjesëmarrjes në tregun e punës, sidomos e të rinjve dhe grave, rritja e qasjes në arsimin dhe trajnimin cilësor, harmonizimi më i mirë me kërkesën e shkathtësive, krijimi i një sistemi modern e fleksibil të mbrojtjes sociale*. Rezultatet që duhet të arrihen përfshijnë:
- një treg pune më gjithëpërfshirës dhe më efektiv;
 - harmonizimin më të mirë të kërkesës dhe ofertës së shkathtësive;
 - sistemin modern të mbrojtjes sociale;
 - një numër më të madh indikatorësh statistikor për krijuesit e politikave;
 - arsimin e përmirësuar parashkollor, të detyrueshëm (fillor e të mesëm) dhe arsimin e lartë.
41. Sipas dokumentit indikativ strategjik 2014-2020 (DIS) arsimi dhe trajnimi do të forcohen sa i përket krijimit të shkathtësive, sidomos nëpërmjet:
- përkrahjes së përmirësimit të cilësisë në arsim dhe lehtësimit të qasjes ndaj arsimit për të gjithë;
 - forcimit dhe modernizimit të sistemeve të arsimit profesional dhe trajnimit (APT) dhe arsimit për të rriturit;
 - mbështetjes së zhvillimit dhe realizimit të kornizës kombëtare të kualifikimeve;
 - përkrahjes së të nxënit gjithëpërfshirës të përhershëm;
 - promovimit të të nxënit sipërmarrës;
 - mbështetjes së partnerëve socialë dhe sektorit privat.
42. Synimet themelore përcaktohen edhe nëpërmjet dokumentesh të tjera të BE-së e të Maqedonisë, siç janë Programi ekonomik i para-anëtarësimit 2014-2015 (viti 2014); Programi ekonomik reformues (viti 2016); Programi kombëtar për miratimin e të drejtës i Bashkimit Evropian (2007, i rishikuar çdo vjet), Vendimi mbi parimet, përparësitë dhe kushtet e përfshira në partneritetin për anëtarësim 2006/57/EK (viti 2008); Strategjia Evropa Juglindore 2020 (viti 2013); Arsimi dhe trajnimi i mësimdhënësve nga Ballkani Perëndimor (viti 2013); Evropa 2020 - Strategjia për zhvillim të mençur, të qëndrueshëm e gjithëpërfshirës (2012), Plani i aktiviteteve për realizimin e përparësive të ngutshme reformuese 2015 (viti 2015) nëpërmjet të cilave shteti mori përgjegjësi për reformat, sidomos në fushën e arsimit, që mund të paraqitet në këtë mënyrë:
- *Arsimi parashkollor, fillor dhe i mesëm:*
 - Qasje universale për të nxënit dhe zhvillimin në fëmijërinë e hershme për moshën 3-6 vjeçe, pavarësisht aftësive të tyre.
 - Përmirësimi i kualitetit të arsimit parashkollor;
 - Rritja e përfshirjes së fëmijëve dhe duke siguruar drejtësi në lidhje me qasjen e të gjithë fëmijëve në institucionet e arsimit parashkollor;

- Sigurimi i arsimit të cilësisë së lartë dhe të rregullt fillor për të gjithë fëmijët dhe parandalimi i shkaqeve për braktisje dhe vijimin e parregullt të mësimi i cili është i paregjistruar.
 - Promovimi i integritit të nxënësve që u përkasin bashkësive të ndryshme etnike, nëpërmjet veprimtarive të përbashkëta mësimore dhe jashtëmësimore, mësimi së bashku i gjuhëve, përmirësimit të kushteve hapësinore për integrim, sigurimi i kompetencave ndërnjerëzore dhe ndërkulturore sociale e shoqërore;
 - Regjistrimi i nxënësve në moshën relevante, pa marrë parasysh prejardhjen dhe kompetencat e tyre, sidomos të atyre që u përkasin grupeve të marginalizuara (p.sh. fëmijët romë) dhe siguria se së paku do ta kryejnë arsimin fillor;
 - Sigurimi i pjesëmarrjes kualitative dhe relevante e nxënësve në arsimin e rregullt për të realizuar potencialin e tyre dhe njëkohësisht për të shmangur situatat ku nxënësit të cilët vijnë nga grupe të marginalizuara dhe të rrezikuara regjistrohen në shkolla, por dështojnë të ndjekin rregullisht orët mësimore dhe kanë arsimim me cilësi të dobët;
 - Përmirësimi dhe përshtatja e infrastrukturës arsimore, e Planit e programit mësimor dhe teksteve për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore; sigurimi i kompetencave të arsimtarëve dhe shërbimeve profesionale që punojnë me nxënës të këtyre grupeve;
 - Përmirësimi i kompetencave dhe efikasiteti i punonjësve të arsimit; aplikimi i teknologjisë digjitale dhe integrimi i TIK-ut në mësimdhënie dhe në të nxënësit;
 - Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit të anëtarëve të shërbimeve eksperte (pedagogë, psikologë, edukatorët e veçantë, punonjësit shoqëror) duke rritur pjesëmarrjen e tyre relevante në jetën e përditshme shkollore të nxënësve, dhe në të njëjtën kohë duke hequr barrën e tyre me detyra administrative të cilat janë jo karakteristike për profesionin e tyre;
 - Transformimi i shkollave speciale në qendra burimore që do të bëhen mbështetje thelbësore për shkollat, mësuesit dhe bashkëpunëtorët e ekspertëve në zbatimin e masave për arsimin e rregullt gjithëpërfshirës;
 - Sigurimi i bursave dhe kujdestarisë për nxënësit romë në shkollat e mesme; bursa për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore; transport falas dhe mjete të tjera të përkrahjes;
 - Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet pushteteve qendrore dhe lokale;
 - Zbatimi i sistemit për t'i ndjekur ata që e kanë kryer arsimin formal.
- *Arsimi profesional dhe trajnimi:*
 - Të bëhet sa më tërheqës APT, cilësia dhe rëndësia e tij, me anë të rregullimit të ndryshimeve shoqërore dhe teknologjike në njërën anë dhe nevojave dhe karakteristikave të nxënësve në tjetrën;
 - Formimi i një qasje të arsimit të mesëm të APT duke u bazuar në kompetenca të përgjithshme dhe kryesore dhe rezultate të pritura të mësimi;
 - Përmirësimi i burimeve dhe kapaciteteve të sistemit APT;
 - Zhvillimi i sistemit për parashikimin e nevojave për shkathtësitë (sidomos nëpërmjet vendosjes së Observatorit të shkathtësive) dhe zhvillimi e operacionalizimi i sistemit informativ në tregun e punës;
 - Futja në përdorim e një sistemi efektiv dhe fleksibil për përpilimin e Standardeve të profesioneve dhe të Standardeve të kualifikimeve që mbështeten në rezultatet e të nxënësit, hartimi i planit dhe programit mësimor modular që mbështeten po kështu te rezultatet e të nxënësit, në pajtim me ato

standarde që i plotësojnë nevojat e tregut të punës, si dhe programet e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore;

- Sigurimi i trajnimeve të arsimtarëve për realizimin e planit dhe programit të ri mësimor dhe lidhur me qasjet e reja ndaj të nxënësve;
- Përmirësimi i të nxënësve nëpërmjet punës në të gjitha format dhe për të gjithë tipat e nxënësve dhe të rriturve, sidomos nëpërmjet zbatimit të programeve përkatëse;
- Vënia në përdorim e sistemit kombëtar për kontrollimin e cilësisë së arsimit dhe kontrollit të relevancës së sistemit për t'i ndjekur ata që kanë përfunduar arsimin formal;
- pjesëmarrja në projektet rajonale të arsimit sipërmarrës në Evropën Juglindore.

- *Arsimi i lartë dhe hulumtimi:*

- rritja e cilësisë në arsimin e lartë nëpërmjet përmirësimit plotësues të punës së Këshillit për akreditim dhe vlerësim në arsimin e lartë;
- përmirësimi i bazës materiale e metodologjike të arsimit të lartë;
- zhvillimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë, sektorit privat dhe organeve publike relevante;
- optimizimi i profileve arsimore që financohen nga shteti, kurse u ofrohen universiteteve në Maqedoni dhe sigurimi i qasjes së barabartë në arsimin e lartë, kohezioni social dhe të nxënësve gjatë gjithë jetës;
- sigurimi i rrjetëzimit me universitetet e huaja,
- përmirësimi i kapaciteteve për akomodimin e studentëve të universiteteve publike;
- rritja e investimeve publike dhe private në kërkimin e zbatuar, zhvillimin dhe risitë.

- *Arsimi joformal dhe informal dhe arsimi i të rriturve:*

- përshpejtimi i procesit për verifikimin e programeve dhe dhënësve të shërbimeve për arsimin joformal dhe arsimin për të rriturit (AJ dhe ARr), përditësimi i rregullt i katalogut të programeve të verifikuara dhe i dhënësve të shërbimeve;
- Përforsimi i ndihmës në procesin e zbatimit dhe operimit të sistemit për vërtetimin e rezultateve nga arsimi joformal dhe informal (VMJI), si sistem i cili mundëson identifikimin, dokumentimin, përqindjen dhe certifikimin e kompetencave të cilat personat i posedojnë. Me këtë sistem atyre do tu mundësohet lëvizshmëri vertikale dhe horizontale në sistemin arsimor dhe në tregun e punës;
- Përshtatja e programeve sipas nevojave dhe karakteristikave specifike të procesit të mësimit të të rriturve;
- përmirësimi i motivimit të personave për të marrë pjesë në AJ dhe ARr nëpërmjet ngritjes së vetëdijes, dhënies së informacioneve, drejtimeve, mbështetja dhe motivimi i të rriturve, vlefshmëria e njohurive të mëparshme, si dhe zgjerimi i mundësive për zhvillimin e karrierës;
- zbatimi i sistemit të kualifikimeve të pjesshme, modeli modular i arsimit të të rriturve dhe programet për të rriturit me nevoja të veçanta arsimore; sigurimi i kompetencave kryesore në kuadër të trajnimeve për arsimimin e të rriturve;

- vendosja e kontrollit të cilësisë në AJ dhe ARr, sidomos nëpërmjet përdorimit të mekanizmit për ndjekjen dhe vlerësimin nga jashtë të cilësisë;
 - vënien në përdorim të mekanizmit për nxitjen e punëdhënësve që të investojnë në arsim dhe trajnime, sidomos nëpërmjet promovimit të partneriteteve ndërmjet punëdhënësve dhe dhënësve të arsimit për të rriturit;
 - përcaktimi i nevojave lokale për AJ dhe ARr (nga ana e komunave) dhe sigurimi i trajnimeve në nivelin rajonal dhe lokal;
 - përmirësim i bazës juridike dhe i planeve për financimin e arsimit për të rriturit;
 - realizimi i programit për kryerjen e arsimit të mesëm nga ana e të rriturve, me rritjen e numrit të komunave të involvuara.
- *Përparësitë e përgjithshme /e përbashkëta:*
 - vendosja e tërësishme e Kornizës kombëtare të kualifikimeve;
 - forcimi i sistemit për orientimin në karrierë dhe këshillimi;
 - prezantimi i përmbajtjeve të duhura të programeve të ndryshme mësimore për zhvillimin e kompetencave të përgjithshme dhe kyçe në të gjitha nivelet e arsimit;
 - krijimi dhe operacionalizimi i sistemit të validitetit të rezultateve dalëse të të nxënit joformal dhe informal;
 - aplikimi i të nxënit sipërmarrës në të gjitha nivelet e arsimit;
 - sigurimi i investimeve kapitale me qëllim të përmirësimit të kushteve fizike në institucionet arsimore;
 - pajisja e të gjitha institucioneve arsimore me mjete ndihmëse dhe pajisje për fëmijët, nxënësit, studentët dhe mësimdhënësit;
 - sigurimi i procesit të vazhdueshëm për zhvillimin profesional të kuadrit dhe shfrytëzimi efikas i teknologjive;
 - përmirësimi i Sistemit të menaxhimit të informacioneve në arsim (EMIS)⁴⁵ dhe i sistemit për grumbullimin e të dhënave;
 - përmirësimi dhe harmonizimi i legjislacionit;
 - vendosja e partneritetit social të institucionalizuar.

43. Përveç kësaj, gjatë formulimit të synimeve dhe detyrave të Strategjisë u morën parasysh me përparësi përfundimet vijuese që parashikohen me njërin nga dokumentet kombëtare strategjike vendimtare (më saktësisht me Strategjinë kombëtare të punësimit 2016-2020 të miratuar në tetor të vitit 2015), të cilat lidhen ngushtë ose i përfshijnë pjesërisht synimet e sipërpërmendura të përcaktuara me dokumentet për anëtarësim dhe dokumentet kombëtare strategjike:

- sistem informatik funksional për arsimin dhe tregun e punës, më saktësisht, metodologji të përmirësuar për ndjekjen e nevojave për shkathtësi (Skill Needs Survey);

⁴⁵ Nga viti 2010 zbatohet programi EMIS, por ka nevojë që ai të përmirësohet.

- sistem të zhvilluar për parashikimin e nevojave për shkathtësi, observator i vendosur për shkathtësitë dhe model për parashikim;
- sistem efikas dhe fleksibil për zhvillimin e Standardeve të reja për kualifikime, zeje dhe profesione;
- standarde të zhvilluara për zejet dhe plane e programe arsimore të rishikuara në pajtim me nevojat e tregut të punës, si dhe trajnime të arsimtarëve;
- sistem i instaluar për të ndjekur nxënësit (Tracersystem) pasi të përfundojnë arsimin formal;
- sistem i përforcuar për orientim në karrierë dhe këshillim;
- përparim i mëtejme për vendosjen e tërësishme të Kornizës kombëtare të kualifikimeve (KKK), duke i përfshirë punëdhënësit në të gjitha fazat e procesit;
- të nxënit e përmirësuar nëpërmjet punës në të gjitha format, si për nxënësit, ashtu edhe për të rriturit;
- zbatimi i programeve speciale mësimore për të rriturit për shkathtësi të reja për pozicione të “gjelbra” pune;
- përsheptimi i procesit të verifikimit të dhënësve të shërbimeve dhe i programeve për të rriturit;
- cilësi e rritur e arsimit të lartë nëpërmjet përmirësimit të mëtejme të punës së Këshillit për akreditim dhe vlerësim në arsimin e lartë (KAVAL), si dhe nëpërmjet realizimit të vlerësimeve nga jashtë;
- numër i zvogëluar i të rinjve të papunë e të papërfshirë në arsim e trajnime dhe normë e zvogëluar e braktisjes;
- operacionalizimi i sistemit për validitetin e rezultateve dalëse nga arsimimi joformal dhe informal, i futur njëherazi me programet speciale për arsimimin e të rriturve.

44. Si rezultat i kësaj, synimet e Strategjisë janë përcaktuar në këtë mënyrë:

- rritja e ndjeshme e përfshirjes së fëmijëve në arsimin parashkollor dhe përshtatja e programit për regjistrim të efikas dhe të përshtatur në arsim fillor;
- racionalizimi i planeve dhe programeve mësimore për të gjitha vitet e arsimit të detyrueshëm, sidomos në vitet e para të çdo cikli si dhe forcimi i tij me veprimtari dhe mjete që e bëjnë më tërheqëse shkollën dhe përfshijnë përmbajtje me interes lokal;
- përforcimi i programeve me aktivitete dhe mjete për të rritur tërheqjen ndaj shkollave, nxisin qëndrim konstruktiv ndaj mësimin dhe përfshijnë përmbajtje të interesit lokal dhe nxisin lidhshmërinë me komunitetin dhe angazhimin e përgjegjshëm;
- përshtatja e Programeve mësimore sipas moshës së nxënësve me anë të përfshirjes së Programeve të ndryshme mësimore të kompetencave të përgjithshme dhe kyçe të bazuara nga rezultatet dalëse të të nxënit;
- përparimi dhe përshtatja e instrumenteve për sigurimin e cilësisë (edhe kontrolli i cilësisë) që e vendos nxënësin në qendër të vëmendjes dhe është në interesin më të mirë të nxënësit;
- përshtatja dhe realizimi konsekuent i konceptit të gjithëpërfshirjes dhe arsimit multikulturor me fokusim në vlerat demokratike, të drejtat njerëzore, barabarësinë gjinore, përfilljen e dallimeve mbi çfarëdo qoftë baze si dhe me mbështetje të kohezionit etnik;
- përparimi dhe zbatimi konsekuent i metodologjisë për regjistrimin e nxënësve dhe njëkohësisht zvogëlimi i rolit të teksteve si mjete të vetme për arritjen e qëllimeve mësimore, me ç'rast duhet pasur parasysh arritjet nga zbatimi i TIK-ut në arsim;

- përparimi i infrastrukturës arsimore për të siguruar gjithëpërfshirje (përfshirje) më të madhe, qasje, efikasitet energjetik dhe digjitalizim;
 - sigurimi i përfshirjes së plotë në sistemin arsimor për të gjithë nxënësit me nevoja të veçanta arsimore nëpërmjet përshtatjes së Programeve mësimore (në aspektin e qëllimeve mësimore dhe gjuhës së realizimit të procesit mësimor) sipas nevojave dhe mundësive të tyre dhe përforcimi i kompetencave të mësuesve dhe kuadrit profesional;
 - racionalizimi dhe rajonizimi konceptor i arsimit të mesëm profesional me programe të bazuara në kompetenca të përgjithshme dhe kyçe dhe me programe të orientuara nga nevojat e tregut të punës;
 - standardizimi i veprimtarisë në arsimin e lartë sipas kriterëve evropiane dhe respektimi i ligjshmërisë gjatë hapjes dhe funksionimit të institucioneve të larta arsimore;
 - rivendosja e autonomisë në universitete, duke përfshirë lirinë akademike dhe parandalimi i mundësive për të ushtruar presion ndaj anëtarëve të komunitetit akademik;
 - zgjerimi i mundësive për arsimimin e të rriturve dhe mbështetja e konceptit për të nxënësit gjatë gjithë jetës;
 - mbështetja në procesin e themelimit dhe funksionalizimit e sistemit për vlefshmërinë e rezultateve të mësimin joformal dhe informal;
 - forcimi i veprimtarisë, kompetencave dhe kapacitetit të kuadrit në të gjitha nivelet arsimore, duke përfshirë bashkëpunëtorë profesionistë në bazë të profesionit;
 - intensifikimi i zbatimit të TIK-ut në arsim nëpërmjet instalimit të portalit për –të nxënësit dhe sistem të menaxhimit të të nxënësit dhe trajnim të vazhdueshëm të kuadrit për shfrytëzimin e teknologjive të reja dhe pajimeve të TIK-ut në arsim; krijimi i sistemit për përtëritjen e pajisjes kompjuterike dhe sigurimi i kushteve për mirëmbajtje efikase të pajisjes kompjuterike dhe rrjeteve kompjuterike;
 - forcimi i kapaciteteve në nivelin qendror, lokal dhe shkollor (parashkollor) për menaxhimin e veprimtarisë nëpërmjet administrimit më efikas, zhvillimi i politikave të harmonizuara dhe transparente për realizimin e procesit arsimor të papenguar e cilësor në kushte të kompetencave të decentralizuara;
 - krijimi i bazave për hartimin dhe zhvillimin e një reforme integrale si një tërësi që do të përfshijë arsimin në të gjitha nivelet, nga arsimit parashkollorë deri tek arsimit i lartë, si një proces dhe mundësi për të mësuarit gjatë gjithë jetës, ku nivelet e arsimit do të ndërliken në mënyrë logjike dhe të suksesshme;
45. Strategjia është dizajnuar në atë mënyrë që të krijojë realizimin e qëllimeve nëpërmjet implementimit të një numri të caktuar masash (dhe arritjes së përfundimeve përkatëse) që lidhen me përparësitë e përcaktuara për çdo nënsektor (shtyllë) të sistemit arsimor dhe kushtëzohen nga nevojat specifike më të ngutshme të çdo shtylle. Kjo qasje jep ndihmesë edhe për anën praktike të Strategjisë, po sidomos të Planit të veprimit, që e lehtëson realizimin, mbikëqyrjen dhe vlerësimin.
46. Njëherazi, po të merret parasysh periudha e kufizuar e kohës që mbulon Strategjia, nuk do jetë e mundur të marrin përgjigje të gjitha sfidat deri në fund të vitit 2025. Prandaj, në Strategji janë marrë parasysh vetëm ato përfundime që realisht mund të jetësohen. Megjithatë, Plani i veprimit përfshin edhe një numër të caktuar veprimtarish që synojnë të vendosin një bazë të fuqishme për t'u arritur qëllimet e mëtejshme.



QASJA STRATEGJIKE

47. Në pikëpamje të dizajnit dhe zbatimit, Strategjia bazohet në këto qasje:

- angazhim i fuqishëm dhe përkushtim i vendit në pajtim me dokumentet për anëtarësim në BE, si dhe të dokumenteve strategjike në shkallë kombëtare;
- analizë e themeltë e gjendjes dhe e asaj që mund të arrihet nga të gjitha masat e propozuara;
- miratim i vendimeve të balancuara për hapat që duhet ndërmarrë për zgjidhjen e çështjeve urgjente;
- përgatitje e një baze të fuqishme për realizimin e çdo mase të paraparë;
- parashtrim i përfundimeve në pajtim me përparësitë, me ç'rast ato janë të realizueshme në kuadër të periudhës së dhënë kohore;
- shpërndarje e burimeve varësisht nga rezultatet dhe indikatorët dalës;

48. Paralelisht me këtë do të sigurohet edhe sa vijon:

- mbështetja e fushatës sistemore me qëllim që të sqarohet nevoja dhe ngrihet vetëdija për parimet gjithëpërfshirëse të të nxëniet gjatë gjithë jetës nëpër të gjitha fazat e jetës dhe në kuadër të secilës prej shtyllave arsimore gjatë miratimit të politikave publike;
- zgjerimi i strukturës së sistemit arsimor në Republikën e Maqedonisë me përfshirjen e të nxëniet dhe arsimimit të të rriturve;

49. Përveç kësaj, duhet të sigurohet përfshirje e gjerë e palëve të interesuara në realizimin e Strategjisë. Sidomos parashihet që shumë rezultate të fitohen me pjesëmarrjen e palëve të interesuara, ose së paku të diskutuara e të harmonizuara me ta para se të miratohen zyrtarisht. Bashkëpunimi dhe pjesëmarrja e të gjitha palëve kryesore të interesuara në fushën e arsimit do të nxitet nëpërmjet dialogut të vazhdueshëm mbi politikën arsimore dhe institucionalizimin e saj, e cila gjë gjithashtu është paraparë në Strategji krahas masave të tjera.

50. Strategjia propozon një sërë masash që janë të përbashkëta për disa nënsektorë në arsim. Më saktësisht, ata janë: orientimi në karrierë dhe këshillimi, sistemi për ndjekjen e nxënësve dhe studentëve që kanë mbaruar, zhvillimi profesional dhe përparimi në karrierë i kuadrit arsimor dhe i kuadrit tjetër, licencimi i drejtorëve të institucioneve arsimore, KNK, EMIS etj. Megjithatë, ato janë prezantuar individualisht në shtyllat përkatëse, por realizimi i tyre do të bashkërendohet me sukses me qëllim të ndjekjes së qasjes integruese dhe të sigurohet efikasitet i shpenzimeve. Në të ardhmen (në fazën vijuese të realizimit të reformave në arsim) ky lloj i masave të politikës arsimore duhet të përcaktohet në kuadër të sistemit të njësuar, kurse në disa raste madje edhe të institucionalizohen.
51. QRM-ja është e vetëdijshme se nevojiten ndryshime thelbësore të domosdoshme në disa aspekte të arsimit dhe se duhet të zbatohen reforma serioze. Megjithatë, sipas qasjes së kësaj Strategjie para se të inkuadrohen çfarëdo qoftë ndryshimesh rrënjësore, duhet të bëhet një analizë e themeltë e realizueshmërisë dhe të arrihet pëlqim për të gjitha ndërhyrjet që duhet të pranohen nga ana e të gjitha palëve kryesore të interesuara. Kjo do të sigurojë operacionalizim të papenguar të çdo sistemi a mekanizmi të ri, pa shkaktuar efekte të padëshirueshme ose kundërthënëse, që mund të çojnë të humbja e kredibilitetit të reformave, ose humbja e besimit të partnerët socialë dhe të shoqëria në përgjithësi.

5

FUSHAT KRYESORE STRATEGJIKE (SHTYLLAT) TË ARSIMIT

5.1

ARSIMI PARASHKOLLOR

5.1.1. Pasqyra e gjendjes dhe veprimtaritë e deritanishme

52. Roli i arsimit dhe edukimit parashkollor në R. Maqedonisë është socializmi, edukimi dhe arsimimi i fëmijëve të moshës parashkollore, me qëllim të krijimit të bazave për zhvillimin e potencialeve të tyre dhe marrjen e diturive mbi botën që i rrethon. Misioni i arsimit parashkollor ka qasje të njëjtë dhe përfshirje maksimale të fëmijëve të moshës parashkollore me forma dhe programe të ndryshme, të dizajnuara sipas trendeve bashkëkohore dhe njohurive shkencore më të reja në fushën e zhvillimit të fëmijës.
53. Me procesin e decentralizimit që filloi në korrik të vitit 2005, të drejtat e themelimit dhe përgjegjësitë për 51 kopshte publike të fëmijëve (me 181 objekte) në 40 komuna u transferuan nga pushtetet qendrore tek ato lokale. Fëmijët e tetë komunave të tjera shkojnë në kopshtet që funksionojnë nën kopshtin e komunës fqinje.
54. Në vitin 2005 u rregullua me ligj që viti i fundit i arsimit parashkollor (për fëmijët e moshës 6-7 vjeçe) të jetë i detyrueshëm. Me kërkesë të MASH u përpilua Programi i veçantë për punën edukative-arsimore në vitin përgatitor, së bashku me dosjen për ndjekjen e zhvillimit të fëmijës gjatë këtij viti, kurse edukatorët ishin stërvitur që atë program ta zbatojnë në praktikë. Në vitin shkollor 2007-2008 viti përgatitor i arsimit parashkollor u përfshi si vit i parë shkollor në ciklin e arsimit fillor.
55. Në vitin 2009 MPPS, kompetente për sistemin e arsimit parashkollor, i futi në përdorim Standardet për të nxënësit dhe zhvillimin e hershëm të fëmijës, të përpiluara nga një grup i gjerë pune, përfaqësues të institucioneve kyçe dhe të palëve të interesuara. Standardet i përcaktojnë të arriturat e pritura nga fëmijët e moshës parashkollore në fusha të ndryshme të zhvillimit të tyre (zhvillimi i motorikës, zhvillimi socio-emocional, zhvillimi mendor etj.). Këto standarde mund të zbatohen në të gjitha kontekstet në të cilat fëmijët e moshës 0-6 vjeçare marrin shërbime të përkujdesjes, edukimit dhe arsimimit (në familje, në kopshte fëmijësh, në qendra rekreative për fëmijët dhe në forma të ndryshme joformale të kujdesit ndaj fëmijëve). Të njëjtin vit u organizuan disa punëtori për ngritjen e vetëdijes mbi rëndësinë e zhvillimit të hershëm të fëmijëve dhe aty morën pjesë përfaqësues nga të gjitha kopshtet e fëmijëve me qëllim të promovimit të Konceptit për zhvillim në fëmijërinë e hershme, nëpërmjet zbatimit praktik të standardeve nëpër kopshte.
56. Gjatë periudhës 2010-2012 u zhvilluan kapacitetet e edukatorëve parashkollorë në 18 kopshte fëmijësh të zgjedhura. Ata u stërvitën për realizimin e strategjive (të bazuara mbi standardet) për të nxënësit e fëmijët, për vlerësimin dhe dokumentimin e të arriturave të tyre si dhe për krijimin e bashkëpunimit me prindërit. Në vitin 2013 u përpiluan materiale për prindërit, të destinuara për mbështetjen e zhvillimit dhe të nxënësit e

fëmijëve në kushte shtëpiake, kurse kopshteve të zgjedhura të fëmijëve iu rekomandua t'i përcjellin efektet e zbatimit të tyre.

57. Në vitin 2012 u përgatitën instrumentet për ndjekjen e zhvillimit të fëmijëve në bazë të Standardeve dhe këto u bënë pjesë zyrtare e portofolios për çdo fëmijë. Me qëllim të lehtësimit të procesit të menaxhimit të dokumentacionit dhe evidencës pedagogjike, u përpilua një doracak për edukatorët dhe mësuesit kujdestarë. Në vitin 2014 edukatorët e të gjitha kopshteve publike e private janë stërvitur për mënyrën e shfrytëzimit të instrumentit të sipërpërmendur.
58. Arsimi parashkollor është i rregulluar me Ligjin për mbrojtjen e fëmijës, të miratuar në vitin 2013, i cili ndryshohet dhe plotësohet sipas nevojës. Me anë të këtij ligji të nxëniet dhe zhvillimi i hershëm vihen në qendër të vëmendjes, kurse përveç kopshteve publike u lejuan edhe forma të tjera të shërbimit të përkujdesjes dhe arsimit të fëmijëve. Kjo i ka nxitur komunitetet për të hapur qendra për zhvillimin e hershëm të fëmijëve aty ku nuk ishin hapur kopshte. Përveç kësaj, ligji rregullon edhe sistemin e mbikëqyrjes inspektuese të veprimtarisë në mbrojtje të fëmijëve dhe inkuadron licencimin mbi bazën e stërvitjes dhe provimeve plotësuese. Ligji shoqërohet nga 25 akte nënligjore që i përcaktojnë normat e realizimit të tij.
59. Gjatë vitit 2014 janë stërvitur 157 edukatorë të të gjitha kopshteve të fëmijëve për zbatimin e plotë e gjithëpërfshirës të Standardeve. Këta edukatorë e kanë përcjellë këtë stërvitje tek edukatorët e tjerë në kopshtet e tyre. Janë përpiluar 2 doracakë (njëri për mësuesin kujdestar dhe tjetri për edukatorin) me qëllim të realizimit të Standardeve.
60. Në vitin 2015 nga MPPS është miratuar Programi i të nxëniet dhe zhvillimit të hershëm të fëmijëve me pengesa në zhvillim, i përgatitur nga ana e BZHA-së. Programi ka për qëllim të sigurojë mundësi të barabarta për të gjithë fëmijët e moshës parashkollore.
61. Gjatë viteve 2014-2015 të gjithë edukatorët që punojnë me fëmijë të moshës 5-6 vjeçe në 10 kopshte fëmijësh janë përfshirë në Programin pilot për aplikimin e respektit të diversitetit dhe multikulturalizmit në zhvillimin e fëmijërisë së hershme. Edukatorët kanë marrë stërvitjen e nevojshme si dhe doracakun, materialet edukative dhe librat për fëmijë me qëllim të realizimit të këtyre veprimtarive. Përveç kësaj, në kuadër të programit të njëjtë janë organizuar edhe veprimtari për ngritjen e vetëdijes për të gjithë edukatorët e kopshteve të tjera të fëmijëve.
62. Në vitin 2013 janë punësuar logopedë në kopshtet e fëmijëve në Republikën e Maqedonisë. Në vitin 2015 të punësuarit e 10 kopshteve pilot e kaluan stërvitjen për gjithëpërfshirje (inkluzion) në të nxëniet dhe zhvillimin e hershëm të bazuar në modulet përkatëse të përsosjes profesionale. Është përpiluar gjithashtu dhe një doracak për arsimimin parashkollor gjithëpërfshirës.
63. Në vitin 2015, me qëllim të përmirësimit të cilësisë në arsimin parashkollor, këshilltarët e BZHA-së filluan të realizojnë vizita këshillëdhënëse-instruktive dhe inspektime profesionale në kopshtet publike të fëmijëve.
64. MPPS në bashkëpunim me Fondin për arsimimin e romëve, me 18 komuna dhe me 17 organizata joqeveritare romë realizoi projektin Gjithëpërfshirja e fëmijëve të përkatësisë romë në kopshtet publike të fëmijëve. Ky projekt kishte për qëllim rritjen e përfshirjes së fëmijëve romë në arsimin parashkollor një deri dy vjet para se të fillojnë shkollimin fillor. Projekti në fjalë synonte që ta ndryshonte për mirë qëndrimin e prindërve romë ndaj arsimit, të zgjeronte shkathtësitë sociale dhe njohjen e gjuhës maqedonase nga fëmijët romë, si dhe të përmirësonte kompetencat e mësuesve kujdestarë dhe të edukatorëve parashkollorë për të punuar me fëmijët romë dhe që të angazhohen kundër paragjytimeve ndaj romëve. Për këto qëllime MPPS, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave (MF) miratoi mbështetje financiare për angazhimin e 17 mësuesve kujdestarë romë. Gjatë realizimit të disa aktiviteteve, institucionet kompetente të përkujdesjes dhe edukimit të fëmijëve realizuan bashkëpunim të ngushtë me disa partnerë kryesorë ndërkombëtarë të zhvillimit dhe me disa palë të interesuara.

65. Janë bërë përpjekje në drejtim të rritjes së numrit të kopshteve/qendrave të zhvillimit në fëmijërinë e hershme dhe zgjerimit të kapaciteteve në kopshtet ekzistuese, sidomos në mjediset rurale dhe mjediset sociale të rrezikuara. Sipas të dhënave MPPS, gjatë periudhës nga viti 2006 deri më sot janë hapur: 14 kopshte publike, 4 institucione publike për fëmijët me zhvillim të hershëm, 17 objekte të edukimit dhe arsimimit parashkollor, 23 grupe në kushte të tjera hapësinore, 25 qendra të zhvillimit në fëmijërinë e hershme në kuadër të kopshteve publike, 7 institucione private për fëmijët – qendra të zhvillimit në fëmijërinë e hershme, 24 institucione private për fëmijë – kopshte fëmijësh dhe 6 kopshte fëmijësh si njësi organizative në kuadër të entiteteve juridike/shkollave të mesme private.

5.1.2. Sfidat

66. Sistemi i arsimit parashkollor ballafaqohet me sfida të rëndësishme:
1. Përfshirja e fëmijëve në arsimin parashkollor nuk është e kënaqshme, kurse sistemi i deritanishëm ka mundësi të kufizuara për regjistrimin në rritje duke përfshirë fëmijët me nevoja të veçanta arsimor. Në të njëjtën kohë, shkalla e përfshirjes është më e ulët sidomos tek komunitetet e marginalizuara tek të cilët tendenca për braktisje është në rritje, duke përfshirë vështirësi në arritje të standardeve dhe arritjet e ulëta të të nxënit;
 2. Kushtet e mësimin në institucionet parashkollore janë të pakënaqshme; normat dhe standardet në institucionet parashkollore realizohen në mënyrë jokonsistente; pothuaj fare nuk shfrytëzohet TIK-u në institucionet parashkollore.
 3. Standardet ekzistuese për të nxënit dhe zhvillimin në fëmijërinë e hershme duhet të rishikohen; kontrollimi i cilësisë nuk funksionon; nuk realizohet edukimi dhe arsimimi i integruar multikulturor i fëmijëve të moshës parashkollore; është i dobët bashkëpunimi me nivelet e tjera të arsimit, sidomos me arsimin e lartë.
 4. Sistemi vuan për shkak të numri të pamjaftueshëm të kuadrit në institucionet parashkollore, që shoqërohet nga përcaktimi jo sa duhet i qartë i kompetencave dhe standardeve për drejtorët, edukatorët, mësuesit kujdestarë dhe shërbimet profesionale të kopshteve. Në realitet nuk ka një mekanizëm të zhvillimit profesional dhe të ngritjes në karrierë për punonjësit, kurse sistemi i licencimit të tyre duhet të rishqyrtohet.
 5. Udhëheqja dhe menaxhimi i institucioneve parashkollore nuk është efikas, përputhen përgjegjësitë e strukturave të ndryshme përgjegjëse për sistemin arsimor parashkollor, pra MASH, MPPS dhe Ministria e Vetëqeverisjes Lokale (MVL); është i dobët bashkëpunimi me prindërit, bashkësitë dhe sektorin e biznesit. Njëkohësisht duhet bërë përmirësime edhe në sistemin e evidencës pedagogjike dhe dokumentacionit që bëhet për fëmijët në këto institucione.

5.1.3. Përparësitë dhe përfundimet e pritshme

67. Sa i përket zhvillimit të arsimit parashkollor, Strategjia ka përcaktuar këto përparësi dhe përfundime të pritshme:

Përparësia I. Përmirësimi i përmbajtjes, kushteve për të nxënit dhe i cilësisë në realizimin e arsimit parashkollor

- 1.1. Është përmirësuar përmbajtja e arsimit parashkollor;
- 1.2. Arsimi parashkollor është orientuar drejt arritjes së rezultateve dalëse të përcaktuara me Standardin nacional për të nxënit dhe zhvillimin e hershëm;
- 1.3. janë krijuar parakushte për t'i kushtuar më shumë vëmendje çdo fëmije në institucionet parashkollore;
- 1.4. Procesi edukativo-arsimor është mbështetur me mjetet e domosdoshme fizike me qëllim të arritjes së rezultateve të caktuara dalëse;
- 1.5. Procesi edukativo-arsimor mbështetet me të gjitha materialet didaktike të nevojshme për arritjen e rezultateve të caktuara dalëse;
- 1.6. Edukimi parashkollor ofron një qasje dygjuhësore për të punuar me fëmijët nga kultura të ndryshme;

Përparësia II. Rritja e përfshirjes së fëmijëve dhe përmirësimi i gjithëpërfshirjes në arsimin parashkollor

- 2.1. Janë krijuar kushte themelore për të rritur përfshirjen e fëmijëve në arsimin parashkollor duke siguruar qasje të barabartë për të gjithë fëmijët;
- 2.2. Janë krijuar kushtet fizike dhe stafi i nevojshëm për regjistrimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore;
- 2.3. Përmbajtja dhe metodat sipas të cilave realizohen aktivitetet me fëmijët në arsimin parashkollor janë përshtatur për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore.
- 2.4. Është siguruar mjedisi që mundëson mbështetje morale dhe ekziston mendimi publik pozitiv për gjithëpërfshirje arsimore;
- 2.5. Është krijuar bazë administrative për sigurimin e gjithëpërfshirjes arsimore.

Përparësia III. Përmirësimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore në institucionet parashkollore

- 3.1. Janë përcaktuar qartë kërkesat e kompetencave profesionale dhe detyrat e punës të punonjësve në institucionet parashkollore;
- 3.2. Edukatorët dhe mësuesit kujdestarë që janë praktikantë/fillestarë janë të aftësuar për kryerjen e detyrave në pajtim me profilin e vendit të punës dhe Standardet e të nxënit dhe zhvillimit të hershëm;
- 3.3. Vazhdimisht përmirësohen kompetencat profesionale të edukatorëve dhe punonjësve të tjerë në institucionet parashkollore; edukatorët janë të motivuar për të treguar rezultate më të mira;
- 3.4. Të gjithë të punësuarit në institucionet parashkollore i plotësojnë kërkesat minimale për kompetenca profesionale.

Përparësia IV. Përmirësimi i legjislacionit, organizimit dhe administrimit në arsimin parashkollor dhe forcimi i bashkëpunimit

- 4.1. Mbikëqyrja e veprimtarive arsimore mbështetet në pasqyrimin përkatës të asaj që kanë punuar edukatorët dhe në arritjet e fëmijëve;
- 4.2. Më mirë janë marrë parasysh nevojat e fëmijëve të moshës parashkollore si dhe interesat e bashkësisë;
- 4.3. Kultura pedagogjike e përgjithshme e prindërve është përmirësuar dhe kjo i jep ndihmesë arsimimit që bazohet në edukimin familjar të fëmijëve.

5.2

ARSIMI FILLOR (ARSIMI I PËRGJITHSHËM)

5.2.1. Pasqyra e gjendjes dhe veprimtaritë e deritanishme

68. Arsimi fillor nëntëvjeçar i detyrueshëm filloi të zbatohet në Maqedoni në vitin 2007, në pajtim me Konventën e arsimimit dhe edukimit fillor nëntëvjeçar. Ligji i arsimit fillor garanton qasje të balancuar të këtij niveli të arsimit për të gjithë fëmijët e moshës 6-14 vjeçe, sidomos përmes sigurimit falas të teksteve dhe transportit të nxënësve që e kanë vendbanimin e përhershëm më larg se 2 km nga shkolla më e afërt.
69. Reformat e planeve dhe programeve mësimore kanë filluar në të njëjtën kohë me vazhdimin e kohëzgjatjes së arsimit fillor. Programet mësimore ngërthejnë në vete qëllime zhvillimore për ciklet e arsimit fillor, qëllime të përgjithshme për çdo paralele dhe qëllime konkrete për çdo temë a program. Përveç kësaj, janë përfshirë edhe shumë lëndë të reja:
 - gjuhë angleze - nga klasa e parë si lëndë e detyrueshme;
 - gjuhë e huaj e dytë - nga klasa VI si lëndë e detyrueshme;
 - inovacione - në klasën IX si lëndë e detyrueshme;
 - punë me kompjuter dhe baza të programimit - në klasat III dhe IV si lëndë e detyrueshme;
 - krijimtari - në klasat IV dhe V si lëndë me zgjedhje;
 - informatikë - në klasat VI dhe VII si lëndë e detyrueshme dhe në klasat VIII dhe IX si lëndë me zgjedhje;
 - etika e religjioneve, njohje me religjionet, kultura klasike në civilizimin evropian - në klasën VI si lëndë zgjedhore;
 - gjuhë shqipe - nga klasa VI si lëndë me zgjedhje;
 - gjuhë dhe kulturë e romëve/boshnjakëve/vllehve - si lëndë me zgjedhje nga klasa III;
 - lëndë të tjera me zgjedhje: atdheu ynë; edukimi për mjedisin; hulumtimi i vendlindjes; kërcime dhe valle popullore; projekte nga arti i muzikës; projekte nga arti i pikturës; arsim teknik; projekte nga informatika; sporti i zgjedhur; përparimi i shëndetit; shkathtësitë e jetës dhe programimi.

70. Përveç kësaj, është përpiluar Programi i arsimit për shkathtësitë e jetës, po edhe doracaku, që planifikohet të realizohet gjatë orës me bashkësinë e klasës nga klasa II deri në klasën IX dhe përfshin shkathtësitë themelore për t'u ballafaquar me sfidat e jetës së përditshme të nxënësve.
71. Nga viti shkollor 2013/2014 është futur programi ndërkombëtar IB në mësimin klasor në dy shkolla fillore të Shkupit (ShFK "Braça Milladinovci" në komunën Aerodrom dhe ShFK "Kirili dhe Metodi" në komunën Qendër), kurse nga viti tjetër shkollorë në këto dy shkolla ka hyrë programi IB në mësimin lëndor.
72. Nga viti shkollor 2015/2016 zbatohet versioni i përshtatur i programeve mësimore sipas Qendrës ndërkombëtare të programeve për provime të Kembrixhit, Britani e Madhe, për lëndët matematikë dhe shkenca natyrore nga klasa I deri në klasën VI dhe matematikë dhe shkenca natyrore të lëndëve si fizikës, kimisë dhe biologjisë nga klasa VII deri në klasën IX. Tekstet mësimore për këto lëndë janë miratuar në pajtim me Konventën për përpunimin e teksteve dhe Metodologjinë e vlerësimit të tekstit.
73. Përveç kësaj, gjatë periudhës 2007-2015 BZhA përgatiti 26 rregullore dhe realizoi 188 stërvitje me arsimtarët, të realizuara na ana e rreth 500 trajnuesve.
74. Me projektin qeveritar Kompjuter për çdo fëmijë duhej t'i sigurohej secilit nxënës në shkollën fillore qasje në kompjuter për ta shfrytëzuar gjatë mësimin. Si mbështetje plotësuese ishte planifikuar të sigurohen dhe kompjuterë portativë për çdo arsimtar dhe internet për të gjitha shkollat.
75. Nxënësit me nevoja të veçanta arsimore mund të regjistrohen në shkolla të rregullta (në paralele të rregullta apo të veçanta) ose në shkolla të posaçme, varësisht nga lloji dhe shkalla e nevojave të veçanta arsimore. Një numër i caktuar arsimtarësh janë stërvitur për punë me këto kategori nxënësish. Në formulën për sigurimin të bllok-dotacioneve merret parasysh edhe numri i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore (me aftësi të kufizuara).
76. Në bashkëpunim me BZhA-në dhe sektorin civil, MPPS në 32 shkolla fillore realizon projektin për zbatimin e teknologjive ndihmëse në procesin e të nxënësve (me shfrytëzimin e pajisjeve speciale, të përshtatura sipas pajisjeve standarde kompjuterike etj.), me qëllim që t'u mundësohet nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe me aftësi të kufizuara të shfrytëzojnë kompjuterin.
77. Është realizuar një hulumtim për punën me nxënësit me prirje e me talent është zbatuar. Për nxënësit që kanë fituar në gara shtetërore dhe ndërkombëtare në matematikë dhe shkenca natyrore caktohen bursa të veçanta. Gjithashtu janë paraparë me ligj edhe programe plotësuese të detyrueshme për nxënësit me vështirësi në të nxënësve dhe programe mësimore shtesë për nxënësit që tregojnë suksese të përparura në lëndë të caktuara.
78. Në vitin 2012 filloi realizimi i projektit pesëvjeçar për integrimin ndëretnik në arsim. Qëllimi i kësaj iniciative ishte që të krijohet në vendin tonë një klimë të përshtatshme shoqërore për mbështetje të integritit ndëretnik jo vetëm në shkolla, por edhe në shoqëri në përgjithësi. Përmes partneriteteve me institucionet kryesore arsimore dhe organizatat joqeveritare lokale, aktivitetet u përqendruan tek nxënësit, prindërit, mësuesit, drejtuesit, administrata dhe bordet e shkollave në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme.
79. Me qëllim të përmirësimit të kontrollit të cilësisë, në vitin 2011 ISHA vuri në përdorim indikatorët për cilësinë e punës në shkolla, që ishin duke u përmirësuar gjatë periudhës nga 2012 – 2016. Me zbatimin e këtyre indikatorëve vlerësohet cilësia e procesit edukativo-arsimor, përcaktohen anët e fuqishme e të dobëta të punës si dhe jepen rekomandime për përmirësimin e tyre. Indikatorët gjithashtu ndihmojnë në procedurën e vlerësimit të pavarur të shkollave. Në procesin e vlerësimit integral, bëhet vlerësimi i detyrave të punës së mësuesve dhe bashkëpunëtorëve profesional të përfshirë në procesin edukativo-arsimor. Për arsimtarët që punësohen për herë të parë aplikohet edhe: dhënia e detyrueshme e testit të personalitetit dhe provimi profesional për arsimtarin.
80. Në periudhën e kaluar ishte paraparë Programi i këshillimit të prindërve dhe Programi i këshillimit të nxënësve.

81. Në vitin 2013 nisi zbatimi i sistemit të kontrollit nga jashtë të arritjeve të nxënësve (testimi ekstern) në të gjitha lëndët nga klasa IV deri në klasën IX. Para përfundimit të vitit shkollor 2016/2017 u ndërpre testimi ekstern.
82. Shkollat fillore të Maqedonisë kanë marrë pjesë në këto testime ndërkombëtare:
- studimi rreth përparimit në shkrim-lexim dhe lnë të lexuarit në shkallë ndërkombëtar (PIRLS), për vlerësimin e përgatitjes së nxënësve të moshës 9-10 vjeçe për të lexuarit dhe të kuptuarit (viti 2006);
 - studimi për trendet në mësimin e matematikës dhe të shkencave natyrore në nivelin ndërkombëtar (TIMSS) për matjen e diturive dhe aftësive në matematikë dhe shkencë natyrore të nxënësit e klasës VIII (viti 2011).
83. Në vitin 2015 është hartuar Ligji për mësuesit në shkollën fillore dhe të mesme për të përcaktuar standardet profesionale për stafin mësimdhënës dhe për zhvillimin e karrierës.
84. Nga shtatori i vitit 2015 MASH-i siguron mbështetje praktike për nxënësit romë të cilët janë klasa e IV, V dhe VI në arsimin fillorë të Republikës së Maqedonisë. Mbështetje arsimore shtesë japin edhe studentët praktikantë nga fakultetet pedagogjike në Republikën e Maqedonisë.

5.2.2. Sfidat

85. Vihen në pah edhe një numër i caktuar sfidash në fushën e arsimit fillor:
1. Të arriturat e arsimore të nxënësve janë mjerisht ulët, siç vërehet nga rezultatet e testimeve ndërkombëtare.
 2. Mungojnë standardet që do t'i përcaktonin rezultatet e të nxënësve në çdo cikël (I, II, III) të arsimit fillor, plani mësimor është i mbingarkuar, kurse programet mësimore nuk janë sa duhet relevante për mjedisin lokal. Më saktësisht, mund të vihet re se në më shumë shkolla nuk bëhet sa duhet dhe ashtu si duhet lënda Arsimi për shkathtësitë jetësore (ASHJ) dhe edukimi civil, kurse shkathtësitë sipërmarrëse shënojnë shkallë të ulët si të nxënësit, ashtu edhe të mësimdhënësit.
 3. Në shkollat ku mësimi zhvillohet në disa gjuhë nxënësit janë të ndarë sipas gjuhës në të cilën mësojnë (punojnë me turne, në objekte a në kate të ndryshme, me administratë të ndryshme etj.), prandaj nuk kanë mundësi të mjaftueshme ndërveprimi, nuk është përfshirë sa duhet arsimi shumëkulturore / ndërkulturore në veprimtaritë mësimore dhe ato jashtë mësimin, si dhe në disa tekste. Vetë arsimtarët nuk promovojnë respektin e duhur lidhur me të qenit i ndryshëm dhe i njëjtë (lidhur me përkatësinë gjinore apo etnike, statusin shoqëror, intelektual dhe aftësitë fizike) si dhe multikulturalizimin.
 4. Nuk janë të mjaftueshme masat për tejkalimin e ndarjeve në vija etnike nëpër shkolla, kurse segregacioni në shkolla ndikon në kohezionin shoqëror dhe në integrimin ndërveprues.
 5. Mungon mekanizmi që siguron të dhëna etnike segregative për fëmijët e moshës shkollore që nuk janë përfshirë në sistem për shkaqe të ndryshme, me një shpjegim të zakonshëm se pengesa është në mbrojtjen e të dhënave personale, megjithatë rregulloret ligjore nuk pengojnë grumbullimin e të dhënave në baza etnike me qëllim të përmirësimit të gjendjes së sistemit arsimor.
 6. Një numër i madh i nxënësve romë janë jashtë sistemit arsimor. Ekziston gjithashtu një përqindje e lartë e braktisjes së arsimit dhe shkallës së ulët të shkrim-leximit të fëmijëve me përkatësi etnike

- rome. Arsye më të shpeshta për këtë situatë janë: njohja e pamjaftueshme e gjuhës maqedonase, niveli i ulët i arsimit të prindërve dhe statusi i dobët socio-ekonomik.
7. Fëmijët me nevoja të veçanta arsimore nuk janë të kyçur sa duhet në arsimin e rregullt fillor. Përfshirja e tyre në shkollat e rregullta nuk është e rregulluar në masën e duhur, por edhe nuk janë kyçur mekanizmat përkatës për këtë çështje. Përveç kësaj ka edhe paragjykime ndaj këtyre fëmijëve, prindërve, arsimtarëve dhe nxënësve. Gjithashtu, arsimtarët nuk i zotërojnë kompetencat duhura për të punuar me këtë kategori nxënësish.
 8. Mungojnë zgjidhje sistemore përkatëse për identifikimin dhe punën me nxënësit e talentuar.
 9. Të miturit që ndodhen në institucionet edukative-përmirësuese janë të përjashtuar nga sistemi i arsimit fillor, prandaj edhe integrimi i tyre në shoqëri është i penguar. Nuk ekziston një sistem efektiv për edukimin, koordinimin e aktiviteteve dhe monitorimin e këtyre kategorive të fëmijëve.
 10. Nuk ka sa duhet materiale didaktike dhe burime didaktike që mësimi të zhvillohet në të gjitha gjuhët mësimore (në këtë përfshirje bëjnë pjesë edhe teknologjitë ndihmëse për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore), kabinetet e specializuara për lëndë të caktuara nuk janë të furnizuara sa duhet me mjete ndihmëse mësimore. Shumica e shkollave shumë pak janë të furnizuara me mjete mësimore për mësimin lëndor, por edhe me pajisje plotësuese TIK (bie fjala, projektor LCD, tabela të zgjuara – smart bord etj.). Metodrat dhe teknikat bashkëkohore mësimore nuk zbatohen sa duhet në praktikë. Ende nuk ka një platformë elektronike arsimore për të nxënësit.
 11. Një pjesë paralelesh kanë numër shumë të madh nxënësish, kurse në disa komuna nuk është miratuar ende rajonizimi i cili nuk është një nga faktorët më të fortë për segregimin në arsimin fillor. Kjo çështje bëhet edhe më e ndërlikuar nga shkak i mospërfilljes së normave për mjedis shkollor të rehatshëm e të sigurt në shumë shkolla.
 12. Sa i përket kontrollit të cilësisë, mungojnë informacionet e vazhdueshme valide për sistemin kombëtar të arsimit në perspektivën ndërkombëtare. Sistemi i testimit ekstern, i zbatuar gjatë viteve 2013-2017, nuk i ka ndjekur në tërësi standardet e vlerësimit të të arriturave të nxënësve; vlerësimi i cilësisë së programeve mësimore dhe vlerësimi i të arriturave të nxënësve nuk sigurojnë konsistencë lidhur me të gjithë faktorët relevantë. Metoda e zbatimit të testit ekstrern ka devijuar përqendrimin e mësimdhënies dhe mësim nxënies duke u bazuar në mësim përmendësh të informacioneve, sesa në kuptimin e thelbit dhe lidhjen e dukurive. Sipas asaj që thotë një numër i madh pjesëmarrësish në procesin arsimor, ende i kushtohet rëndësi e madhe planifikimit formal dhe përpilimit të raporteve, edhe pse fokusi duhet të përqendrohet në realizimin e procesit arsimor dhe në arritjen e rezultateve në mësim.
 13. Nuk realizohet orientimi profesional dhe i karrierës. Shpeshherë përmbajtja të cilën nxënësit janë duke e mësuar nuk kanë të bëjnë me jetën reale dhe jetën profesionale pra ata nuk marrin informacione të mjaftueshme dhe relevante për to, sidomos për profesionet teknike, por nuk marrin as mbështetje për zgjedhjen e shkollave dhe profileve profesionale që kërkohen në tregun e punës.
 14. Shërbimet profesionale nuk janë të kompletuara me të gjithë bashkëpunëtorët e nevojshëm profesionalë, edhe pse në dy vitet e kaluara është punësuar nëpër shkolla fillore një numër i madh i psikologëve, pedagogëve dhe edukatorëve specialë. Një pjesë e madhe e stafit të shërbimit profesional orët e punës i kalojnë në aktivitete administrative për shkollën, jo në lidhje me profilin e tyre profesional. Prandaj edhe pse shkollat kanë shërbime profesionale, në praktikë, nxënësit dhe mësuesit nuk marrin mbështetje të mjaftueshme nga këto shërbime profesionale nga ekspertiza e tyre primare. Në disa raste shërbimet profesionale nuk ndjekin strukturën etnike në shkollat shumëgjuhëshe.
 15. Palët e ndryshme kryesore të interesuara nuk janë të informuara plotësisht dhe nuk përfshihen në proceset reformuese; veprimtaritë nismat për projekte janë të paqëndrueshme në masën më

të madhe. Kësisoj, futen risi pa u bërë pilotimi dhe pa u vlerësuar efektet e tyre. Mbështetja për pjesëmarrje demokratike të nxënësve është e pamjaftueshme në më shumë shkolla.

16. Formulari ekzistues për financimin e arsimit fillor duhet të rishikohet për të përfshirë një zhvillim komponent që do të financojë zhvillimin profesional të mësuesve dhe do të mundësojë futjen e metodave novatore të punës me nxënësit, zbatimin e hulumtimit të aksionit, zbatimin e projekteve zhvillimore me qëllim të përmirësimit të procesit të mësimdhënies, duke forcuar bashkëpunimin me prindërit dhe aktivitete tjera të ngjashme.

5.2.3. Përparësitë dhe përfundimet e pritshme

86. Përparësitë strategjike të zhvillimit të arsimit fillor gjatë periudhës deri në vitin 2025 dhe rezultatet përkatëse të tyre do të jenë si vijon (të sqaruara në detaje, duke përfshirë masat, aktivitetet dhe indikatorët në shtyllat përkatëse në Planin e Veprimit):

Përparësia I. Përmirësimi i përmbajtjes së arsimit fillor

- 1.1. Rezultatet e të nxënit për çdo cikël të arsimit fillor janë të përcaktuara qartë dhe kanë rëndësi për gjendjen dhe nevojat reale të nxënësve në pajtim me moshën dhe karakteristikat e tyre.⁴⁶
- 1.2. Arsimi fillor ndihmon për zhvillimin kompetencave kyçe dhe të përgjithshme si aftësia e nxënësve për të për të menduar kritik dhe për të zgjidhur probleme, për t'i respektuar dallimet dhe multikulturalizmin dhe për t'u pajisur me vlera e shkathtësi demokratike;
- 1.3. Planet dhe programet mësimore për të gjitha klasat janë të orientuara nga arritja e rezultateve nga të nxënit që janë të përcaktuara me Standardin në shkallë kombëtare;
- 1.4. Nxënësit fitojnë dituri dhe kompetenca më gjera sipas interesave të tyre dhe që janë të rëndësishme për mjedisin lokal;
- 1.5. Nxënësit në arsimin fillor kanë tekste cilësore dhe aktuale si zgjedhje e diturive të zbatueshme që promovojnë të drejta njerëzore, respektim të dallimeve dhe vlera demokratike.

Përparësia II. Rritja e përfshirjes së nxënësve dhe përmirësimi i gjithëpërfshirjes e integritetit ndëretnik në arsimin fillor.

- 2.1. Janë krijuar kushte fizike të domosdoshme për gjithëpërfshirjen e nxënësve me pengesa fizike;
- 2.2. Shkollat paraqesin mjedis gjithëpërfshirës për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore të cilëve u ofrohet mbështetje të plotë;
- 2.3. Është përmirësuar efikasiteti i financimit të proceseve të gjithëpërfshirjes dhe të nxënit për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore;
- 2.4. Është përmirësuar ndërveprimi midis nxënësve që ndjekin mësimin në gjuhë të ndryshme;
- 2.5. Është përmirësuar mësimdhënia në gjuhët më pak të përfaqësuara, duke përfshirë mësimin e lëndëve për mësimin e gjuhës dhe kulturës së komuniteteve që ndjekin mësimet në gjuhë tjetër nga gjuha e tyre amtare.

⁴⁶ Gjatë përcaktimit të rezultateve të të nxënit duhet pasur kujdes për përfshirjen e shkathtësive sipërmarrëse në pajtim me Strategjinë e të nxënit sipërmarrës në RM 2014-2020.

- 2.6. Janë siguruar kushte për fëmijët që ndodhen në institucione edukative-përmirësuese që ta vazhdojnë (përfundojnë) arsimin fillor.
- 2.7. Janë identifikuar, përfshirë e monitoruar personat të cilët duhet ta kryejnë arsimin e tyre deri në atë që është obligator.

Përparësia III. Përmirësimi i kushteve të nxënies dhe cilësia e realizimit të arsimit fillor

- 3.1. Janë krijuar kushte të përmirësuara për të nxënësit që mundësojnë kujdes më të madh për çdo nxënësi;
- 3.2. Është përmirësuar efikasiteti i procesit të zhvillimit të mësimin pa marrë parasysh gjuhën në të cilën zhvillohet ai.
- 3.3. Janë përmirësuar të arriturat e nxënësve në matematikë dhe shkencë natyrore;
- 3.4. Shkolla paraqet mjedis të sigurt për mësim në të gjitha aspektet, si për arsimtarët, ashtu edhe për nxënësit (objektet për zhvillimin e mësimin, objektet ndihmëse, pajisjet për ushtrime dhe materialet, teknologjitë ndihmëse për nxënësit me nevojë të veçanta arsimore, standardet e ushqimit);
- 3.5. Nxënësit janë të informuar më mirë para vendosjes për të vazhduar shkollimin pas përfundimit të arsimit fillor;
- 3.6. Është rritur pjesëmarrja demokratike e nxënësve në shkollë;
- 3.7. Njoftimet prapavepruese nga të gjitha vlerësimet për të arriturat e nxënësve mundësojnë të merren vendime rreth politikave arsimore të bazuara në dëshmi;
- 3.8. Janë siguruar të dhëna empirike për mësimin e matematikës dhe për mësimin e shkencave natyrore të nxënësit në arsimin fillor në përputhje me perspektivat ndërkombëtare.

Përparësia IV. Përmirësimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore në shkollat fillore

- 4.1. Është ngritur cilësia e arsimtarëve të ardhshëm;
- 4.2. Arsimtarët praktikantë kanë fituar kompetencat që kërkohen sipas standardeve profesionale dhe kombëtare;
- 4.3. Arsimtarët dhe bashkëpunëtorët profesionalë praktikantë marrin përkrahjen e domosdoshme për punën e tyre të përditshme;
- 4.4. Arsimtarë janë të motivuar për të arritur rezultate më të mira në vendin e punës;
- 4.5. Kompetencat profesionale të arsimtarëve përmirësohen vazhdimisht;
- 4.6. Nxënësit dhe arsimtarët marrin mbështetje të vazhdueshme nga shërbimet profesionale.

Përparësia V. Rritja e efektivitetit në organizimin dhe administrimin e arsimit fillor

- 5.1. Ndikimi i përmirësuar dhe qëndrueshmëria e inovacioneve të përfshira në arsimin fillor.
- 5.2. Drejtorët e shkollave fillore plotësojnë kërkesat minimale për kompetencat profesionale, duke siguruar një mjedis më të mirë mësimi dhe kulture, menaxhimi dhe udhëheqje.

5.3

ARSIMI I MESËM I PËRGJITHSHËM (GJIMNAZET, SHKOLLAT E ARTEVE DHE SHKOLLAT PËR NXËNËSIT ME NEVOJA TË POSAÇME ARSIMORE)

5.3.1. Pasqyra e gjendjes nga aktivitetet e deritanishme

87. Nga viti shkollor 2007/2008, arsimi i mesëm është i obliguar për çdo qytetarë me kushte të barabarta të konstatuara me Ligjin për arsimin e mesëm dhe në përputhje me këtë kërkesë është harmonizuar me politikën e regjistrimit në shkollat e mesme. Me këtë ligj mundësohet qasshmëria horizontale dhe vertikale. Me qëllim të mundësohet qasshmëri cilësore për të gjithë nxënësit, janë siguruar libra shkollorë dhe transport falas si dhe akomodim falas në internatet për nxënës.
88. Me qëllim të promovimit të arsimit sipërmarrës në përputhje me ecuritë bashkëkohore, janë përgatitur programe mësimore për dy lëndët e obligueshme të arsimit të mesëm në shkollat e gjimnazit dhe shkollat e mesme të artit: biznes dhe sipërmarrje (për vitin IV), inovacione dhe sipërmarrje (për vitin I, II dhe të III). Për mësimin e gjuhës angleze si gjuhë të parë të huaj dhe gjuhës gjermane, frënge dhe ruse si gjuhë të dytë të huaj, janë aprovuar programe të reja arsimore për vitin e I, II, III dhe vitin e IV të arsimit të mesëm. Gjithashtu, është miratuar edhe program arsimor për lëndën e re të obligueshme lënda Gjuhët Programore për vitin e III, drejtimi i gjimnazit, si dhe kanë rifilluar Programet mësimore për lëndët zgjedhore, Algjebër, Algjebra lineare dhe Gjeometri analitike për vitin e III të drejtimit të gjimnazit. Ndryshime ka edhe në programet mësimore për shkollat e mesme të artit.
89. Janë analizuar Programet mësimore për arsimin e mesëm sipas përfaqësimit të multikulturalizmit për qëllimet dhe përmbajtjet. Është përgatitur program mësimor për arsimin për shkathtësi të jetës dhe doracak për realizimin e tij në orët klasike.
90. Me qëllim të promovimit mjedis të shëndetshëm dhe të sigurt për të nxënë dhe për tu zvogëluar dhuna, të promovohen të drejtat e nxënësve, vlerat demokratike, liritë dhe diversitetet, është zbatuar numër i caktuar i aktiviteteve jashtë arsimore nëpërmjet Plan veprimit për komunat dhe Qytetin e Shkupit.
91. U formua Akademia e Sportit dhe janë përgatitur plane mësimore dhe programe për futboll, basketboll, hendboll dhe tenis.
92. U miratua Ligj i posaçëm për librat shkollorë për arsimin fillor dhe të mesëm dhe më shumë akte nënligjore me të cilat krejtësisht rregulloret procedura për miratimin dhe publikimin e librave shkollorë, janë miratuar nënakte ligjore të duhura dhe u formua Komisioni nacional për libra shkollorë. Mirëpo, të gjitha këto më lartë kanë mangësi dhe paraqesin sfidë të veçantë për reformat e ardhshme.

93. Nga janari i vitit 2013 deri në janar të vitit 2017 në të gjitha shkollat e mesme zbatohet sistemi i kontrollit të jashtëm të arritjeve të nxënësve sipas të gjithë lëndëve.
94. Nëpërmjet procesit të decentralizimit sigurohen mjete për financimin e plotë të shkollave. Ky sistem është i bazuar në shpërndarjen racionale të destinuar me bllok dotacione dhe mjete plotësues nga buxheti i komunave dhe Qytetit të Shkupit. Është investuar edhe në përforcimin e kapaciteteve të komunave dhe Qytetit të Shkupit për menaxhimin e dhe kryesimin e shkollave të mesme, sidomos nga aspekti i financimit, përcjellje dhe përshtatjen e buxhetit të shkollave.
95. Nga viti 2008 u aprovua Matura shtetërore në shkollat e mesme drejtimi i gjimnazit dhe drejtimi profesional me kohëzgjatje 4 vjeçare, kurse nga viti 2009 edhe në shkollat e mesme të artit. Me Maturën shtetërore pritet të sigurohet kontrolli i cilësisë së shkollave të mesme, të përcillet realizimi i Programeve mësimore, përfundimi i arsimit të mesëm me diplomën e duhur dhe të ndihmojë gjatë përzgjedhjes në arsimin universitar.
96. Që të lehtësohet mësimi i matematikës në arsimin e mesëm, është hartuar doracak për matematikë për nxënësit e moshës 15-16 vjeç, për prindërit dhe mësimdhënësit e tyre.
97. Janë bërë ndryshime të Ligjit për arsimin e mesëm, me të cilin rregullohet vetëvlerësimi dhe përpunimi i Planit të zhvillimit të shkollave, por është aprovuar edhe evalvim integral që e zbaton ISHA. U aprovua një test profesional për mësimdhënësit, duke përfshirë edhe dhënie të obligueshme të testit të personalitetit për kuadrin mësimdhënësit i cili u kundërshtua nga publiku i ekspertëve.
98. Politikat e MASH-it gjithëpërfshirja e nxënësve me nevoja të posaçme arsimore në procesin e rregullt arsimor parashohin:
- Hartimin e planeve individuale;
 - Formimi i ekipit gjithëpërfshirës në shkollat e mesme;
 - Ekipimi i shërbimit profesional të pedagogëve, psikologëve dhe edukatorëve special;
 - Përdorimi i pajisjeve ndihmëse dhe ndërtimin e rampave me qasshmëri nëpër shkolla.
99. Janë hartuar plane dhe programe të reja arsimor të përshtatura për nxënësit me shikim dhe dëgjim të dëmtuar. Me këtë masë nxënësve me aftësi të kufizuara më të lehtë pas përfundimit të vitit të IV iu mundësohet t'i nënshtrohen provimit të Maturës shtetërore të përshtatur dhe të vazhdojnë arsimin në institucionet e arsimit të lartë të vendit dhe jashtë shtetit.
100. Nga viti 2009 janë siguruar bursa dhe mentorim/ tutor për nxënësit romë. Kjo nismë ka për qëllim të avancojë suksesin e nxënësve romë nga të gjitha vitet arsimore, në të gjitha shkollat e mesme publike dhe private. Me qëllim të stimulit të nxënësve romë për të vazhduar arsimin e vet në shkollat e mesme, janë ulur kriteret për regjistrimin e pjesëtarëve të këtij komuniteti etnik. Janë siguruar bursa për nxënësit romë nga familjet me rrezik social, të cilët rregullisht vijojnë mësimin, si dhe bursa për nxënësit nga grupet e rrezikuara, nxënësit e talentuar, sportistët, fëmijët pa prindër dhe fëmijët me nevoja të posaçme arsimore.
101. Për nxënësit që kanë marrë çmime në nivel shtetëror dhe gara ndërkombëtare në matematikë dhe në lëndët e shkencave natyrore janë ndarë shpërblime të veçanta. Nga viti shkollor 2016/2017, janë paraparë shpërblime në mjete financiare për nxënësit që do të fitojnë medalje të artë, të argjendte, të bronzte në ndonjërin nga 13-të olimpiadat ndërkombëtare shkencore për nxënësit e shkollave të mesme. Shpërblimi i arkëtohet edhe mësimdhënësit – mentorit të nxënësit.
102. Me qëllim të zvogëlimit të paragjykimeve etnike dhe të përmirësohet njohja e kulturës së nxënësve nga grupet e ndryshme etnike, disa nga shkollat zbatojnë aktivitete të përbashkëta me nxënës që ndjekin mësimin në gjuhë të ndryshme të mësimdhënies. Për këtë qëllim janë themeluar ekipe për integrimin e

shkollave, për të koordinuar dhe organizuar aktivitetet e përbashkëta të nxënësve dhe bashkëpunimin e prindërve.

103. Në vitin 2000 dhe 2015, shkollat e mesme të Republikës së Maqedonisë morën pjesë në Programin për vlerësimin ndërkombëtar të nxënësve (PISA), me të cilën matet sesa nxënësit të moshës 15 vjeç janë të aftë për të lexuar dhe kuptuar, sa kanë njohuri matematikore dhe të fushave të shkencave natyrore.
104. Aktivitete të tjera të rëndësishme në sektorin e arsimit të mesëm janë:
- Hartimi dhe zbatimi i Programit për këshillimin e prindërve dhe Programit për këshillimin e nxënësve.
 - Promovimin e këshillimit të karrierës për nxënësit në shkolla, nëpërmjet hapjes së qendrave të karrierës në të cilat punojnë këshilltarë të karrierës dhe janë pjesë e stafit mësimdhënës nëpër shkolla.

Në vitin 2015 u hartua ligji për mësuesit në arsimin fillor dhe të mesëm për të përcaktuar standardet profesionale për stafin mësimdhënës dhe zhvillimin e karrierës.

5.3.2. Sfidat

105. Analiza e situatës kontribuoi për realizimin e sfidave vijuese në fushën e arsimit të përgjithshëm:
1. Planet mësimore janë të mbingarkuara dhe akoma ka programe mësimore të vjetërsuara që nuk mundësojnë zhvillim të vazhdueshëm kognitiv socio-emocional i nxënësve, nuk lejojnë qasje të integruar për mësimin e dukurive, nuk zhvillojnë kompetenca të mjaftueshme të përgjithshme e kyçe, nuk përkrahin qasjen bashkëkohore për zhvillimin e të nxënësve dhe nuk pasqyrojnë proceset aktuale sociale.
 2. Një pjesë e librave shkollorë janë vjetërsuar dhe përmbajnë stereotipe, paragjykimë dhe stigmatizime ku mungojnë elementet e bashkë-ekzistencës, respektimi i diversiteteve, integriteteve, multikulturalizmit dhe në mënyrë plotësuese komplikohet me legjislacionin demotivues për përpunimin dhe revidimin e librave shkollorë. Zhvillimi dhe pasurimi i teksteve shkollorë me përmbajtje shtesë është një proces i ngadalshëm dhe i gjatë dhe nuk plotëson nevojat e stafit mësimdhënës lidhur me përmbajtjet më të fundit në fusha të caktuara, gjë që kontribuon në procesin e mësimin të vjetruar.
 3. Arsimi multikulturor-interkulturor nuk është i pasqyruar në aktivitetet mësimore ose jashtë mësimore. Ekzistojnë barrierat që pengojnë integrimin e nxënësve të cilët mësojnë në gjuhë të ndryshme nga gjuha amtare; nxënësit të cilët mësojnë në gjuhë tjetër në shkolla ku mësimi mbahet në disa gjuhë, zakonisht janë në turne të ndara, godina, kate, madje edhe administratë shkollorë të ndarë. Njëkohësisht, motivimi i shkollave dhe mësimdhënësve për sigurimin e arsimit integritet interetnik dhe arsimit gjithpërfshirës është shumë më i ulët, për shkak të mungesës së motivimit dhe përkrahjes financiare.
 4. Disperzioni i shkollave të mesme është i papërshtatshëm (me qasje shumë të dobët nëpër shkollat e rajoneve) që paraqet problem plotësues për numrin e madh të nxënësve (deri 40 nxënës në paralele) në disa nga shkolla apo numrin tepër të vogël në tjera.
 5. Qasja fizike (objektet, pajisjet për ushtrime dhe pajisjet e tjera) dhe qasja didaktike dhe metodologjike është shumë e dobët në shumë shkolla të mesme; kushtet për inkluzion të nxënësve me aftësi të posaçme arsimore janë jashtëzakonisht të kufizuara, duke marrë parasysh se një numër i madh

nxënësish me nevoja të veçanta arsimore kanë arritje më të ulëta, mundësitë e tyre për regjistrim në arsimin e mesëm të përgjithshëm janë shumë të vështira dhe të kufizuara.

6. Mësimdhënësit nuk marrin praktikën e nevojshme për përgatitjen e trajnimeve iniciues ose praktikës së përgjithshme; testi i personalitetit i imponuar ligjërisht është i pajustificuar dhe i diskutueshëm në aspektin e aktivitetit psikologjik dhe është i prirur për keqpërdorim, por gjithashtu ka shkaktuar kundërthënie dhe pakënaqësi të shumta me mësuesit; nuk ka profesionalizëm të mjaftueshëm dhe neutralitet politik te drejtorët e shkollave; shërbimet profesionale nuk janë mjaftueshëm të ekipuara sipas nevojave të shkollave (p.sh sipas numrit të nxënësve, gjuha në të cilën zhvillohet mësimi), dhe njëkohësisht pjesa më e madhe e kohës kalohet në aktivitete të përditshme administrative shkollore se sa në fushën ekspertizës; faktori i fundit rezulton me cilësi të dobët ose qasje të kufizuara të këtyre shërbimeve, siç është përkrahja e nxënësve me nevoja të veçanta arsimi, këshillimi për karrierën ose orientimin dhe udhëzimin e nxënësve të talentuar.
7. Vlerësimi i cilësisë së Planit dhe programit mësimor dhe vlerësimi i nxënësve nuk janë konsistentë në kuptimin e të gjithë faktorëve relevantë.
8. Reformat në fushën e arsimit, në drejtimin e gjimnazit jo gjithmonë janë koherente-konsistente me reformat në arsimin fillor, për shkak të cilave transferimi i nxënësve nga shkolla fillore në shkollë të mesme është jashtëzakonisht stresues dhe reflekton negativisht në qëndrimin e tyre ndaj të mësuarit dhe arritjes së rezultateve.
9. Përkrahja për pjesëmarrje demokratike të nxënësve vazhdimisht mbetet e pamjaftueshme.
10. Mungojnë informacione të vazhdueshme të vlefshme për sistemin nacional arsimor në perspektivat ndërkombëtare.

5.3.3. Përparësitë dhe rezultatet e pritshme

106. Përparësitë e tjera që janë përfshirë për periudhën deri në 2025 (të sqaruar në detaje, duke përfshirë masat, aktivitete dhe indikatorët në shtyllën e duhur në Planin e Veprimt) dhe duhet t'i sigurojnë këto rezultate të dëshiruara.

Përparësia I, përmirësimi i përmbajtjes së arsimit të mesëm

- 1.1 Rezultatet nga të nxënësit të arsimit të mesëm janë definuar qartë dhe janë të rëndësishëm për situatën reale dhe nevojat e nxënësve në përputhje me moshën dhe karakteristikat e tyre dhe Përparësitë për zhvillimin shoqëror të Republikës së Maqedonisë⁴⁷;
- 1.2 Arsimi i mesëm kontribuon për njohurit e të drejtave të njeriut, të respektohet diversiteti dhe vlerat demokratike nga nxënësit;
- 1.3 Të gjitha planet dhe programet mësimore janë drejt arritjes së rezultateve nga të nxënësit, të cilat janë përcaktuar me Standardet nacionale dhe të sigurojnë vazhdimësi në arsimin fillor;
- 1.4 Nxënësit e arsimit të mesëm aktualisht kanë libra shkollorë cilësorë si burim i diturisë moderne dhe relevante dhe si vegël për promovimin e të drejtave të njeriut, respektimin e diversitetit dhe vlerave demokratike;

⁴⁷ Gjatë definimit të rezultateve nga të nxënësit do të duhet të bëjmë kujdes në përfshirjen e shkathtësive sipërmarrëse, në përputhje me Strategjinë për përmirësimin e sipërmarrjes në RM 2014-2020.

Përparësia II. Rritja e përfshirjes së nxënësve dhe rritja e gjithëpërfshirjes dhe integritimit ndëretnik në arsimin e mesëm.

- 2.1. U aprovuan kushte fizike për tu përfshirë nxënësit me aftësi të kufizuara fizike;
- 2.2. U aprovua bazë e administratës dhe informacionit për sigurimin e arsimit gjithëpërfshirës;
- 2.3. U avancuan interaksionet ndërmjet nxënësve të cilët mësimin e zhvillojnë në gjuhë të ndryshme;
- 2.4. U siguruan kushte që nxënësit të cilët gjenden në shtëpitë korrigjuese-edukuese ta vazhdojnë (përfundojnë) arsimin e mesëm të përgjithshëm.

Përparësia III, Avancimi i kapaciteteve të resurseve humane në shkollat e mesme

- 3.1. Kompetencat profesionale të mësimdhënësve vazhdimisht avancohen; Mësimdhënësit motivohen të arrijnë rezultate më të mira;
- 3.2. Të gjithë drejtorët e shkollave të mesme i plotësojnë kërkesat minimale për kompetenca profesionale;
- 3.3. Arsimi shoqërohet tërësisht me shërbime profesionale të domosdoshme për proces cilësor të të nxënësve dhe zhvillimit të nxënësve;
- 3.4. Mësimdhënësit fillestarë marrin përkrahjen e domosdoshme për punën e tyre të përditshme.

Përparësia IV. Avancimi i kushteve të të nxënësve dhe cilësia e arsimit

- 4.1. U aprovuan kushte më të mira për mësim të cilët mundësojnë që çdo nxënës të merr vëmendjen e duhur;
- 4.2. Objektet shkollore dhe koha e nxënësve pas përfundimit të orëve të shfrytëzohet në mënyrë më efektive;
- 4.3. U rrit participimi demokratik i nxënësve në shkollë;
- 4.4. Informacionet kthyes nga të gjitha vlerësimet e suksesit të nxënësve mundësojnë të merren vendime për politikën në bazë të dëshmive;
- 4.5. Janë siguruar të dhëna empirike të vlefshme për aftësimin e nxënësve të moshës prej 15 vjeç (krahasuar me perspektivat ndërkombëtare) për hyrje në jetë dhe vazhdimin e arsimit ose përfshirjen në tregun e punës;
- 4.6. Nxënësit e talentuar kanë mundësi për zhvillimin e potencialeve të tyre.

5.4

ARSIMI DHE TRAJNIMI PROFESIONAL

5.4.1. Pasqyra e gjendjes dhe veprimitaritë e deritanishme

107. Institucioni publik kryesor kompetent për sigurimin e përkrahjes profesionale për zhvillimin dhe rinovimin e vazhdueshëm në sistemin për APT është Qendra për Arsim dhe Trajnim Profesional, e themeluar në vitin 2007. Lëndët e përgjithshme arsimore të shkollave të mesme profesionale janë përgjegjësi e BZha-së.
108. U firmos Memorandum bashkëpunimi ndërmjet QAPT-së dhe institucioneve dhe organizatave nga Republika e Maqedonisë dhe jashtë vendit, të bazuara në Protokollin për partneritet social dhe Kornizën për partneritet social, me qëllim të intensifikimit të bashkëpunimit me të gjitha palët kryesore të interesit që do të përfshihen në gjetjen e zgjidhjeve dhe hartimin e dokumenteve të rëndësishme për arsimin dhe trajnimin profesional.
109. U përgatitën Standarde për realizimi e trajnimit praktik të nxënësve me punëdhënësit, u realizua plan programi mësimor për trajnimin profesional – didaktik të trajnerëve nga kompanitë ku do të zhvillohet trajnimi praktik dhe janë realizuar disa trajnim e të mentorëve nga kompanitë të cilat do t'i udhëheqin nxënësit në realizimin e qëllimeve të orëve praktike
110. Në vitin 2015 filloi era e re e modernizimit të ATP-së për shkollat e mesme nëpërmjet projektit “Zhvillimi i shkollave të mesme dhe përkrahja e inovacioneve”. Kjo nismë është e drejtuar drejt reformimit të arsimit 4 vjeçar teknik dhe përfshirjes së mekanizmave për reagimin e shpejtë të nevojave të tregut të punës. Rezultatet e tjera të pritshme nga ky projekt janë: analiza e nevojave të sistemit për ATP-në dhe dhënien e rekomandimeve për reformën e tij strukturore; Rezultatet e tjera të pritshme nga ky projekt janë: analiza për nevojat e sistemit të ATP-së dhe dhënia e rekomandimeve për strukturën e tij reformuese; përpunimi i Konceptit për arsimin teknik në Republikën e Maqedonisë; metodologjia për ndërtimin e Standardeve të profileve të profesioneve, revidimi i Standardeve të profileve ekzistuese dhe atyre të reja; Metodologjia e përpunimit të Standardeve kualifikuese dhe programeve mësimore dhe planeve të bazuara në rezultatet nga të nxënësit; përgatitja e metodologjisë dhe instrumenteve për analizimin e rrjetit të shkollave të mesme profesionale në Republikën e Maqedonisë; vlerësimi i rrjetit të shkollave të mesme profesionale, programit dhe materialeve për trajnim të mësimdhënësve dhe drejtorëve të shkollave të mesme, si dhe kryerjen e vlerësimit të nevojave për furnizimin e shkollave dhe kabineteve për mësimin praktik.
111. Është hartuar metodologji për përpunimin e Standardeve të profileve në vitin 2009 dhe u ndryshua në vitin 2017, me çka është vendosur bazë nëpërmjet të cilës janë definuar njohurit dhe shkathtësitë nevojshme për një profil të caktuar. Në këtë mënyrë lehtësohet edhe hartimi i programeve në arsimin dhe trajnimin profesional formal dhe joformal. Deri më tani janë hartuar më së paku 90 standarde të profileve. Mirëpo,

proceset e reformave të deritanishme të APT-së nuk kanë qenë krejtësisht të koordinuara dhe zbatuara me plan.

112. Janë hartuar plane dhe programore për arsimin e mesëm profesional të reformuar, si dhe për standarde profesionale dhe të kualifikimit. Paralelisht me këtë mësimdhënësit me APT-në u trajnuan në temat siç janë : shfrytëzimin e metodave, përfshirjen aktive të nxënësve dhe stimulimin e kreativitetit të tyre. Kontribut të rëndësishëm ndaj këtyre avancimeve u realizua nëpërmjet projekteve “Përkrahje për modernizim të sistemit të arsimit dhe trajnimit” dhe “Forcimi i të mësuarit gjatë gjithë jetës përmes modernizimit të APT-së dhe sistemit të arsimit të të rriturve”. Rezultatet e prodhuara janë standarde të reja profesionale, standarde të kualifikimit, si dhe programe mësimore dhe programe që plotësojnë nevojat e Tregut të punës.
113. Në arsimin e mesëm profesional gjuha angleze mësohet si gjuhë e parë e huaj, kurse gjermanishtja, frëngjishtja dhe rusishtja ofrohen si gjuhë të dyta të huaja në disa profile. Për këtë janë aprovuar programe të reja arsimore për vitin e I, II, III dhe vitin e IV të arsimit të mesëm. Pikënisja bazë e hartimit të programeve të reja arsimore është Korniza Evropiane e përbashkët e referimit për gjuhët, si orientim në raport me nivelin e kompetencave gjuhësore të cilat nxënësit do duhet t’i fitojnë deri në fund të çdo viti shkollor nga arsimi i mesëm.
114. Për lehtësimin e të nxëniet të lëndës së matematikës në arsimin e mesëm, është e hartuar doracak për matematikë për nxënësit e moshës 15-16 vjeç, dhe për prindërit dhe mësimdhënësit e tyre. U mbajtën trajnime për mësimdhëniet, të cilëve iu prezantua programi i provimeve dhe qëllimeve të lëndës së matematikës për Maturën shtetërore dhe njëkohësisht iu ofrua material për nxënësit që të jenë më të suksesshëm në dhënien e provimit.
115. Me qëllim të sigurimit të orientimit të karrierës së nxënësve nëpër shkolla janë hapur qendrat e karrierës në të cilat punojnë këshilltarë të trajnuar të karrierës që janë pjesë e stafit të mësimdhënësve të shkollave. Puna e tyre është përkrahur me zhvillimin e veglës të standardizuar- Bateria e instrumenteve për orientim profesional (BIOP). Nuk ka qendra të karrierave dhe këshilltarë për karriera në shkolla. Mësimdhënësit të cilët punojnë si këshilltarë karrierash janë ato të cilët kanë marrë trajnime nga projektet e USAID-it.
116. Për të rritur cilësinë e stafit mësimdhënës u përfshinë kompetencat profesionale për mësuesit, bashkëpunëtorët profesionalë dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat profesionale të mesme të cilat u përfshinë në realizimin e mësimin praktik të nxënësve. Për tu ngritur cilësia e stafit mësimdhënës për mësimdhënësit e rinj, është aprovuar sistem për dhënien e domosdoshme të testit të provimit personal dhe profesional për mësimdhënës, si dhe kontrolli i aftësisë së mësimdhënësit për punën me fëmijë dhe adoleshentë, megjithatë, testi i personalitetit u kundërshtua nga ekspertët dhe publiku.
117. Është bërë analizë për nevojat nga shkathtësisë në tregun e punës, me çka janë fituar informacione nga punëdhënësit për nevojat për punësime të reja me kohëzgjatje 6 deri në 12 muaj. Qëllimi i hulumtimit ishte të fitohen njohuri më të mëdha për gjendjet dhe ndryshimet e pritshme në tregun e punës, për nevojat nga profilet të punësimeve të reja të planifikuara për nevojat nga shkathtësitë me të cilat duhet të disponojnë kandidatët për punësimet e reja të planifikuara, për nevojat e punëdhënësve me profile të caktuara për të cilat punëdhënësit kanë hasur në mungesë gjatë plotësimit të vendeve të lira të punës. Hulumtimi dhe analiza për nevojat e shkathtësive në tregun e punës sigurojnë tregues afatshkurtër për pritshmërinë e punëdhënësve në raport me punësimet e reja dhe nevojat e shkathtësive që ata që kërkojnë punë i bëjnë të jenë më konkurrues në tregun e punës.
118. Për të mundësuar punësim më i madh i personave të papunësuar, nëpërmjet fitimit të njohurive dhe shkathtësive të profileve, të cilat kërkohen në tregun e punës janë realizuar trajnime për plotësimin e profileve të kërkuara në tregun e punës. Programi për trajnim është realizuar në periudhë prej 4 muaj tek zbatues me verifikim për trajnime, që përfshijnë edhe punën në kushte reale të punëdhënësi. Pas përfundimit të trajnimit dhe kontrollit të njohurive dhe shkathtësive të fituara, pjesëmarrësit marrin vërtetim adekuat për njohuritë e fituara.

119. Në vitin 2010, nga QAPT-ja në koordinim me institucione të tjera relevante, u hartua Koncepti për arsimin pas kryerjes së arsimit të mesëm, i cili është miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
120. Nga janari i vitit 2013 deri në janar të vitit 2017, në të gjitha shkollat e mesme u zbatua sistemi i kontrollit të jashtëm të arritjes së nxënësve në të gjitha lëndët.
121. Në vitin 2000 dhe 2015, shkollat e mesme profesionale (së bashku me shkollat e tjera të mesme) morën pjesë në studimin PISA me të cilin matet se sa nxënësit e moshës deri 15 vjeç janë të aftë për lexim me kuptim, sa janë të aftë në matematikë dhe në fushën e shkencave natyrore.

5.4.2. Sfidat

122. Në arsimin dhe trajnimin profesional duhet të merren parasysh këto sfida:

1. Arsimi profesional edhe më tej nuk tërheq numër të mjaftueshëm të nxënësve (përveçse në disa profile të caktuara nga fusha e shëndetësisë, ekonomisë dhe drejtësisë) dhe akoma nuk është vendosur sistem bashkëkohor i arsimit pas kryerjes së arsimit të mesëm; kapacitetet në sistemin e APT-së për sigurimin e arsimit gjithëpërfshirës janë shumë të kufizuara. Numri i lëndëve profesionale në plan programin mësimor është më i ulët në Evropë, rreth 52% (në krahasim me 70% në Evropë), ndërsa numri i lëndëve të përgjithshme është më i madh (rreth 42%) me çka arsimi bëhet i përgjithshëm. Gjithashtu, përqindja e trajnimit praktik është jashtëzakonisht e ulët, mesatarisht 20-30%, në krahasim me trendin e Evropës me mbi 60%. Qasja ndaj APT-së, gjithashtu edhe e programeve të APT-së, nuk është mjaft fleksibil për t'u përshtatur me zhvillimet e shpejta të teknologjike. Procesi i inovacionit të një plan programi, nga zhvillimi i programit, miratimi i tij, deri në përfundimin e gjeneratës së parë të nxënësve, gjithmonë është më i ngadalshëm në krahasim me zhvillimet teknologjike, me këtë edhe ndryshimet në tregun e punës. Prandaj, në mënyrë që ATP-ja të përgjigjet në mënyrë relevante dhe me vazhdimësi ndaj nevojave të tregut të punës, pozicioni i ATP-së, duke përfshirë programet dhe trajnimet e mësimdhënësve duhet të jenë fleksibil, duket u bazur në përshtatje të vazhdueshme të zhvillimeve. Me këtë, në mënyrë që nxënësit e ATP-së t'i u përgjigjen kërkesave të tregut të punës, pikënisja e tyre duhet të jetë zhvillimi i kompetencave të përgjithshme dhe kyçe. Kompetencat e zhvilluara në këtë mënyrë si për shembull të menduarit kritik, zgjidhja e problemeve, të mësuarit se si të fitojnë informata dhe shkathtësi të reja dhe se si t'i zbatojnë në situata praktike, përfshirë edhe inovacionin dhe sipërmarrjen – do t'i ndihmojnë nxënësve për tu përshtatur më me efikasitet në ndryshimet e shpejta të nevojave të tregut të punës.
2. Vërehet mospërputhje e ofertës së kuadrit nga sistemi i APT-së dhe kërkesës së tregut të fuqisë së punës; sistemi për aprovimin e kualifikimeve të reja të arsimit dhe trajnimit profesional është jo fleksibil dhe jo efikas, kurse bashkëpunimi me sektorin e biznesit për trajnim konkret praktik të nxënësve dhe mësim në ambient të punës është jo efikas i pamjaftueshëm. Standardet profesionale si pikënisje për arsimimin e duhur dhe të përditësuar profesional nuk janë iniciuar mjaftueshëm nga komuniteti i biznesit dhe procedurat për zhvillimin e tyre janë të jo dhe aq produktive.
3. Vërehen mangësi të konsiderueshme në njohuritë e mësimdhënësve për teknologjitë bashkëkohore që kanë të bëjnë me lëndët mësimore, dhe gjendja e këtillë vështirëson motivimin e ulët të mësimdhënësve dhe sistemit pamjaftueshëm të zhvilluar për përsosmërinë dhe avancimin profesional të karrierës; sidomos nga këto shkaqe mbizotëron periudha tradicionale ndaj kryesimit të procesit arsimorë.
4. Punëdhënësit nuk janë të motivuar sa duhet për të pranuar nxënësit për trajnim praktik, edhe pse Ligji për ATP-në përfshin të drejtën e punëdhënësit që i regjistron nxënësit për trajnim praktik për

të marrë lehtësime financiare, doganore dhe tatimore, megjithatë në praktikë këto dispozita ligjore nuk janë funksionale.

5. Disa nga drejtorët e shkollave për APT-në nuk arrijnë nivelin e duhur profesional të këtij funksioni, që ka ndikim negativ ndaj efikasitetit të institucioneve për APT-në, nga të cilat shumica nuk janë krejtësisht të pajisura me shërbimet profesionale dhe ndihmëse (për shembull administratorë për TIK, këshilltarë të karrierës etj.). Ekziston mungesa e zbatimit të standardeve për zhvillimin profesional dhe të karrierës së drejtorëve të shkollave dhe stafit të bashkëpunëtorëve të ekspertëve në shkolla.
6. Sistemi për sigurimin e cilësisë në shkollat e mesme profesionale është në fazën e hershme të zhvillimit. Mungojnë informacione të vlefshme të vazhdueshme për sistemin arsimorë nacional gjithashtu edhe të perspektivave ndërkombëtare. Testi i personalitetit i imponuar ligjërisht, u kundërshtua në aspektin e aktiviteti psikologjik, shkaktoi kundërvënie të shumta dhe pakënaqësi me mësimdhënësit.
7. Një përqindje e madhe e nxënësve të komuniteteve të marginalizuara regjistrohen në shkollat e APT-së ku vërehet integriteti i tyre i pamjaftueshëm, përfshirja e cilësisë dhe multikulturalizmi, sidomos kur bëhet fjalë për nxënësit rom dhe nxënësit me nevoja të posaçme arsimore.
8. Kufizohet përzgjedhja e profileve që ofrohen për nxënësit e vendosur në shtëpitë korigjuese-ndëshkuese.

5.4.3. Përparësitë dhe rezultatet e pritshme

123. Avancimi i sektorit të arsimit dhe trajnimit profesional do të bazohet në këto përparësi dhe rezultate të pritshme të cilat janë të sqaruara në detaje (duke përfshirë masat, aktivitetet dhe indikatorët) në shtyllat përkatëse në Planin e Veprimit;

Përparësia I. Harmonizimi i arsimit dhe trajnimit profesional me nevojat e tregut të punës

- 1.1 Sistemi i APT-së shpejt përshtatet për nevojat e ndryshueshme të shkathtësive në tregun e punës;
- 1.2 Të nxënit në kuadër të sistemit për APT-në është organizuar në mënyrë më fleksibile dhe më efektive në raport me fitimin e kompetencave dhe është orientuar drejtë arritjeve të rezultateve nga të nxënit të definuara sipas Standardeve;
- 1.3 Procesi i vendimit dhe zhvillimit të sistemit për APT-në është përkrahur nga një numër i madh i palëve kyçe të përfshira të interesit, duke përfshirë komunitetin e biznesit;
- 1.4 Sistemi për APT-në vazhdimisht informon për nevojat aktuale të fuqisë së punës, si dhe për kualifikimet dhe shkathtësitë e nevojshme për zhvillimin e politikës së APT-së;
- 1.5 Informacionet nga përcjellja e nxënësve që kanë përfunduar arsimin për nivelin e duhur të arsimit ose punësimin në të ardhmen (avancim në karrierë) mundësojnë të merren vendime për politikat arsimore të themeluara në bazë të provave;
- 1.6 Arsimi pas kryerjes së arsimit të mesëm është reformuar në përputhje me Kornizën maqedonase të kualifikimeve (KMK).

Përparësia II. Avancimi i mjedisit të të nxënit dhe cilësisë së arsimit dhe trajnimit profesional

- 2.1. Është përmirësuar efikasiteti i sistemit të APT-së në raport me harxhimet dhe rëndësinë e tregjeve të punës në nivel lokal, rajonal dhe nacional;

- 2.2. Procesi i udhëzimit dhe të nxënësve është përkrahur me të gjitha mjetet e domosdoshme që të arrihen rezultatet e caktuara nga të nxënësve;
- 2.3. Kompetencat e nxënësve që mbarojnë APT-në janë në përputhje me kërkesat e punëdhënësve dhe janë kompatible me drejtimet e përcaktuara sipas EQAVET- SECAP (Sigurimi Evropian i cilësisë në arsimin dhe aftësimin profesional);
- 2.4. Nxënësit me APT fitojnë shkathtësi relevante praktike për nevojat e mirëfillta në ambientet e punës;
- 2.5. Komuniteti i biznesit në mënyrë aktive merr pjesë në zbatimin e APT-së;
- 2.6. Informacionet kthyes nga të gjitha vlerësimet e suksesit të nxënësve mundësojnë të merren vendime për politikën në bazë të dëshmiave;
- 2.7. Janë siguruar të dhëna empirike të vlefshme për aftësinë e nxënësve të moshës deri 15 vjeç (krahasuar me perspektivat ndërkombëtare) për hyrje në jetë dhe vazhdimin e arsimimit ose përfshirjen në procesin e tregut të punës;
- 2.8. Efikasiteti i reformave të APT-së është siguruar nëpërmjet centralizimit të investimeve dhe përqendrimit të rezultateve;
- 2.9. Promovohet edhe aprovimi i përhapjes (desiminimit) i inovacioneve të APT-së të bazuara në praktikën më të mira kombëtare e ndërkombëtare.

Përparësia III. Rritja e përfshirjes në arsimin dhe trajnimin profesional

- 3.1. Nxënësit që kanë përfunduar APT-në janë të aftë të marrin vendime të informuara për arsimin ose drejtimin e karrierës së tyre;
- 3.2. Në sistemin e APT-së regjistrohet numër i madh i nxënësve që përparojnë më shumë në mësim;
- 3.3. Përgjithësisht është përmirësuar tërheqja dhe respektimi i veprimtarive profesionale të APT-së;
- 3.4. Janë siguruar kushte për përfshirjen e nxënësve në shtëpitë korrigjuese ndëshkuese në arsimin dhe trajnimin profesional.

Përparësia IV. Përmirësimi i kapaciteteve të resorëve

- 4.1. Kompetencat profesionale të mësimdhënësve vazhdimisht përmirësohen ;
- 4.2. Mësimdhënësit motivohen të arrijnë rezultate më të mira;
- 4.3. Drejtorët e të gjitha shkollave për APT-në plotësojnë kushtet minimale për kompetencat profesionale;
- 4.4. Arsimit dhe trajnimet krejtësisht shoqërohen me shërbimet profesionale, të domosdoshme për cilësinë e procesit të të nxënësve dhe zhvillimit të nxënësve.

5.5

ARSIMI I LARTË, HULUMTIMET DHE INOVACIONET

5.5.1. Pasqyra e gjendjes së veprimtarive të deritanishme

124. Instrumenti kryesor ligjor për këtë sektor është Ligji për arsimin e lartë (nga viti 2008), i cili ndër të tjera përmban dispozitat për harmonizimin e arsimit të lartë në vend, me procesin e Bolonjës dhe Sistemin evropian për transferimin e kredive dhe gjithashtu ofron një bazë ligjore për statusin e stafit mësimdhënës dhe mobilitetin e studentëve. Pas miratimit të Ligjit, i njëjti është ndryshuar 20 herë, megjithatë zbatimi i disa amendamenteve është vonuar disa herë, kështu duke krijuar konfuzion ligjor në lidhje me vlefshmërinë e dispozitave të caktuara. Në të njëjtën kohë shumë ndryshime ligjore u kritikuan nga komuniteti akademik-profesorë e studentë, pasi ato përmbanin kufizime të autonomisë së universiteteve dhe ishin arsyeja për protesta masive në Republikën e Maqedonisë.
125. Ligji për veprimtari shkencore- hulumtuese (nga viti 2008) rregullon marrëdhëniet në fushën e kërkimit shkencor dhe bashkëpunim fushën e transferimit të njohurive, kërkimeve, trajnimit dhe implementimit. Në vitin 2013, sipas Ligjit për aktivitetet e inovacionit, është themeluar Fondi për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik (FIZHT), i cili është përgjegjëse për koordinimin dhe forcimin e aktiviteteve në fushën e inovacionit.
126. Janë themeluar tre universitete të reja publike, “Goce Dellçev” në Shtip (viti 2007), Universiteti i Shkencës dhe Teknologjisë së Informacionit në Ohër (viti 2009) dhe Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup (viti 2016). Për më tepër, në vitin 2010 QRM miratoi dy vendime: Vendimi për zvogëlimin e pagesës (participimit) për të studiuar në universitetet publike dhe një vendim për lehtësimin e qasjes në universitete për personat më të moshuar se 30/35 vjeç (participim më i ulët dhe status të studentit me korrespondencë).
127. Nga viti 2010 e këtej MASH ofron bursa për studime universitare, bursa studimi master dhe doktoraturë jashtë vendit, për kandidatët e pranuar në 100 universitet e para të renditura në listën e Shangait dhe atë në fushën e shkencave juridike, shkencave teknike, arkitekturës, inxhinierisë, matematikës, ekonomisë dhe financave, fizikës, biologjisë, kimisë dhe gjenetikës.
128. Përgjegjëse për sigurimin dhe vlerësimin e cilësisë në arsimin e lartë sipas Ligjit për arsim të lartë është Bordi për Akreditim dhe Vlerësimin në Arsimin e Lartë (BAVRL), i cili është themeluar në vitin 2011, i cili është i përbërë nga 23 anëtarë. Në versionin origjinal të këtij ligji ishin parashikuar që Këshilli për Akreditim dhe Agjencia për Vlerësim që më vonë të njëjtat të bashkoheshin. Aktualisht mandati i BAVRL-së përfshin: aprovim dhe njohje të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit, vlerësim të cilësisë së arsimit të lartë, menaxhim, financimin, aktivitete akademike dhe të tjera.

129. Në lidhje me këtë fushë, u prezantua një provim shtetëror kundërshtues, aplikimi i të cilit ishte shtyrë dhe deri më tani nuk është zbatuar aspak. Gjithashtu, Ligji për Arsimin e Lartë ka paraparë një Këshill Kombëtar, i cili ende nuk është themeluar.
130. Në vitin 2013 është miratuar rregullorja, sipas të cilës të gjitha institucionet e arsimit të lartë kanë formuar Bordet e tyre të Besimit dhe Bashkëpunimit me Publikun (BBBP), me qëllim të sigurimit të cilësisë përmes shqyrtimit të mendimeve dhe rekomandimeve të të gjitha palëve kyçe të interesuara për zhvillimin e institucionit. Në vitin akademik 2015/2016 u zbatua renditja e tretë e institucioneve të arsimit të lartë, që kryhej sipas 21 tregueseve të suksesit akademik dhe konkurrencës, të cilat kanë të bëjnë me aspektet kryesore të veprimtarisë së tyre si mësimdhënie, hulumtim dhe dimensionin social.
131. Procedura e njohjes dhe ekuivalencës e përcaktuar në Ligjin për Arsimin e Lartë në periudhën para kësaj strategjie u nënshtrua disa ndryshimeve. Gjithashtu, ky ligj si proces i vetëm rregullon të dy llojet e njohjes së kualifikimeve (profesionale dhe akademike). Pritet që Korniza e Maqedonisë për Kualifikime (KMK, sipas ligjit për NRK), zbatimi i së cilës është në proces, do të lehtësojë validimin e kualifikimeve të fituara në vendet e tjera (dhe anasjelltas) dhe do të përmirësojë mobilitetin për fuqinë punëtore.
132. Nga viti 2016 ka filluar procesi i rishikimit të modelit të financimit të arsimit të lartë, në mënyrë që të përmirësojë efikasitetin me të cilën janë ndarë fondet për universitetet.
133. Nga viti 2010 janë filluar disa projekte: furnizime për laboratorë me pajisje teknike moderne, kërkime shkencore dhe aktivitete të zbatuara për universitetet publike; ishte përgatitur portali www.nauka.mon.gov.mk me bazë të dhënash të institucioneve shkencore, studiuesve dhe laboratorë kërkimor; ishin siguruar “subvencione shkencore” për autorët e punimeve shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare me faktor ndikimi; 1.000 libra profesionale dhe tekste që përdoren në universitetet më prestigjioze të botës janë përkthyer, megjithatë, përkthimet shpeshherë nuk ishin kualitative gjë që i bënte pjesën e madhe të librave të papërdorura. Gjithashtu, disa laboratorë të destinuara për institucionet e arsimit të lartë u janë dhënë institucioneve të tjera jo arsimore dhe aktualisht ekziston një procedurë nga prokuroria publike kompetente kundër këtij rasti.
134. Që nga viti 2013 MASH ofron grante të pakthyeshme për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët e institucioneve të larta arsimore dhe shkencore, për të kryer tre lloje të aktiviteteve kreative në fushën e artit dhe arkitekturës, arteve dramatike, arteve muzikore, filmin dhe letërsisë:
- Pjesëmarrje ose realizim të festivalit - një anëtar i Shoqatës Evropiane në festivale;
 - Pjesëmarrje si përfaqësues i shtetit në projektin ose manifestim jashtë vendit;
 - Pjesëmarrje në një projekt ndërkombëtar dhe manifestim jashtë vendit.
135. Në bazë të një vendimi të Qeverisë në vitin 2015, MASH nëpërmjet Drejtorisë për zhvillimin dhe promovimin e arsimit në gjuhët e komuniteteve etnike filloi dhënien e bursave për studentët romë. Qëllimi i këtij veprimi është të stimulojë romët të regjistrohen në universitete që prodhojnë staf mësimor. Ky veprim është në përputhje me Planin e Veprimit për arsimin 2014-2020 i cili është pjesë e strategjisë kombëtare për përfshirjen e romëve në Republikën e Maqedonisë.
136. Në vitin 2014 Republika e Maqedonisë, së bashku me katër vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor u bashkua në programin Horizont 2020 dhe u bë anëtare shoqëruese me pjesëmarrje të barabartë në të gjitha segmentet e programit shtatëvjeçar të BE-së për hulumtim dhe inovacion, i cili mundëson mobilitet për shkencëtarë të shquar, i forcon sistemet e brendshme për hulumtim dhe ndihmon vendet të integrohen në aktivitetet evropiane të kërkimit.
137. Në vitin 2015 FITR filloi t'i përdor instrumentet për sigurim të granteve të pakthyeshme për bashkëfinancim: (1) “start up” dhe “spinoff” shoqëri tregtare të sapoformuara; (2) komercializim i inovacionit; (3) transferim i teknologjive; dhe (4) themelim, punë dhe investime në përsheptuesit e teknologjisë të biznesit. Deri tani

grant të pakthyeshem kanë fituar 37 projekte në fushën e TIK-së, në inxhinieri mekanike dhe elektrike, bujqësi, prodhim të mineraleve, industri kreative dhe ndërtim.

5.5.2. Sfidat

138. Në fushën e edukimit të lartë ekzistojnë shumë sfida të cilat akoma janë duke pasur ndikim në këtë sektorë:
1. Cilësia e pamjaftueshme e disa fakulteteve dhe universiteteve është e shoqëruar nga një sistem jo plotësisht funksional për akreditim dhe vlerësim të universiteteve, disa programe studimi dhe lëndësh nuk përputhen me nevojat e tregut të punës; ende shfaqen fenomene të tilla si plagjiaturë në veprat e shkruara të studentëve dhe mësuesve, sistemi për trajnimin praktik të studentëve është i papërshtatshëm. Bordi i akreditimit dhe vlerësimit nuk siguron efikasitet dhe funksionalitet. Për këto arsye, do të kërkohet që ky organ të reformohet me anë të themelimit të organeve të veçantë për akreditimin dhe vlerësimin e arsimit të lartë. Sa i përket programeve të akredituara, ekziston mungesa e mekanizmave efikase për të mundur kontrollin e pajtueshmërisë së kriterëve të akreditimit dhe të vlerësimit në periudhën pas akreditimit të programit të studimit. Në këtë drejtim, nuk ka analiza për monitorimin e përmbushjes së kriterëve nga momenti i akreditimit të programit të studimit deri në momentin e riakreditimit.
 2. Sistemi i arsimit të lartë nuk parashikon kontroll të rregullt të cilësisë. U prezantua një model i provimit shtetëror. Ky model ishte në kundërshtim me parimet e arsimit të lartë dhe pati ndikim të drejtpërdrejt në lirinë akademike të universiteteve. Edhe në aspektin procedural, ky model ishte joefikas dhe u kundërshtua, dhe si i tillë vështirë për t'u zbatuar. Rrjedhimisht ky model i provimit shtetëror nuk u zbatua asnjëherë.
 3. Procedura për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë është komplekse. Zakonisht ajo zgjat për një periudhë të gjatë për t'u përfunduar dhe është e ngarkuar me shumë kërkesa administrative.
 4. Në përgjithësi, sistemi i arsimit të lartë ka shumë rregulla që pasqyrohet në autonominë e universiteteve. Në të njëjtën kohë, menaxhimi i universiteteve/fakulteteve nuk është participuar mjaftueshëm.
 5. Kërkesat (kriteret) për regjistrim në universitete janë ende të ulëta, por qasja në arsimin e lartë për grupet e ndryshme në nevojë është i kufizuar, edhe nuk ka informacione të mjaftueshme mbi mundësitë e përfshirjes së universiteteve.
 6. Vazhdohet me zgjerimin e programeve të studimit pa analizë të duhur të nevojave të tregut të punës dhe kapacitetet për zbatimin e tyre.
 7. Kompetencat e pamjaftueshme të personelit mësimor të universiteteve, i cili është rënduar më tej nga mundësitë e pamjaftueshme për zhvillim profesional, zhvillimin dhe mobilitet për karrierë akademike; në universitete mungon stafin e ri për shkak të motivimit të ulët dhe pozicioneve të pamjaftueshme të hapura; është i lartë raporti student/ profesor.
 8. Në fusha të ndryshme të arsimit të lartë ka probleme si: vështirësi me lëshimin e shtojcave të diplomës, mungesa e mundësive për të mësuar në distancë për shkak të kuadrit ligjor jo të plotë dhe të zhvillimit të dobët të platformave online për mësim, kriteret të papërcaktuara për financimin e arsimit të lartë, mungesë e vërtetë e bashkëpunimi trepalësh në mes të qeverisë, akademisë dhe komunitetit të biznesit.
 9. Financimi për hulumtime mbetet në nivel të pakënaqshëm, që në mënyrë të konsiderueshme kontribuon në infrastrukturën joadekuatë të qendrave të kërkimit shkencor në universitete; fushat

tematike me përparësi të hulumtimit nuk janë reformuar; qasja në të dhënat shkencore globale është e kufizuar; nuk ka mekanizëm operativ për komercializimin e zgjidhjeve inovative.

5.5.3. Përparësitë dhe rezultatet e pritshme

139. Këto janë Përparësitë e mëposhtme dhe rezultatet e pritshme në këtë shtyllë:

Përparësia I. Sigurimi i cilësisë dhe efikasitetit të arsimit të lartë në përputhje me praktikat më të mira evropiane

- 1.1. Janë vendosur parakushte për vlerësim të cilësisë së arsimit të lartë;
- 1.2. Janë vendosur parakushte për sigurim të kontrollit të cilësisë së universiteteve;
- 1.3. Janë vendosur parakushte për funksionimin efektiv të BAVRL;
- 1.4. Është përmirësuar efikasiteti dhe efektiviteti i sistemit për arsimin të lartë në aspektin e kostos dhe rëndësisë në tregun vendor, rajonal dhe kombëtar të punës;
- 1.5. Studentët fitojnë aftësi praktike që janë relevante për kërkesat aktuale të punës;
- 1.6. Të diplomuarit janë në gjendje të sjellin zgjidhje të informuara për karrierën;
- 1.7. Është rritur efikasiteti i procesit mësimor në universitete duke i kushtuar më shumë vëmendje çdo studenti.

Përparësia II. Përmirësimi i përmbajtjes në arsimin e lartë

- 2.1. Janë vendosur kushte minimale për përmbajtjen dhe rezultatet e arsimit të lartë;
- 2.2. Informacionet për arsimin e mëtejshëm dhe/ose punësimin e të diplomuarve (përparim në karrierë), mundëson të merren vendime për politikën që janë të bazuara në dëshmi;
- 2.3. Është përmirësuar zhvillimi akademik dhe mobiliteti i stafit universitar dhe i studentëve në kuadër të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë dhe Bashkësia Ndërkombëtare të Arsimit të Lartë;
- 2.4. Sistemi i arsimit të lartë është i informuar vazhdimisht mbi kërkesat më të reja për kualifikime dhe aftësi që duhet të përdoren për të zhvilluar politika për arsimin e lartë.

Përparësia III. Përmirësimi i disponueshmërisë dhe sistemin për regjistrimin në arsimin e lartë

- 3.1. Është përmirësuar qasja në arsimin e lartë për personat me aftësi të kufizuara fizike;
- 3.2. Studentët kanë kushte të mira për strehim në të gjitha konviktet studentore.

Përparësia IV. Përmirësimi i menaxhimit dhe financimit të arsimit të lartë

- 4.1. Menaxhimi dhe drejtimi me universitetet është demokratizuar dhe është rritur efikasiteti i tyre;
- 4.2. Është rritur pjesëmarrja funksionale e studentëve në proceset e vendimmarrjes në nivel të fakultetit dhe universitetit;
- 4.3. Është përforcuar bashkëpunimi i universiteteve me palët kyçe të interesuara (komunitet i biznesit, BAVRL dhe Senati universitar.)
- 4.4. Është rritur efikasiteti i përdorimit të burimeve financiare të përcaktuara për arsimin e lartë;
- 4.5. Janë vendosur kushtet për rritje të investimeve në arsimin e lartë.

Përparësia V. Mbështetje e kërkimeve dhe inovacioneve

- 5.1. Është vendosur mbështetje e qëndrueshme dhe drejtim në hulumtime dhe inovacione;
- 5.2. Është rritur efikasiteti i shfrytëzimit të resurseve financiare të përcaktuara për hulumtime dhe inovacione;
- 5.3. Kërkimet shkencore në përputhje me nevojat bashkëkohore për zhvillim të teknologjisë.

5.6

ARSIMI JOFORMAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR

5.6.1. Pasqyra e gjendjes dhe veprimtaritë e deritanishme

140. Ligji për Arsimin e të rriturve u miratua në vitin 2008 dhe vijon miratimi (ose ndryshimi) i shumë akteve nënligjore me të cilat rregullohen procedurat për verifikimin e programeve për arsimimin e të rriturve (arsimit jo-formal) standardet për hapësira, pajisje dhe personel për vendet për arsimin e të rriturve. Në vitin 2011 u miratua një tjetër akt ligjor i lidhur me këtë zonë, pra Ligjin për universitetet e hapura qytetare për mësim gjatë gjithë jetës.
141. Sipas ligjeve për çështjet strategjike që lidhen me zhvillimin e arsimit për të rritur, kompetent është Këshilli për arsimin e të rriturve. Qendra për Arsimin e të Rriturve, e cila u themelua në nëntor të vitit 2008 dhe e cila filloi të funksionojë në qershor të vitit 2009, ka mision të përcaktuar për të promovuar një sistem për mësim funksional joformal dhe mësim për të rritur (në përputhje me standardet e BE-së), që mundëson cilësi të lartë të mësimin për të fituar kualifikime, rritje të punësimit dhe zhvillim të sipërmarrjes, plotësim i nevojave të tregut të punës, kontribut në zhvillimin ekonomik, social dhe personal të individëve.
142. Përparësitë në sektor janë përcaktuar në Strategjinë për Arsimin e të Rriturve, 2010-2015. Më vonë janë miratuar dy dokumente të tjera konceptuale që përmbajnë udhëzime për integrimin e edukimit jo-formal në sistemin e arsimit dhe trajnimit dhe përcaktojnë kushtet për përmirësimin e arsimit bazë të të rriturve. Këto aktivitete ishin shoqëruar me miratimin e udhëzimeve për verifikimin e programeve të veçanta për të rritur dhe verifikimin e institucioneve për arsimin e të rriturve në vitin 2011. Përveç kësaj në vitin 2013 ishte përgatitur rregullore për verifikimin e institucioneve për arsimin e të rriturve. Nga viti 2012 janë verifikuar 53 institucione për arsimin e të rriturve. Në procesin e vendosjes së KNK-së është zhvilluar katalogu i kualifikimeve që mund të fitohen me anë të arsimit për të rritur, në lidhje me kornizën evropiane.
143. Në vitin 2012 ka filluar procesi i verifikimit të programeve të veçanta për arsimimin e të rriturve (programeve për mësim joformal) me të cilat fitohet kualifikim ose kualifikim i pjesshëm. Këto programe janë përgatitur në përputhje me standardet e profesioneve, që aktualisht i ka rreth 130 në numër. Përveç kësaj, nga viti 2014 e këtej janë verifikuar 190 programe të veçanta për fitimin e njohurive, shkathtësive dhe kompetencave specifike.
144. Për momentin janë verifikuar (akredituar) 53 ofrues të trajnimit joformal dhe u janë lejuar të lëshojnë certifikata, që njihen në vend. Dy prej këtyre objekteve janë të certifikuara për të ofruar programe trajnimi për të rriturit dhe nga viti 2012 rreth 40 pjesëmarrës u bënë trajnuese profesionistë.
145. Të rriturve u ofrohet një gamë e gjerë e programeve mësimore. Më saktë, nga viti 2010 rreth 2.000 të rritur (vetëm me arsim fillor) kanë marrë pjesë në programe të ndryshme në nivel të arsimit të mesëm profesional

në gjashtë komuna; nga viti 2010 deri në vitin 2015 në kuadër të Planit operativ për masat aktive në tregun e punës dhe programet e punësimit përmes Agjencisë së Punësimit, janë trajnuar 1.190 persona të papunë për profesione të kërkuara në tregun e punës.

146. Me qëllim që të sigurohet cilësi në arsimin për të rritur, është vendosur një sistem për mbikëqyrje mbi ofruesit e trajnimeve në vitin 2013.
147. Duke kuptuar rëndësinë e ndërgjegjësimit të publikut dhe përfitimet nga arsimi i të rriturve, në dy vitet e fundit ishin mbajtur shumë aktivitete promovuese. Nga viti 2012 rregullisht organizohen “Ditët e arsimit për të rritur”, që kanë për qëllim të promovojnë konceptin e mësimin të përjetshëm si arsim, që haset gjatë gjithë jetës, pa dallim të moshës, gjinisë ose përkatësisë etnike dhe me qëllim të rritet ndërgjegjësimi qytetar për rëndësinë e arsimimit të të rriturve.
148. Në vitin 2016 u hartua projekt për forcimin e sistemit të mësimin gjatë gjithë jetës duke modernizuar arsimin profesional, trajnimi dhe arsimin e të rriturve, duke rezultuar në zhvillimin e një strategjie për arsimin e të rriturve, strategji për të mësuarit gjatë gjithë jetës, 15 programe të reja për trajnimin e të rriturve, më shumë se 40 trajnues për të rriturit, si dhe një draft model për forcimin e rrjetit të Universiteteve të Hapura Qytetare për të mësuarit gjatë gjithë jetës, si nxitës të zhvillimit ekonomik lokal, duke përfshirë ndryshimet e propozuara në legjislacionin në lidhje me veprimet e tyre bazuar në praktikat më të mira gjermane dhe evropiane.

5.6.2. Sfidat

149. Edhe përkaj asaj që janë bërë përmirësime të ndryshme në sektorin e të nxënës dhe arsimit për të rritur, megjithatë duhet të investohet mund më i madh për tu përfshirë këto sfida:
 1. Ekziston mosharmonizim ndërmjet ofertës dhe arsimit të të rriturve, i cili vjen si rezultat nga mungesa e informacioneve për nevojat nga fuqia e punës të paktën në afat të shkurtër dhe në afat të mesëm.
 2. Vetëdija e ulët e popullatës për mundësitë e dhe përfitimet nga arsimi i personave të rritur kontribuon drejt motivimit të ulët të të rriturve të marrin pjesë në mësimin gjatë gjithë jetës, kurse shkaku tjetër për këtë është mungesa e sistemit për vlefshmërinë e mësimin joformal dhe informal (VMJI) .
 3. Përveç kompanive të cilat nuk janë të informuara me privilegjet e zbatimit të të nxënës nëpërmjet punës, trajnimit praktik dhe stazhimit, gjithashtu punëtorët nuk janë të informuar mjaftueshëm me të drejtat dhe obligimet e tyre arsimore.
 4. Nuk ka sistem gjithëpërfshirës për financimin e arsimit të të rriturve në vend, por edhe punëdhënësit nuk kanë asnjë motivim financiar për të investuar në arsimin e personave të rritur.
 5. Përgjithësisht, niveli i bashkëpunimit me palët e ndryshme të interesuara (p.sh. me Këshillin lokal ekonomik dhe social) është i ulët, ka vështirësi serioze me pjesëmarrjen në komunitetin e biznesit gjatë dizajnit të programit për arsim të të rriturve, sidomos në aspekt të rezultateve nga të nxënës.
 6. Programet të destinuara për çrrënjosjen e analfabetizimit të popullatës së rritur kanë përfshirje të kufizuara, sistemi për arsim të fillor të të rriturve nuk është mjaftueshëm fleksibil dhe efikas dhe krejtësisht mungon sistemi për përfundimin e arsimit të mesëm të të rriturve
 7. Nuk ekziston sistem për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore, të dhëna dhe analiza për arsimin e të rriturve.
 8. Nuk përmbush kushtet as edhe kontrolli i cilësisë gjatë zbatimit të arsimit të të rriturve nga ana e ofruesve të certifikuar.

5.6.3. Përparësitë dhe rezultatet e pritshme

150. Përparësitë e përmendura dhe rezultatet e tyre adekuate të cilat janë theksuar në këtë Strategji, janë përcaktuar me qëllim të kontribuojnë ndaj avancimit të të nxënit dhe arsimit për të rritur deri në nivelin e duhur të zhvillimit;

Përparësia 1. Rritja e kualifikimeve të të rriturve (njohuritë, shkathhtësitë dhe kompetencat)

- 1.1. Të gjithë qytetarët kanë mundësinë që kompetencat e tyre që kanë fituar nëpërmjet mësimi jo formal dhe in-formal, t'i bëjnë të vlefshme, me çka do të përmirësohet stimulimi i arsimit gjatë gjithë jetës dhe do të rritet konkurrenca e fuqisë së punës;
- 1.2. Është rritur niveli i arsimit të cilin e fiton popullata;
- 1.3. Janë përmirësuar kompetencat kryesore të personave të rritur;
- 1.4. Janë përmirësuar mundësitë për të nxënit e të rriturve me nevoja të posaçme arsimore;
- 1.5. Janë siguruar kushte për personat e vendosur në shtëpitë korrigjuese-ndëshkuese të përfundojnë arsimin fillorë dhe të mesëm si dhe të marrin pjesë në APT;
- 1.6. Është përmirësuar motivimi i të rriturve të marrin pjesë në trajnime;
- 1.7. Janë përmirësuar mundësitë për NARr për shkak të politikës së përmirësuar;
- 1.8. Rritja e përfshirjes në NARr që në mënyrë të konsiderueshme kontribuon për zhvillimin rajonal dhe atë lokal.

Përparësia 2. Përmirësimi i përmbajtjes dhe cilësisë të të nxënit dhe arsimit për të rritur

- 2.1. Janë aprovuar parakushte për rritjen e numrit të ofruesve të AF-së për të rritur dhe për zgjerimin e përhapjes së kualifikimeve të cilat ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;
- 2.2. Janë siguruar kushte për kontroll të cilësisë gjatë zbatimit të NARr-së;
- 2.3. Është përmirësuar cilësia e NARr-së për të rritur si rezultat i kompetencave të përforcuara profesionale të trajnuesve të personave të rritur;
- 2.4. Është rritur rëndësia e arsimimit të personave të rritur për nevojat e tregut të punës

Përparësia 3. Përmirësimi i legjislacionit, organizimi dhe menaxhimi i të nxënit dhe arsimit për të rritur

- 3.1. U siguroa bazë financiare e domosdoshme për funksionim dhe zhvillim të qëndrueshëm të sistemit për NARr-së;
- 3.2. Në dispozicion janë të dhënat bashkëkohore statistikore për sistemin e NARr-së, dhe të njëjtat mundësojnë të merren vendime për politikat të cilat themelohen në dëshmi;
- 3.3. Janë verifikuar mundësitë dhe opsionet për vendosjen e parakushteve për rritjen e investimeve në NARr.

5.7

PËRPARËSITË E PËRGJITHSHME-TË PËRBASHKËTA NË SISTEMIN E ARSIMIT

151. Ekzistojnë tema që janë të përbashkëta për disa shtylla, madje edhe të atilla që janë të përbashkëta për sistemin arsimor në tërësi. Me qëllim të përmbahemi në logjikën sa më të qartë të Strategjisë dhe të sigurohet menaxhim dhe zbatim më efikas i sajë, disa nga këto tema horizontale janë të përfshira në shtyllat e mëparshme dhe atje janë të sistematizuara. Kështu janë temat siç vijojnë:
- Përmirësimi i mjedisit të të nxëniet dhe sigurimi i arsimit cilësor- për të gjitha nivelet;
 - Përmirësimi i përmbajtjes së arsimit- për të gjitha nivelet (duke u plotësuar dhe harmonizuar me nevojat e tregut të punës) - sidomos nëpërmjet aprovimit të Standardeve të të nxëniet të bazuara në rezultate nga të nxëniet;
 - Pjesëmarrje më e madhe, përmirësim i inkluzionit dhe integritit ndëretnik- për arsimin parashkollorë, fillorë dhe të mesëm;
 - Përmirësimi i kapaciteteve të resurseve humane (administrata shkollore, stafi i mësimdhënësve dhe kuadro të tjera) dhe operacionalizimi i mekanizmave për avancimin në karrierë për arsimin parashkollorë, fillorë dhe të mesëm, APC, arsimin e lartë dhe arsimin për të rriturit;
 - Përmirësimi i organizimit dhe menaxhimit të institucioneve- për arsimin parashkollorë, fillorë dhe të mesëm, APC, arsimin e lartë dhe arsimin për të rriturit;
 - Përmirësimi i kushteve për orientim profesional dhe orientim të karrierës- për arsimin fillorë dhe të mesëm, APC, arsimin e lartë;
152. Kur bëhet fjalë për avancimet e inkluzionit, e cila si temë shfaqet thuajse në të gjitha shtyllat, fokusi i personave (nxënësve) me aftësi të posaçme arsimore. Në Strategji, me nocionin “nevoja të posaçme arsimore” nënkuptohen nevojat që në procesin arsimorë i kanë personat (nxënësit) të cilët në mënyrë të pavarur dhe pa intervenime dhe përkrahje arsimore nga faktorët arsimorë nuk mund ti arrijnë Standardet e të nxëniet të parapara sipas moshës që kanë. Për personat me aftësi të posaçme arsimore, karakteristike është nevoja që t’u sigurohet ndihmë plotësuese në arsimim për të arritur Standardet e të nxëniet. Ekziston spektër i gjerë i arsyeve për shkak të të cilave numër i caktuar i nxënësve mund të kenë nevoja të posaçme arsimore: (a) aftësi e kufizuar mendore ose fizike të zhvillimit; (b) arsye apo shkaqe socio-emocionale dhe biheviore; dhe (c) kushte të papërshtatshme arsimore, që ka të bëjë me faktorët socio-ekonomik, kulturorë, dhe/ose faktorët gjuhësorë.

153. Tema tjetër që është e përfshirë në më shumë shtylla dhe është sidomos e rëndësishme për kontekstin e përgjithshëm shoqëror, ka të bëjë me përmirësimin e integritimit ndëretnik. Sipas Strategjisë njëra nga mënyrat që të arrihet kjo është nëpërmjet sigurimit të arsimit multikulturor, përkatësisht aprovimit të *multikulturalizmit* në arsim, që nënkupton prezencën e përmbajtjeve që pasqyrojnë karakteristikat kulturore të të gjitha bashkësive etnike të cilat jetojnë në Republikën e Maqedonisë në mënyrën e cila promovon pranimin e ngjashmërive dhe respektimin e diversiteteve. Nga ana tjetër kur bëhet fjalë për aktivitetet të *integritimit ndëretnik* në arsim, mendohet në aktivitetet e përbashkëta me grupe, nxënës/mësimdhënës “të përziera”, nga gjuhët e ndryshme mësimore që bazohen në interaksionin ndërmjet nxënësve.
154. Ekzistojnë edhe tema të tjera të përgjithshme të cilat lidhen me procesin e përgjithshëm arsimorë dhe që janë përfshirë sidomos në shtyllën e 7-të.
- Legjislacionit;
 - Statistikat dhe informacionet për arsim;
 - Njohuritë për TIK dhe digjitalizim;
 - Partneriteti social;
 - Korniza nacionale e kualifikimeve.
155. Përveç kësaj, në kuadër të shtyllës së shtatë do të përfshihet edhe Përparësia specifike që ka të bëjë me monitorimin dhe vlerësimin e Strategjisë, si dhe për forcimin e kapaciteteve të organeve shtetërore.

5.7.1. Pasqyrimi i gjendjes dhe veprimtarive të deritanishme

156. Nga viti 2000 e këndeje janë miratuar disa rregullore të niveleve dhe aspekteve të ndryshme të arsimit:
- Ligji për mbrojtje të fëmijëve⁴⁸ (viti 2000);
 - Ligji për nxitje dhe ndihmë të kulturës teknike (viti 2000);
 - Ligji për arsimin fillor (viti 2002);
 - Ligji për arsimin e mesëm (viti 2002);
 - Ligji për standardin e nxënësve (viti 2005);
 - Ligji për arsimin dhe trajnimin profesional (viti 2006);
 - Ligji për arsimin e lartë (viti 2008);
 - Ligji për arsimin e të rriturve (viti 2008);
 - Ligji për librat shkollorë të arsimit fillor dhe të mesëm (viti 2008);
 - Ligji për hulumtime dhe veprimtari shkencore (viti 2008);
 - Ligji për njohje të kualifikimeve profesionale (viti 2010);
 - Ligji përhapjen e universiteteve qytetare për mësim gjatë gjithë jetës (viti 2011);
 - Ligji për standardin studentor (viti 2013)
 - Ligji për veprimtari inovative (viti 2013);
 - Ligji për kornizën nacionale të kualifikimeve (viti 2013);

⁴⁸ I rregullon marrëdhëniet në sferën e edukimit parashkollor.

- Ligji për trajnim dhe provim për drejtorët e shkollave fillore, shkollave të mesme, konvikteve të nxënësve dhe universiteteve të hapura qytetare për mësim gjatë gjithë jetës (viti 2014);
 - Ligji për institucionet arsimore të arsimit të lartë për kuadrin mësimdhënës në edukimin parashkollor, arsimin fillorë dhe të mesëm (viti 2015).
157. Përveç kësaj ekzistojnë edhe ligje që rregullojnë veprimtaritë e strukturave të ndryshme të sistemit arsimorë, siç janë: Ligji për themelimin e Universitetit të Tetovës (viti 2014); Ligji për themelimin e Agjencisë nacionale për programe arsimore dhe mobilitet Evropian (viti 2007); Ligji për qendrën shtetërore të provimeve (viti 2008); Ligji për themelimin e Universitetit për Shkencat e Teknologjisë së Informacionit “Shën Apostull Pavli” (viti 2008); Ligji për themelimin e Agjencisë Nacionale për Teknologjitë Nukleare të Republikës së Maqedonisë (viti 2010); Ligji për shërbime pedagogjike (ShP; viti 2011); Ligji për akademinë e sportit (viti 2014); Ligji për akademinë e mësimdhënësve (viti 2015); Ligji për mësimdhënësit në shkollat fillore dhe të mesme (viti 2015); dhe Ligji për themelimin e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, viti 2015); Ligji për themelimin e Universitetit për Mbrojtje Nacionale, Siguri dhe Paqe “Damian Gruev” në Shkup (viti 2014).
158. Të gjitha këto ligje, nga miratimi i tyre deri më tani, sipas nevojës rregullisht janë rishqyrtuar. Këto procese iniciuan nga ministri të ndryshme, institucione ose sektorë të ndryshëm të ministrive kompetente për fushat e caktuara, kurse rishqyrtimi i ndonjërit ligj nuk u pasua me ndryshime dhe plotësime adekuatë të ligjeve të tjera. Për shkak të kësaj, rishqyrtimi gjithëpërfshirës dhe harmonizimi i legjislacionit të arsimit u bë nevojë urgjente.
159. Të dhënat për sistemin arsimor, paralelisht grumbullohen dhe përpunohen nga struktura të shumta, si për shembull: Enti Shtetërorë i Statistikës (statistika zyrtare); Sistemi informativ i menaxhimit të arsimit (EMIS) i cili vepron në kuadër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës; Byrosë për Zhvillimin e Arsimit; Qendrës Shtetërore të Provimeve etj. Universitet disponojnë me bazat e tyre të të dhënave. Edhe një bazë tjetër e vendosur për të dhënat e arsimit para shkollorë funksionon në mënyrë të pavarur.
160. Në vitin 2012 u aprovua EMIS me qëllim të përkrahjes të aktiviteteve kryesore të MASH-it, implementimit të sistemit kompleks dhe bashkëkohor për resurse humane nëpërmjet përfshirjes të kërkesave të MASH-it, të gjitha agjencitë e sajë dhe të gjitha shkollat fillore dhe të mesme në vend. EMIS nënkupton grumbullimin, kontrollimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave për nxënësit dhe arritjet e tyre në shkollat fillore dhe të mesme publike. Nga ana e EMIS-it kryesisht menaxhohet me të dhënat për: mirëmbajtjen e shkollave, nxënësve, mësimdhënësve dhe stafit tjetër të shkollës, rezultatet e nxënësve (me përfshirje të rezultateve nga Matura), mungesat e nxënësve, objektet dhe mjetet shkollore, financimi dhe harxhimet, planet vjetore shkollore, mosprezenca e personelit, shpërndarja e nxënësve/klasave, librave shkollorë dhe përdorimi i tyre. Sistemi përfshinë edhe informacionin për personelin, për shembull të dhënat për punësim dhe shkarkim nga puna, historia e punësimit, menaxhimi me karrierën, trajnim dhe zhvillim profesional, kompensime dhe benificione etj. Sistemi ka më shumë se 1000 shfrytëzues nga 2 të punësuar në çdo shkollë dhe nga 3 të punësuar në çdo komunë.
161. Në vitin 2016 filloi projekti i ri 3 vjeçar me qëllim të krijimit të modelit për integrim të centralizuar të EMIS-it për arsimin e lartë për çështjet studentore, programet studiuëse, menaxhimi me resurset humane, buxheti dhe menaxhimi financiar, menaxhimi infrastrukturor dhe të dhëna të tjera të domosdoshme për përcjelljen e punës dhe rezultateve të arsimit të lartë.
162. Në periudhën 2009-2011 janë zbatuar trajnime për stafin e përgjithshëm të mësimdhënësve në arsimin fillor, me të cilin sigurohen njohuritë digjitale dhe përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në procesin mësimorë, nëpërmjet shfrytëzimit të sistemit operativ EDUBUNTU (kryesisht për lëndët mësimore: matematikë, fizikë, kimi, informatikë). Nga viti 2011 me projektin “Kompjuter për çdo fëmijë” u rrit pajisja me harduerë dhe softuerë në shkollat fillore dhe të mesme dhe u siguroa interoperabiliteti.

163. U siguroa qasje për shërbimet për përkrahje dhe resurse multimediale edukative në Internet. Shkollave iu mundësua lidhje me Internet, klasat u lidhën me rrjetin lokal të Internetit si dhe u siguroa qasje e shpejt në internet për të gjithë subjektet juridik dhe fizik, të cilët janë pjesë e procesit arsimor. Është bërë revizion i Plan - programeve arsimore nga fusha e TIK-së në arsimin fillor dhe të mesëm dhe është rritur prezenca e arsimit për TIK, në atë mënyrë që janë aprovuar lëndë të obliguara nga kjo fushë nga klasa e III të arsimit të mesëm dhe është mundësuar kontinuitet i mësimin të informatikës në të katër vitet të arsimit të mesëm. Janë hartuar përmbajtje digjitale për lëndët mësimore: histori, arsim i muzikës, arsimi i artit figurativ, gjuha maqedonase dhe gjuha shqipe. Është formuar literaturë e TIK-ut në gjuhën maqedonase dhe në gjuhët e komuniteteve në vendet dhe fushat ku ekziston korniza ligjore. U aprovua portal në të cilin u vendosën librat shkollorë (për të cilat MASH ka leje) në formatin PDF.
164. Janë integruar forma fleksibile të të nxënimit dhe forma për mësimin gjatë gjithë jetës me shfrytëzimin e TIK-së në sistemin ekzistues. Është siguruar njohuri e vazhdueshme digjitale në të gjitha profesionet me përshtatjen ndaj nevojave specifike profesionale. Nxënësit të cilët kanë braktisur shkollën dhe të papunëve iu është mundësuar të fitojnë njohuri digjitale. Në shkollat fillore dhe të mesme është aprovuar ditar elektronik me qëllim të sigurohet komunikim më i mirë ndërmjet mësimdhënësve dhe prindërve, të mundësohet kontroll i shpejtë dhe i thjeshtë i informacioneve nga ditari nga ana e mësimdhënësve të shkollës dhe tu sigurohen analiza të shpejta të centralizuara të të dhënave nga MASH dhe institucionet e tjera publike. Janë hapur disa portale të cilët mundësojnë informimin dhe aplikimin për bursa, vendosjen e videove edukative, evidentimin e aktiviteteve shkencorë- hulumtuese dhe aktivitetet e tyre shkencorë-aplikative në Republikën e Maqedonisë (projekte, punime dhe inovacione).
165. Ekzistojnë shumë struktura adekuate kompetente për aspektet e ndryshme të arsimit, ku marrin pjesë faktorë të ndryshëm. Të tillë janë:
- Këshilli për arsim dhe trajnim profesional;
 - Këshilli për arsimin e të rriturve;
 - Komiteti sektorial për përcjelljen e komponentit IV- IPA;
 - Këshillit për përcjelljen e zbatimit të strategjisë për APT-në 2013-2020 në kontekst të mësimin gjatë gjithë jetës;
 - Këshilli nacional për Kornizën e Maqedonisë të kualifikimeve;
 - Komiteti për inovacione dhe sipërmarrje;
 - Këshilli për përcjelljen e zbatimit të Strategjisë për të nxënimit të sipërmarrjes;
 - Grupi këshillëdhënës për përcjelljen e zbatimit të strategjisë për inovacione;
 - Grupet sektoriale të punës në kuadër të Komitetit nacional të investimeve (grupi sektorial i punës për arsim, punësim dhe politika sociale);
 - Grupet punuese ndërministrorë për kapituj të ndryshëm nga Programi nacional për miratimin e të drejtës të Bashkimit Evropian (PNMDBE)
166. Të gjithë këto këshille me përfshirje të institucioneve nacionale siç janë: MASH, MPPS, MF, BZHA, QARr, QAPT dhe partnerët zhvillimor, gjithashtu përfshijnë edhe partnerët social si për shembull: Lidhja e Odës Ekonomike të Maqedonisë, Lidhja e Odës ekonomike të Maqedonisë Veriperëndimore, Konfederatës së Punëdhënësve të Republikës së Maqedonisë, Odës së Zejtarëve të Maqedonisë, Organizata e Punëdhënësve të Republikës së Maqedonisë dhe përfaqësuesit e sindikatave relevante.
167. Gjithashtu, me ligj janë paraparë dhe në një të ardhme të afërt do të vendosen edhe struktura të tjera adekuate, siç janë: Këshilli nacional për arsimin e lartë, shkencë, inovacione dhe teknologji, Këshilli

kompetent për çështjet të lidhura me financimin e Programit për arsim të lartë e të tjerë. Këto gjithashtu në mënyrë adekuate do të përfshijnë edhe partnerë të ndryshëm social.

168. Këshilli ekonomiko-social të cilin sipas detyrës zyrtare e kryeson Ministria e Punës dhe Politikës Sociale është organ tripartit me përfaqësim të barabartë të QRM-së, shoqatave të punëdhënësve dhe sindikatave (gjithsej 12 anëtarë) dhe ka rol këshill dhënës në krijimin dhe zbatimin e strategjive politike të fushës së ekonomike dhe sociale, duke përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me arsimin dhe trajnimin. Ekzistojnë gjashtë këshille lokale ekonomike dhe sociale ku janë përfshirë përfaqësues të sektorit arsimor.
169. Korniza e Maqedonisë kualifikimeve (KMK) ka për qëllim të përmirësojë sistemin e arsimit dhe trajnimit nëpërmjet zbatimit të qasjes së bazuar në rezultatet nga të nxënit, të lehtësojë qasjen ndaj të të nxënit në çdo kontekst, të bëjë rezultatet sa më të qarta për çdo qytetarë, të rris nivelin e përgjithshëm të kualifikimeve në popullatë dhe të përforcojë lidhjet ndërmjet kualifikimeve dhe mundësive për punësim. Me miratimin e ligjit për kornizën nacionale të kualifikimeve në vitin 2013 dhe emërimin e përfaqësuesit zyrtarë si anëtarë me të drejta të plota të grupit këshill dhënës të Kornizës Evropiane të kualifikimeve (KEK). Tashmë janë zbatuar shumë aktivitete siç janë: themelimi dhe ekipimi i njësisë së veçantë të kornizës nacionale të kualifikimeve në kuadër të Sektorit për çështje të përgjithshme dhe përkrahje të Ministrit në MASH, vendosja e funksionimit të këshillit nacional për KMK, lëshim në përdorim i ueb faqes së KMK-së, publikimit të listës së përgjithshme të të gjitha kualifikimeve dhe vendosjen e Komisioneve sektoriale për kualifikimet. Përveç kësaj, në prill të vitit 2014 u formua grupi i punës për zhvillimin e mëtutjeshëm të kornizës nacionale të kualifikimeve për mësim gjatë gjithë jetës. Në shkurt të vitit 2016 grupi këshill dhënës i KEK-së miratoi Raportin gjithëpërfshirës për udhëzimin e Kornizës Maqedonase të kualifikimeve me KEK-në dhe me vet konfirmim të Kornizës për kualifikime të arsimit të lartë, të hartuar në periudhën 2014-2016.
170. Zhvillimi i mëtutjeshëm i zbatimit të KNK-së kanë Përparësia më të lartë nacional. Intervenimet pasuese janë të lidhura me: hartimin dhe harmonizimin e legjislacionit relevant për zbatimin e mëtutjeshëm të KMK-së, përforcimin e kapaciteteve institucionale, si dhe vendosja e sistemin funksional nacional të komunikimeve nëpërmjet reformave të arsimit profesional, arsimit të lartë dhe arsimit për të rritur.

5.7.2. Sfidat

171. Temat e përgjithshme të dhëna më poshtë të sistemit arsimor konsiderohen si sfida kryesore, të cilat duhet të zgjidhen në kuadër të Strategjisë.
 1. Ligjet aktuale me të cilat rregullohen fushat e ndryshme dhe aspektet e sistemit arsimor, si dhe veprimtaritë e institucioneve të ndryshme, me sjelljen e tyre nuk janë shqyrtuar në mënyrë sistematike dhe nuk janë përputhur. Si rezultat i kësaj, ka mosharmonizim, ndërsa ndonjëherë edhe kundërshtime midis dispozitave të ligjeve të ndryshme që lidhen mes vete ose rregullojnë çështje të njëjta. Vetë ky fakt i rregullores së kryqëzuar është sfidë vetë më vete. Njëkohësisht, për dallim të fushave tjera të arsimit, për edukimin parashkollor nuk ekziston ligj i pavarur dhe kjo sferë për momentin është e rregulluar vetëm me disa nene të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve. Në mënyrë të plotë, tashmë është e njohur nevoja për përgatitjen e Ligjit të ri për arsim të lartë.
 2. Sistemet ekzistuese për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore dhe administrative për arsimin nuk janë konsistente dhe nuk janë të lidhura në mes veti. Asnjëra prej tyre nuk është gjithëpërfshirës dhe nuk disponon njëkohësisht me të dhëna të plota, të sakta dhe në kohë. Përveç kësaj, të dhënat nuk janë çdoherë konsistente të brendshme, si p.sh, me rastin e arsimit fillor dhe të mesëm të dhënat e mbledhura nga ana e Entit Shtetëror i Statistikës (EShS) janë në nivelin e shkollës, përderisa ata që kanë të bëjnë me arsimin e lartë janë në nivelin e studentëve dhe të kuadrit mësimdhënës. Më ndryshe është puna kur EShS-ja ende grumbullon të dhëna statistikore më së

shpeshti në formë të letrës nga institucionet për shkak se është e detyruar të përpunojë më shumë se njëqind pyetësor. Përveç asaj, edhe vetë institucionet arsimore janë të detyruara të grumbullojnë të dhëna për qëllime të veta për shkak se të dhënat e siguruar në bazën e SIMA-s nuk konsiderohen si shumë të sakta. E gjithë kjo rezulton si mungesë e qasjes së shpejtë dhe të lehtë deri te të dhënat dhe informatat statistikore, të domosdoshme për zhvillimin e politikave të bazuara në dëshmi. Pas asaj, jo vetëm që sistemet vuajnë për mungesa të brendshme, por edhe kapacitet e resurseve njerëzore për punë me EMIS-n (edhe në fushën shkollore edhe në fushën e administrimit) nuk janë të mjaftueshme.

3. Edhe pse për të gjithë shkollat fillore dhe të mesme janë siguruar kompjuter personal në dispozicion për të gjithë nxënësit, zbatimi i TIK-së në procesin arsimor nuk është shumë efektiv. Më konkretisht, mungojnë standarde për shfrytëzimin e TIK-së në sistemin arsimor, të gjithë mësime të mësimdhënësit nuk janë mirë të trajnuar dhe softueri që është në dispozicion nuk është kompetent për ti plotësuar nevojat vijuese. Njëkohësisht, parashkollorë dhe shkollat e mesme profesionale nuk janë shumë të pajisur me kompjuter dhe mjete të tjera të TIK-së. Në vend ende mungon platforma e vetme elektronike për të mësuar dhe mësim, si dhe për sigurimin e resurseve tjera që do të shërbenin si mbështetje didaktike për mësime të mësimdhënësit dhe nxënësit, do ju mundësonte mësime të mësimdhënësve të ndajnë përvojat e tyre dhe ti përcjellin inovacionet pedagogjike dhe do të kish sjellë deri te zhvillimi vetjak profesional i mësime të mësimdhënësve. Për të siguruar përgatitje për gjeneratën e re të specialistëve të kualifikuar të TIK-së (me kualifikime edhe të fushës të shkollimit të mesëm edhe atij të lartë) që janë të aftësuar për të zhvilluar, për të promovuar, për të marrë pjesë dhe shfrytëzuar shoqërinë informatike, duhet të rritet interesi i të rinjve për TIK-së dhe të rriten mundësitë për arritjen e tyre me kompetenca bazë qysh prej fazave më të hershme. Për këto arsye, si sfida të veçanta në këtë sektor mund të konsiderohen hapja e gjimnazit të TIK-së dhe/ose paralele të specializuara për shkencë kompjuterike dhe matematikë dhe vënia e kualifikimeve moderne të TIK-së në nivelin e arsimit dhe trajnimit profesional.
4. Edhe pse në shtet janë themeluar një numër i madh i organeve të ndryshme këshillimore me përfshirjen e partnerëve social (ose do të themelohen), megjithatë, nuk mund të konsiderohet se partneriteti social në nivelin e arsimit është i zhvilluar, as edhe se është në nivelin e përshtatshëm. Në praktikë, partnerët social nuk janë të përfshirë përkatësisht në procesin e sjelljes së vendimeve në politikën e arsimit, që kryesisht u nënshtrohet këtyre arsyeve: dialogu social për gjithë sektorin arsimor nuk është institucionalizuar në mënyrë të drejtë, si dhe përvoja e dialogut social dhe kapacitetet e zyrtarëve qeverisës, ashtu edhe të partnerëve social akoma nuk janë të mjaftueshme. Si sfida kryesore në këtë fushë është vendosja e strukturës së vazhdueshme për dialog të politikës arsimore në nivelin kombëtar – Këshill për zhvillimin e politikave arsimore; (KZHPA: me përgjegjësi të definuar ligjore dhe procedura të qarta për funksionim), si dhe zhvillimin e kapaciteteve të palëve kryesore të interesuara.
5. Edhe pse Ligji për KMK definon koncepte dhe terminologji në lidhje me Kornizën e Maqedonisë të kualifikimeve, sistemi kombëtar aktual i kualifikimeve nuk është i përputhur mjaftueshëm me ta. Njëkohësisht, një numër i madh i akteve juridike duhet të rishqyrtohen dhe të përputhen me Ligjin e KMK-së. Sistemi për përfshirjen e kualifikimeve në KMK-n dhe Regjistrin nuk janë të zhvilluara mjaftueshëm, ndërsa pothuajse, kualifikimet nuk janë të harmonizuara përkatësisht me kërkesën e tregut të punës edhe me nevojat e personave për zhvillim personal. Përveç kësaj, te Standardet e profesioneve, Standardet e kualifikimeve dhe Programet mësime të mësimdhënësve duhet të vazhdojë procesi për revizion dhe ristrukturim në bazë të rezultateve të mësimit. Sistemi i vlefshmërisë për mësim joformal dhe informal është në fazën embrionale, ndërsa vendosja e sistemit për udhëheqjen e KMK-së dhe përfshirja e anëtarëve është ende çështje e hapur. Me përgatitjen e Doracaktit për zhvillimin e mëtutjeshëm dhe realizimin e KMK-së, ishte miratuar edhe qasje e përgjithshme për shqyrtimin e sfidave.

5.7.3. Përparësitë dhe rezultatet e pritshme

172. Duke marrë parasysh sfiduesit e identifikuar kjo strategji i definoi temat e përgjithshme të dhëna më poshtë të sistemit arsimor si përparësi që duhet të zgjidhen përmes sigurimit të rezultateve përkatëse:

Përparësia I. Përmirësimi dhe harmonizim i bazës ligjore në arsim

- 1.1. Legjislacioni në nivelin e arsimit është konsistent dhe e mbështet realizimin e reformave dhe zhvillimin si dhe siguron përparimin sistematik të mjedisit përmes integritit dhe mbështetjen e të mësuarit nga të gjitha palët e interesuara;
- 1.2. Është siguruar baza e drejtësisë për rregullimin e arsimit parashkollor;
- 1.3. Janë konfirmuar mundësitë dhe opsionet për aprovimin e detyrueshëm të vitit parashkollor për fëmijët e moshës 5-6 vjeçare si hap i parë për zbatimin e arsimit parashkollor të detyruar;
- 1.4. Është rritur niveli i autonomisë administrative, financiare dhe akademike të universiteteve dhe llogaridhënia e tyre.
- 1.5. Është përmirësuar efikasiteti dhe efektiviteti i funksionimit të universiteteve.
- 1.6. Koncepti i mësimit gjatë gjithë jetës është pranuar gjerësisht dhe është promovuar përmes procesit të planifikimit të arsimit në të gjithë sektorët.
- 1.7. Publiku i gjerë e vlerëson shumë vlerën e mësimit vetjak të vazhdueshëm dhe certifikimin e shkathtësive të arritura gjatë jetës.

Përparësia II. Përmirësimi i sistemit për grumbullimin e të dhënave statistikore dhe EMIS

- 2.1. EMIS- (Sistemi i menaxhimit të informacionit në sistemin arsimor) përfshinë të gjitha fushat e arsimit dhe paraqet mjet efikas për krijimin e politikave arsimore të bazuara në dëshmi;
- 2.2. Është rritur efikasiteti dhe efektiviteti për grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave statistikore nga ana e EShS-së.
- 2.3. Kuadri përkatës në të gjitha fushat e sistemit arsimor është aftësuar plotësisht për ti shfrytëzuar të dhënat statistikore për drejtimin dhe udhëheqjen efektive të arsimit dhe për krijimin e politikave të bazuara në dëshmi.

Përparësia III. Sigurimi i përdorimit të gjerë të TIK-së në arsim dhe trajnim dhe shkrimi digjital

- 3.1. Është rritur efektiviteti në procesin arsimor përmes përdorimit të TIK-së
- 3.2. Nxënësit dhe kuadri arrihen me shkathtësitë e nevojshme digjitale
- 3.3. Janë siguruar kushte dhe mjedis për zhvillimin profesional të pavarur të kuadrit dhe për ndarjen e përvojave;
- 3.4. Është rritur efikasiteti dhe efektiviteti për sigurimin e materialeve didaktike të kuadrit dhe material mësimor për nxënësit dhe dispozicioni i inovacioneve pedagogjike;
- 3.5. Është rritur interesi i gjeneratës së re për TIK-së;
- 3.6. Janë mundësuar parakushte për përgatitje të specialistëve të ardhshëm të kualifikuar për TIK.
- 3.7. Është përgatitur gjeneratë e re e TIK-së, teknikë të aftësuar për të zhvilluar, promovuar dhe shfrytëzuar shoqërinë e informacionit dhe të marrin pjesë në atë.

Përparësia IV. Përforcimi i partneritetit social dhe përmirësimi i dialogut për politikat arsimore.

- 4.1. Partneriteti social në sektorin arsimor është institucionalizuar;
- 4.2. Partnerët social kanë mundësi të porositin dialogun për politikat e arsimit.

Përparësia V. Operacionimi i KMK-së

- 5.1. Ekzistojnë parakushte për zbatimin e harmonizuar të MRK-së
- 5.2. Është siguruar vetëdija publike e MRK-së dhe të gjitha komponentët e saja, si dhe dukja e MRK-së për palët kryesore të interesuara dhe publiku më i gjerë.
- 5.3. Janë përforcuar kapacitetet institucionale për udhëheqje efikase me MRK-n dhe futjen e palëve kryesore të interesuara;
- 5.4. Është vendosur sistem gjithëpërfshirës për kualifikimet e arritura në Republikën e Maqedonisë sipas KMK-së dhe Regjistrit të kualifikimeve;
- 5.5. Është siguruar besueshmëria e kualifikimeve të cilat arrihen në Republikën e Maqedonisë.

Përparësia VI. Përmirësimi i kapaciteteve të institucioneve kombëtare dhe sigurimi i monitorimit dhe vlerësimi i Strategjisë.

- 6.1. Nevojat për trajnimin e institucioneve kombëtare për përpunimin, realizimin, vëzhgimin dhe vlerësimin e politikave arsimore dhe për udhëheqjen e sistemit arsimor janë sistematizuar.
- 6.2. Janë siguruar informata kthyesë për procesin e zbatimit të Strategjisë;
- 6.3. Ekzistojnë parakushte për sigurimin e zbatimit efektiv dhe efikas të Strategjisë;
- 6.4. Janë siguruar informata kthyesë për atë sa janë arritur rezultatet e Strategjisë si dhe informacione për vendime të mëtutjeshme të lidhura me politikat arsimore.



ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI I STRATEGJISË

173. Strategjia do të zbatohet në përputhje me Planin e veprimit përmes përdorimit të mekanizmave dhe instrumenteve të ndryshme, me pjesëmarrjen e strukturave të ndryshme publike dhe joqeveritare, administratës dhe ekspertëve, si dhe ndërmarrjeve private. Megjithatë, MASH është organi udhëheqës përgjegjës për organizimin, koordinimin dhe konsolidimin e aktiviteteve, rezultateve të nxjerra dhe për realizimin e rezultateve. MPPS është partneri kryesor që mbanë përgjegjësi për segmentet që janë nën kompetencat e tij. Marrin pjesë edhe shumë ministri në pajtueshmëri me kompetencat dhe autoritetet.
174. Parashihen dy mënyra kryesore për realizimin e rezultateve të Strategjisë: nga ana e personalit profesional në institucionet dhe organet kombëtare, respektivisht ministrinë dhe organet në strukturën e tyre, dhe përmes furnizimit të punëve të kryera, shërbimeve dhe mallrave nga ofruesit privat apo të pavarur të tyre. Për përpunimin e dokumenteve konceptuale dhe teknike, ashtu siç janë standardet, programet, konceptet dhe mekanizmat, do të jepen grupeve punuese ku do të jenë anëtarë ekspertë dhe /ose përfaqësues të institucioneve dhe organeve kombëtare (që janë përgjegjës drejtpërdrejtë për aktivitete të caktuara) me qëllim të arrihet koordinim më i mirë dhe të sigurohet cilësi e asaj që është punuar.
175. Definimi i qartë i rezultateve dhe indikatorëve të cilat vërtetohen objektivisht, do të mundësojë vëzhgimin efektiv dhe vlerësimin e Strategjisë. Si dhe gjatë zbatimit të Strategjisë, qasja pjesëmarrëse do të zbatohet edhe për vëzhgimin dhe vlerësimin e saj. Transparenca, objektiviteti dhe besueshmëria do të jenë principet kryesore e këtyre proceseve.



PLANI I VEPRIMIT

Vërejtje: Mbështetja në kuadër të IPA II 2014-2020 (Sektori i punësimit, arsimit dhe politikave sociale) është në fazën e bisedimeve. Fushat e identifikuara janë propozime për të cilat në të ardhmen do të ketë diskutime dhe harmonizime të mëtejshme.

7.1. ARSIMI PARASHKOLLOR

Nr.	Përparesitë/Masat	Rezultatet	Indikatorit që vërtetohet objektivisht	Periudha ²⁵	Përgjegjës
Përparesia I. Përmirësimi i përmbajtjes, i kushteve për të nxënëit dhe i cilësisë në realizimin e arsimit parashkollor					
1.1	Rishikimi i Standardeve për të nxënëit dhe zhvillimin e hershëm të fëmijëve të moshës 0 – 6 vjeç	<ul style="list-style-type: none"> • Është përmirësuar përmbajtja e arsimit parashkollor 	<ul style="list-style-type: none"> • Miratimi i Standardeve për të nxënëit dhe zhvillimin e hershëm të fëmijëve të moshës 0 – 6 vjeç 	2020	MPPS, MASH, BZhA
1.2	Rishikimi i Programit për të nxënëit dhe zhvillimin e hershëm	<ul style="list-style-type: none"> • Arsimi parashkollor është orientuar nga arritja e rezultateve dalje të përcaktuara me Standardin kombëtar për të nxënëit dhe zhvillimin e hershëm 	<ul style="list-style-type: none"> • Miratimi i Programit për të nxënëit dhe zhvillimin e hershëm në arsimin parashkollor që përmbush kërkesat e Standardeve për të nxënëit dhe zhvillimin e hershëm; • Përgatitja e doracakëve për realizimin e Programit për të nxënëit dhe zhvillimin e hershëm; • Programi për të nxënëit dhe zhvillimin e hershëm i pilotuar dhe i vënë në zbatim dalëngadalë së paku në 10 kopshte 	2025	MPPS, MASH, BZhA
1.3	Optimizimi i numrit të fëmijëve në grupe	<ul style="list-style-type: none"> • Janë krijuar parakushte për t'i kushtuar më shumë vëmendje çdo fëmije në institucionet parashkollore 	<ul style="list-style-type: none"> • Janë hapur grupe të reja në kopshte me numër më të madh të fëmijëve sesa norma e paracaktuar; • Janë hapur vende të nevojshme pune dhe janë plotësuar me punonjës të ri – edukatorë dhe kujdestarë. • Numri i fëmijëve për grup nuk i tejkalon normat e përcaktuara me ligj 	2020 2015	MPPS, BZhA, komunitat
1.4	Sigurimi i kopshteve për fëmijë me kushte të nevojshme fizike (hapësirë, dhoma për lojëra, shesh lojërash, mobilie, pajisje sportive etj.)	<ul style="list-style-type: none"> • Procesi edukativo-arsimor është mbështetur me të gjitha mjetet e nevojshme fizike për arritjen e rezultateve dalje të përcaktuara me Standardin kombëtar për të nxënëit dhe zhvillimin e hershëm 	<ul style="list-style-type: none"> • Është bërë hartimi i plotë dhe inventarizimi i nevojave të institucioneve parashkollore; • 30% e kopshteve publike janë pajisur plotësisht në përputhje me Standardet dhe normat për kryerjen e aktiviteteve të institucioneve për fëmijë 	2020 2025	MPPS, BZhA, komunitat

²⁵ Realizimi i masave është sistemuar në dy periudha – deri më 2020 (më afatshkurtër) dhe deri më 2025 (më afatgjatë), varësisht nga afati përfundimtar deri kur është parashikuar realizimi i veprimtarive të përfshira brenda masës së përmendur.

Nr.	Përparesitë/Masat	Rezultatet	Indikatorit që vërtetohet objektivisht	Periudha ²⁵	Përgjegjës
1.5	Sigurimi i materialeve didaktike të domosdoshme për kopshtet	<ul style="list-style-type: none"> Procesi edukativo-arsimor është mbështetur me të gjitha mjetet e domosdoshme që të arrihen rezultatet dalëse të përcaktuara 	<ul style="list-style-type: none"> Pranimi i normativave për materiale didaktike; Pajisja e të gjitha kopshteve me mjete dhe materiale didaktike të domosdoshme; Pajisja e plotë e 30% të kopshteve publike sipas Standardeve për të nxënëit dhe zhvillimin e hershëm 	2020 2025	MPPS, BZhA, komunitat
1.6	Sigurimi i kushteve për edukimin dygjuhësor të fëmijëve parashkollor	<ul style="list-style-type: none"> Arsimi parashkollorë ofron mundësi për qasje dygjuhësore për të punuar me fëmijët e kulturave të ndryshme 	<ul style="list-style-type: none"> Themelimi i së paku 25 grupeve dygjuhëshe në kopshtet publike 	2020	MPPS, MASH, BZhA

Nr.	Veprimtaritë	Indikatorët dalës	Burimet e verifikimit	Afati i fundit	Përgjegjës
1.1.1	Validimi dhe rishikimi i Standardeve për të nxënëit dhe zhvillimin e hershëm të moshës 0 – 6 vjeç	<ul style="list-style-type: none"> GP-të për validimin dhe rishikimin e Standardeve për të nxënëit dhe zhvillimin e hershëm të moshës 0 – 6 vjeç Janë formuar GP-të për rishikimin e Standardeve; Janë përcaktuar mjetet financiare; Janë studiuar përvojat ndërkombëtare; Janë rishikuar standardet dhe janë diskutuar me palët e interesuara kryesore; 	<ul style="list-style-type: none"> Raportet e GP-ve; Procesverbalet nga takimet për diskutime; Vendimet e MASH-it²⁶ dhe të MPPS-së; 	2020	MPPS, MASH, BZhA, komunitat
1.1.2	Rishikimi i Programit për të nxënëit dhe zhvillimin e hershëm	<ul style="list-style-type: none"> Janë formuar GP-të për rishikimin e Standardeve; Janë përcaktuar mjetet financiare; Janë studiuar përvojat ndërkombëtare; Janë rishikuar Standardet dhe janë diskutuar me palët e interesuara kryesore; Janë miratuar Standarde zyrtare për realizimin e programit për të nxënëit dhe zhvillimin e hershëm së bashku me udhëzimet për zbatimin e tyre; 	<ul style="list-style-type: none"> Raportet e GP-ve; Hartimi i aktit ligjor për miratimin e Standardeve; Procesverbalet nga takimet për diskutime; Vendimet e MASH-it dhe të MPPS-së; 	2025	MPPS, MASH, BZhA

²⁶ Gjithkund në Planin e veprimtarive referimi në vendimet e MASH-it nënkuptohet që organet përkatëse në kuadër të kësaj ministrie do të veprojnë sipas kompetencave të veta dhe do të marrin vendimet përkatëse.

Nr.	Veprimtaritë	Indikatorët dalës	Burimet e verifikimit	Afati i fundit	Përgjegjës
I.1.3	Pilotimi i standardeve të rishikuara në 10 kopshte, përmirësimi i tyre dhe përdorimi nëpër kopshte	<ul style="list-style-type: none"> • Janë përpunuar rezultatet e pilotimit; • Është përgatitur versioni përfundimtar i standardeve për të nxënëit dhe zhvillimin e hershëm; • Janë miratuar standardet për të nxënëit dhe zhvillimin e hershëm së bashku me udhëzimet për zbatimin e tyre zyrtar, janë publikuar në të gjitha gjuhët dhe u janë dërguar të gjitha kopshteve 	<ul style="list-style-type: none"> • Evidenca nga pilotimi; • Vendimet e MASH-it dhe të MPPS-së; 	2024	MPPS, MASH, BZha
I.2.1	Rishikimi i Programit për të nxënëit dhe zhvillimin e hershëm në pajtim me Standardet dhe përgatitjen e doracakëve shoqëruar për realizimin e Programit në të gjitha gjuhët	<ul style="list-style-type: none"> • Janë formuar GP-të për rishikimin e Programit; • Janë përcaktuar mjetet financiare; • Janë studiuar përvojat ndërkombëtare; • Janë rishikuar programet dhe janë diskutuar me palët e interesuara kryesore; • Janë përpiluar doracakët për realizimin e programit për të nxënëit dhe zhvillimin e hershëm; • Janë miratuar programi dhe doracaku për të nxënëit dhe zhvillimin e hershëm 	<ul style="list-style-type: none"> • Raportet e GP-ve; • Procesverbalet nga takimet për diskutime; • Vendimet e MASH-it dhe të MPPS-së 	2025	MPPS, MASH, BZha
I.2.2	Pilotimi i Programit të rishikuar për të nxënëit dhe zhvillimin e hershëm në 10 kopshte, përmirësimi dhe zbatimi i tij në të gjitha kopshtet	<ul style="list-style-type: none"> • Janë përpunuar rezultatet e pilotimit të programit për të nxënëit dhe zhvillimin e hershëm; • Janë miratuar zyrtarisht versionet përfundimtare të programit për nxënëit dhe zhvillimin e hershëm; • Janë përgatitur programet për të nxënëit dhe zhvillimin e hershëm në të gjitha gjuhët, janë shtypur dhe u janë dërguar të gjitha kopshteve 	<ul style="list-style-type: none"> • Raportet nga pilotimi me rekomandimet për përmirësimin e Programit për të nxënëit dhe zhvillimin e hershëm; • Vendimet e MASH-it dhe të MPPS-së 	2025	MPPS, MASH, BZha
I.2.1	Trajnimi i edukatorëve të kopshteve për realizimin e programit të rishikuar për të nxënëit dhe zhvillimin e hershëm	<ul style="list-style-type: none"> • Është zgjedhur ofruesi/-t i shërbimeve; • Janë përpiluar programet e trajnimit (duke përfshirë këtu të gjitha modulet dhe materialet e domosdoshme për trajnim) dhe u janë dërguar të gjitha kopshteve; • Janë trajnuar të gjithë edukatorët në kopshte 	<ul style="list-style-type: none"> • Procesverbalet nga trajnimet e zbatuara; • Vendimet e MASH-it dhe të MPPS-së 	2025	MPPS, MASH, BZha

Nr.	Veprimtaritë	Indikatorët dalës	Burimet e verifikimit	Afati i fundit	Përgjegjës
I.3.1	Hapja e grupeve të reja në kopshte të cilët kanë numër më të madh të fëmijëve se sa norma e parapërcaktuar	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i fëmijëve në të gjitha kopshtet për grup nuk i tejkalon normat e përcaktuara nga legjislatcioni; • Janë shpallur dhe zbatuar konkurse në të gjitha kopshtet që kanë nevojë për punësime 	<ul style="list-style-type: none"> • Dokumentet e konkursit për punësim, rezultatet e intervistave të përfunduara; • Librat e regjistrimit të personelit (vendimet e drejtorit); • Dokumentet e kopshteve për planifikimin e buxhetit të MPPS-së 	2020-2025	MPPS, komunitat
I.4.1	Organizimi i projektimit tërësor dhe përcaktimi i nevojave të shkollave fillore	<ul style="list-style-type: none"> • Është zbatuar procedura e tenderit për sigurimin e shërbimeve për projektimin dhe përcaktimin e nevojave; • Janë përpunuar rezultatet nga projektimi dhe përcaktimi i nevojave të shkollave fillore; • Janë përcaktuar kriteret për zgjedhjen e shkollave fillore që do të pajisen tërësisht; • Shkollat fillore janë zgjedhur sipas rezultateve nga projektimi dhe kriteret e përzgjedhjes; • Janë përcaktuar mjetet e nevojshme financiare 	<ul style="list-style-type: none"> • Kontrata me ofruesin/-it e shërbimeve; • Raporti i projektimit i miratuar prej MASH-it; • Vendimet e MASH-it 	2018	MPPS
I.4.2	Organizimi i punimeve të ndërtimit për përmirësimin e gjendjes së 30% të	<ul style="list-style-type: none"> • Është zbatuar procedura e tenderit ; • Ndërtesat e së paku 30% të kopshteve publike janë përmirësuar tërësisht sipas standardeve dhe normave për kryerjen e aktiviteteve në institucionet për fëmijët 	<ul style="list-style-type: none"> • Kontrata me ofruesin/-it e shërbimeve; • Aktet për pranimin e punëve ndërtimore; • Vendimet e MPPS-së 	2020	MPPS, komunitat
I.5.1	Përpilimi i normativave për materialet didaktike	<ul style="list-style-type: none"> • Janë miratuar normativat për materialet didaktike 	<ul style="list-style-type: none"> • Vendimet e MPPS-së dhe të MASH-it 	2018	MPPS, MASH, BZha
I.5.2	Përgatitja (rishikimi) i materialeve didaktike në të gjitha gjuhët e mësimin nëpër kopshte	<ul style="list-style-type: none"> • Janë formuar GP-të për përpunimin e materialeve didaktike; • Janë përcaktuar mjetet financiare; • Janë përpunuar materialet didaktike dhe janë diskutuar me palët e interesuara kryesore; • Janë miratuar zyrtarisht materialet didaktike dhe metodologjia për zbatimin e tyre 	<ul style="list-style-type: none"> • Raportet e GP-ve; • Procesverbalet nga takimet për diskutime; • Vendimet e MASH-it dhe të MPPS-së 	2020	MPPS, MASH

Nr.	Veprimtaritë	Indikatorët dalës	Burimet e verifikimit	Afati i fundit	Përgjegjës
1.5.3	Publikimi i materialeve didaktike	<ul style="list-style-type: none"> • Është zbatuar procedura e tenderit; • Është botuar numri i duhur i kopjeve të materialeve didaktike dhe u janë dërguar kopshteve 	<ul style="list-style-type: none"> • Kontrata me ofruesin/-it e shërbimeve; • Dokumentet financiare; • Aktet për pranimin e materialeve didaktike të dorëzuara; • Vendimet e MASH-it dhe të MPPS-së 	2020	MPPS, MASH
1.5.4	Furnizimi me pajisje dhe materiale didaktike	<ul style="list-style-type: none"> • Është zbatuar procedura e tenderit; • Janë furnizuar të gjitha institucionet parashkollore me pajisje dhe materiale didaktike sipas Standardeve dhe normave për kryerjen e aktiviteteve në institucionet për fëmijët 	<ul style="list-style-type: none"> • Kontrata me ofruesin/-it e shërbimeve; • Dokumentet financiare; • Aktet për pranimin e materialeve didaktike të dorëzuara; • Vendimet e MPPS-së 	2020	MPPS, kopshtet në komuna
1.6.1	Trajnimi i edukatoreve nëpër kopshte për t'i përdorur materialet didaktike	<ul style="list-style-type: none"> • Është zgjedhur ofruesi/-t i shërbimeve; • Janë përpiluar programet e trajnimit (duke përfshirë këtu të gjitha modulet dhe materialet e domosdoshme për trajnim) dhe u janë dërguar të gjitha kopshteve; • Janë trajnuar të gjithë edukatorët në kopshte 	<ul style="list-style-type: none"> • Procesverbalet nga trajnimet e bëra; • Vendimet e MASH-it dhe të MPPS-së 	2021	MPPS, MASH, BZHA

Nr.	Përparesitë/Masat	Rezultatet	Indikatorit që vërtetohet objektivisht	Periudha	Përgjegjës
Përparesia II. Rritja e përfshirjes së fëmijëve dhe përmirësimi i gjithëpërfshirjes në arsimin parashkollor					
2.1	Zgjerim i rrjetit të institucioneve parashkollore	<ul style="list-style-type: none"> • Janë krijuar kushte themelore për të rritur përfshirjen e fëmijëve në arsimin parashkollor duke siguruar qasje të barabartë 	<ul style="list-style-type: none"> • 40 institucione të reja në zonat urbane dhe rurale në 40 qytete / fshatra; • Janë përfshirë rreth 3,000 fëmijë 	2025	MPPS, komunat
2.2	Adaptimi i institucioneve parashkollore për arsimin gjithëpërfshirës	<ul style="list-style-type: none"> • Janë krijuar kushtet fizike dhe personeli i nevojshëm për regjistrimin e fëmijëve me pengesa fizike 	<ul style="list-style-type: none"> • Themelimi i kriterit për zgjedhjen e së paku 20 kopshteve gjithëpërfshirëse • Godinat e kopshteve të caktuara krejtësisht të përshtatura për nxënësit me pengesa fizike; • Formimi i ekipeve profesionale të përbëra nga pedagogë, psikolog, edukatorë specialë, logoped dhe punonjës social në çerdhet e zgjedhura 	2025	MPPS, komunat, kopshtet

Nr.	Përparësitë/Masat	Rezultatet	Indikatorit që vërtetohet objektivisht	Periudha	Përgjegjës
2.3	Rishikimi dhe zhvillimi i materialeve të reja didaktike për fëmijët me pengesa zhvillimore në fëmijërinë e hershme	<ul style="list-style-type: none"> Janë miratuar përmbajtja dhe metodat për zbatimin e aktiviteteve me fëmijët në arsimin parashkollor përshtaten për të përfshirë fëmijët me vështirësi fizike 	<ul style="list-style-type: none"> Janë përgatitur materiale didaktike për më së paku 3 lloje të pengesave zhvillimore në të gjitha gjuhët e përfaqësuara në kopshte 	2020 2025	MPPS, MASH
2.4	Rritja e ndërgjegjësimit të personelit parashkollor dhe prindërve rreth nevojës për të pranuar fëmijët me pengesa fizike	<ul style="list-style-type: none"> Është siguruar një mjedis që ofron mbështetje morale dhe ekziston një opinion publik pozitiv mbi arsimin gjithëpërfshirës 	<ul style="list-style-type: none"> Është zhvilluar koncepti për fushatat për të për ngritjen e ndërgjegjës dhe është arritur marrëveshja me palët kyçe të interesuara; Së paku tetë fushata rajonale dhe dy kombëtare (ngjarje) çdo vit, për ngritjen e vetëdijes, të mbajtura së bashku me personat e punësuar në institucionet parashkollore dhe prindërit 	2020	MPPS, MASH
2.5	Forcimi i kompetencave të personelit punues për arsimin gjithëpërfshirës dhe ofrimi i qasjes për fëmijët me zhvillim të hershëm dhe me pengesa fizike cilësore	<ul style="list-style-type: none"> Është krijuar baza administrative për sigurimin e arsimit gjithëpërfshirës 	<ul style="list-style-type: none"> Është vendosur procedura për marrjen e vendimeve lidhur me gjithëpërfshirjen e fëmijëve me nevojë të veçanta arsimore në kopshtet/grupet e rregullta 	2020	MPPS MASH MSh

Nr.	Veprimtaritë	Indikatorët dalës	Burimet e verifikimit	Afati i fundit	Përgjegjës
2.1.1	Ndërtimi, rindërtimi dhe rregullimi i objekteve për institucionet e reja parashkollore	<ul style="list-style-type: none"> Janë organizuar tenderët për prokurimin e shërbimit të projektimit, ndërtimit, rindërtimit apo rregullimit të objekteve Është përgatitur zgjidhja arkitektonike për punët ndërtimore me vlerësim të buxhetit; Janë hapur 40 institucione të reja parashkollore në objekte të reja të rindërtuara ose të rregulluara 	<ul style="list-style-type: none"> Kontrata me ofruesin/-it e shërbimeve; Aktet për pranimin e shërbimeve të projektit dhe punës; Vendimet e MPPS-së 	2025	MPPS, komunitat
2.1.2	Furnizimi i institucioneve të reja parashkollore me mjetet e nevojshme	<ul style="list-style-type: none"> Është organizuar tenderi për prokurimin e pajisjeve; 40 institucione parashkollore janë pajisur me mjetet e nevojshme sipas standardeve 	<ul style="list-style-type: none"> Kontrata me ofruesin/-it e shërbimeve; Dokumentet financiare; Aktet për pranimin e mjeteve; Vendimet e MPPS-së 	2025	MPPS, komunitat

Nr.	Veprimtaritë	Indikatorët dalës	Burimet e verifikimit	Afati i fundit	Përgjegjës
2.2.1	Organizimi i përshatjes së 20 godinave të institucioneve parashkollore për gjithëpërfshirjen e fëmijëve me pengesa fizike	<ul style="list-style-type: none"> • Është miratuar kriteri për zgjedhjen e së paku 20 kopshëve për përshatje për gjithëpërfshirjen e fëmijëve me pengesa fizike; • Është zbatuar procedura e tenderit; • Është përpunuar projektimi dhe punët ndërtimore për përshatje e 20 institucioneve parashkollore për gjithëpërfshirjen e fëmijëve me pengesa fizike, me vlerësim të buxhetit • Janë përshtatur së paku 20 institucione për përfshirjen e fëmijëve me pengesa fizike sipas standardeve (ndër) kombëtare 	<ul style="list-style-type: none"> • Kontrata me ofruesin/-it e shërbimeve; • Dokumentet financiare; • Aktet për pranimin e shërbimeve të projekteve dhe punës; • Vendimet e MPPS-së 	2025	MPPS, komunat, kopshtet
2.2.2	Shërbimi i personelit profesional në të gjitha kopshtet sipas nevojës	<ul style="list-style-type: none"> • Janë organizuar konkurset për punësimet e reja në kuadër të shërbimeve profesionale në të gjitha kopshtet sipas nevojës; 	<ul style="list-style-type: none"> • Dokumente për konkurs (shpallje, pyetësorë, rezultate intervistash, etj.) • Evidencë për të punësuarit nëpër shkolla (vendime të drejtorëve) 	2020	MPPS, komunat, kopshtet
2.3.1	Rishikimi i materialeve didaktike ekzistuese dhe përpilimi i materialeve didaktike të reja për fëmijët me pengesa fizike	<ul style="list-style-type: none"> • Janë formuar GP-të për rishikimin e materialeve didaktike; • Janë përcaktuar mjetet financiare; • Janë përpiluar materialet didaktike dhe janë diskutuar me palët e interesuara kryesore; • Janë miratuar zyrtarisht materialet didaktike dhe metodologjia e zbatimit të tyre; • Janë përkthyer materialet didaktike në të gjitha gjuhët e mësimin nëpër kopshte 	<ul style="list-style-type: none"> • Raportet e GP-ve; • Procesverbalet nga takimet për diskutime; • Vendimet e MASH-it dhe MPPS-së 	2019	MPPS, MASH
2.3.2	Botimi i materialeve didaktike	<ul style="list-style-type: none"> • Është zbatuar procedura e tenderit; • Është botuar numri i duhur i kopjeve të materialeve didaktike dhe u janë dërguar kopshteve 	<ul style="list-style-type: none"> • Kontrata me ofruesin/-it e shërbimeve; • Dokumentet financiare; • Vendimet për pranimin e materialeve didaktike të dorëzuara; • Vendimet e MPPS-së 	2021	MPPS

Nr.	Veprimtaritë	Indikatorët dalës	Burimet e verifikimit	Afati i fundit	Përgjegjës
2.3.3	Përpilimi i konceptit për fushatat e ndërgjegjësimit nëpërmjet Planit të veprimit	<ul style="list-style-type: none"> • Janë formuar GP-të për hartimin e Konceptit; • Janë përcaktuar mjetet financiare; • Është përgatitur Koncepti dhe Plani i veprimit dhe janë diskutuar me palët e interesuara kryesore; • Është miratuar zyrtarisht koncepti i fushatës për ndërgjegjësimin dhe Plani i veprimit 	<ul style="list-style-type: none"> • Raportet e GP-ve; • Procesverbalet nga takimet për diskutime; • Vendimet e MASH-it dhe të MPPS-së 	2019	MPPS, MASH
2.3.4	Organizimi i fushatave për ndërgjegjësimin	<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillohen së paku tetë fushata rajonale dhe dy kom-betare për ngritjen e vetëdijes (ngjarje) gjatë një viti të cilat mbahen së bashku me punonjësit në institucionet parashkolllore dhe prindërit; • Janë realizuar fushatat mediatike me anë të regjistri-meve të përgatitura me video 	<ul style="list-style-type: none"> • Kontrata me ofruesin/-it e shërbimeve; • Dëshmitë nga fushatat për ngritjen e vetëdijes (p.sh. evidenca, materiale të shtypura, fotografike, video e të tjera, raporte, intervista etj.); • Aktet për pranimin e shërbimeve të mundësuar; • Vendime të MPPS-së 	2019	MPPS, MASH
2.3.5	Krijimi i mekanizmave për përfshirjen e fëmijëve me vështirësi në zhvillim në arsimin e rregullt parashkollor	<ul style="list-style-type: none"> • Janë formuar GP-të për përpunimin e mekanizmave; • Janë përcaktuar mjetet financiare; • Janë studiuar përvojat ndërkombëtare; • Është përgatitur mekanizmi dhe është diskutuar me palët e interesuara kryesore; • Janë miratuar zyrtarisht mekanizmi për përfshirjen e fëmijëve me vështirësi zhvillimi në arsimin e rregullt parashkollor dhe procedurat për zbatimin e tij 	<ul style="list-style-type: none"> • Raportet e GP-ve; • Procesverbalet nga takimet për diskutime; • Vendimet e MASH-it, e MPPS-së dhe e BL-ve 	2020	MPPS, MASH, BL

Nr.	Përpjesëtimë/Masat	Rezultatet	Indikatorit që vërtetohet objektivisht	Afati i fundit	Përgjegjës
Përpjesëtimë III. Përmirësimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore në institucionet parashkolllore					

Nr.	Përparësitë/Masat	Rezultatet	Indikatorit që vërtetohet objektivisht	Afati i fundit	Përgjegjës
3.1	Zhvillimi dhe zbatimi i standardeve profesionale dhe i profileve të punës për edukatorët, mësuesit kujdestarë, punonjësit profesionalë, bashkëpunëtorët profesionalë dhe drejtuesit e institucioneve parashkollore	<ul style="list-style-type: none"> Janë përcaktuar qartë kërkesat rreth kompetencave profesionale dhe detyrave të punës për të punësuarit në institucionet parashkollore 	<ul style="list-style-type: none"> Janë miratuar zyrtarisht standardet profesionale dhe profilet e punës 	2020	MPPS, MASH, BZhA, IShA
3.2	Përmirësimi i kompetencave të kandidatëve për edukatorë dhe mësues kujdestarë	<ul style="list-style-type: none"> Edukatorët dhe mësuesit kujdestarë praktikantë/fillestarë janë të aftë për t'i kryer detyrat e veta në pajtim me profilin e vendit të punës dhe standardet për të nxënëit dhe zhvillimin e hershëm 	<ul style="list-style-type: none"> Janë akredituar sërish programet studimore për edukatorë Janë akredituar trajnimet për mësuesit kujdestarë 	2025	MPPS, MASH, universitetet
3.3	Promovimi dhe përpilimi i sistemit për zhvillimin profesional dhe ngritjen në karrierë për edukatorët në institucionet parashkollore si dhe për të punësuarit e tjerë	<ul style="list-style-type: none"> Përmirësohen vazhdimisht kompetencat profesionale të edukatorëve dhe të punonjësve të tjerë në institucionet parashkollore; Edukatorët janë të motivuar për të treguar rezultate më të mira 	<ul style="list-style-type: none"> Është zbatuar edhe sistemi operativ për zhvillimin profesional dhe ngritjen në karrierë; Është miratuar programi për zhvillimin profesional të mësuesve kujdestarë, edukatorëve, shërbimeve profesionale dhe menaxhuesve; Ofruesit e akredituar për të ofruar trajnime për zhvillimin profesional të të punësuarve në institucionet parashkollore; Të përfshirë 50% e edukatorëve dhe mësuesve kujdestarë në programet e zhvillimit profesional 	2025	MPPS, MASH, BZhA, IShA, universitetet
3.4	Rishikimi i sistemit për dhënien e licencave për mësues kujdestarë, edukatorë, punonjës profesionalë, bashkëpunëtorë profesionalë dhe menaxhues në institucionet parashkollore	<ul style="list-style-type: none"> Të gjithë punonjësit në institucionet parashkollore i plotësojnë kërkesat minimale për kompetencat profesionale 	<ul style="list-style-type: none"> Sistemi i ri i licencimit që përmban parakushtet e rishikuara për të bërë kërkesën e licencimit, përmbajtje dhe procedura të ndryshuara për provimet e marrjes së licencës dhe kushtet e heqjes së licencës; 50% e punonjësve në institucionet parashkollore kanë kaluar procedurat e reja për marrjen e licencës 	2025	MPPS, MASH, QShP

Nr.	Veprimtaritë	Indikatorët dalës	Burimet e verifikimit	Afati i fundit	Përgjegjës
3.1.1	Përgatitja e standardeve profesionale dhe e profileve për vendet e punës edukatorë, mësues kujdestarë, shërbime profesionale dhe menaxhues institucionesh parashkollore	<ul style="list-style-type: none"> • Janë formuar GP-të për përpilimin e standardeve profesionale dhe të profileve për vendet e punës; • Janë përcaktuar mjettet financiare; • Janë studiuar përvojat ndërkombëtare; • Janë përpunuar standardet profesionale dhe profilet e vendeve të punës dhe ato janë diskutuar me palët e interesuara kryesore; • Janë miratuar zyrtarisht standardet profesionale, profilet e vendeve të punës dhe doracakët për zbatimin e tyre 	<ul style="list-style-type: none"> • Raportet e GP-ve; • Procesverbalet nga takimet për diskutime; • Vendimet e MASH-it dhe të MPPS-së; • Vendimet e QRM 	2020	QRM, MPPS,M- VL, MASH, BZhA, QShP
